

BIBLIOTEKA

GIROKASTER

8JH-32

A64

E

SHTETIT


**SOTIR
ANDONI**

*tri
novela*

INDUVA RITOS

TRI NOVELLA

Redaktor: DILAVER DILAVERI.
Kopertina nga: SPIRO KRISTO



Tirazhi 10.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1972

HËNA KISHTE MARRË TATËPJETË

Në oborr të saj rrihte një tundës, në çardhak tundej një djep, nëpër hekurat e dritares dilte një nina-nana. Zëra grash dhe fëmijësh; asnjë zë burri. Burrat kishin shkuar nëpër ara. E kujt i shkonte në mendje se unë, kokëkrisuri i fshatit, do çatisja atje mu në mes të ditës! Por ja që u fryva dhe u mbusha si një calik me raki mani e më s'mund të duroja. Të dalë ku të dalë!

Lisavetën tashmë e mbanin mbyllur në shtëpi, kurse unë desha ta takoja medoemos. Kishte hithra nën strehët, kishte kërmij nëpër hithrat, kishte lilëza xhamesh pas mureve, kishte zhabjakë nëpër tulllat e thyera, por as që pyesja për këto. Ato që sapo kisha dëgjuar ma ndezën kokën dhe, po të mos isha përmbajtur, do kisha ulëritur si një ujk i goditur.

Ngula kryet te dritarja prapa shtëpisë, hundët më hynë në saksitë me bozillog, por aromën e tij as e nuhata fare.

Dhoma e nuseve me kurorat e verdha të misrit, hiri i vatrës, urët e shuara, një djep i boshatisur dhe... në kënd ishte shtrirë ajo. Mbante një degë arre ndër duar. Fletët e gjelbëra dhe të mëdha si duar i rrihnin butë mbi faqet e kuqe e vërtitëshin nibi dy sy të mëdhenj, të zes e të butë, sy të men-

duar e të trishtuar, të thelluar nën vetullat, sy si të hutuar, si të trembur... U gëlltita. Gjunjët m'u fërkuan pas murit, por s'mund të flisja. Futa duart ndër xhepa, i mbusha pëllëmbët me thana e ja vërvita nëpër dritare... Ajo fërgëlloi e u derdh nëpër derdhjen e thanave. Lëngu i kuq ju shënua nëpër fytyrë, në hundë, në ballë, thanat ju derdhën gushës e ju futën nëpër gjinjët e ajo qeshi me qukëzat e faqeve të ngjyera me lëng të kuq. Në atë çast dera e odës krisi e u përplas, unë u zbrapsa nga dritarja e bëra një çap prapa. Atje hyri i ati, Golja, tërë sulm e inat. E pashë, por ai s'më pa.

— Me kë flet kështu? — i tha së bijës.

— Me veten time.

— Mos lojte!

— S'është çudi... me këto që bën ti, baba, edhe mund të çmendem.

— Posi... posi! edhe të tjera kanë bërë naze si ti, po pastaj i ka shtruar buka dhe fëmijët.

— Jo, baba, mos...

— Po si s'mendon për tët atë xhanëm? Do kapem pas një cope toke...

— Jo... kot e ke, unë nuk e dua, jo!

Sikur ai t'i sulej për ta rrahur, hekurat e dritares me dhëmbë do t'i shqyeja e do hyja. Por ai heshti, ktheu shpinën nga dritarja. Ashtu munda ta shihja edhe një herë atë bujk trupgjatë e qimeverdhë, të thatë, me kokën dhe duart të mëdha. Ishte keq i dobët, si pa qafë, si krap, e dukej sikur s'kishte copë mishi në trup, veç një grusht muskujsh i qenë mbledhur në zverk me ca rrudha të thella e nëpër ato rrudha ca qime të rralla...

Dhe u rrokullisën shumë ngjarje.

Malet e largëta e të kredhura në një tis blu të errët po e shtynin natën përmbi fshat. Kupa e qiellit po hirosej e njerëzit me kazma në duar e sëpata krahëve po zbrisnin tatëpjetë. Burra të ashpër veshur me shajak të zi përpara kishin kafshët e ngarkuara me brana e me dru, ndërsa prapa, pas, si oçiçe vinin gratë e tyre të kërrusura, të rreshkura, me çorape e shtiza ndër duar dhe me shpinën ngarkuar me dengje gjethi për gjënë e gjallë.

Në fshat po vinte kopeja. Të tjera gra e nuse me mashtrapat në duar prisnin në çezmat e rrugëve, duke u treguar shoqeve e sulinarëve të rejat e ditës e duke trazuar ndër xhepa ndonjë krodhe buke apo ndonjë masë krundesh.

Muzgu në fshat. Hynte kopeja. Në ballë dy cjep fodullë. Njëri më lavrak, me mjekër të hollë e brirë çatallë, teshtinte e turfullonte. Tjetri s'kishte brirë fare. Ishte leshzi, i ngjallur, i rëndë e këmbëshkurtër, në kokën e madhe kishte leshra shumë e çuditërisht të lëmuara, një mjekër të gjatë (ndonëse ja kishin shkurtuar ca), leshi i tij ishte i dendur, i gjatë e i zi dhe dukej si një raso. Ngjante tamam si një dhespot. Dhe kështu e thërrisnin. Nuk kishte mbrëmje që «dhespoti» të mos hynte i pari në fshat, por sonte... s'u kthye!

Rrako Çeturi, djalë njëzet e pesë vjeç, moshatar me mua, rrinte vrerët te kreu i rrugës. Hundët i kishte lëshuar një pashë, ballin rrudhur si plak e gjunjët e hollë përbrenda atyre pantallonave të holla prej stofi që s'i kishte njeri tjetër në fshat, i dridheshin nga inati.

Ky ishte rivali im. Të dy kishim shtënë dashuri në një vajzë. Në panaiet rendte i pari, në dasmat gjithashtu, i binte edhe kitarës. Kishte një palë nofulla të gjera me ca faqe të mëdha e të bardha si petulla prej nishesteje. Kokën e kish ca të madhe e prandaj, prapa e në tullgë flokët i qethte shkurt e karé, kurse përpara i linte të gjata.

Ai asaj dite i kishte dërguar fjalë Lisavetës, vajzës që ne donim të dy, kurse ajo ja kishte kthyer: «Shiko punën»!

— Çoban Mihali ! O çoban Mihali! Ku e ke «Dhespotin»?

Tjetri uli kryet dhe ja nisi me «Përruan e Hajdutëve» dhe mbaroi me një «nesër, të shumtën gjer pasnesër, do të sjell nishanë, se kaq e pat...»

Rrakua ju sul si i tërbuar:

— More sarakaçani i djallit, hajdut e rrjepacak, ti që vjen e na merr hakun që në shkurt... .

Dhe furia e Rrakos sa vinte shtohej, kurse Mihali bënte ç'bënte e zinte në gojë nishanin, gjersa...

Rrakos filloi t'i stërzgjatej zëri si i lyer me jargë dhe fare papritur u largua jo për tek i ati, por tatëpjetë lumit... .

«Mëlçitë ja hëngërshin njëqind ujqër, sepse nga mungesa e tij janë shpërndarë edhe ftujat dhe ata gjejnë shkak të shkojnë gjithandej për t'i kërkuar...»

Me siguri, ky mendim e bëri t'i zgjatej zëri atje para Mihal Çobanit, kurse «Dhespotin» e përfytyroi se ishte duke u vërtitur diku në ndonjë hell hajdutësh ose «kushedi sa ujq po e copëtonin ose kushedi se cila ferrë gjembashe e ka kapur pas ramos së zezë e s'e lëshon gjersa të vijë kumtëri ujq që t'i bëjë gjyqin e fundit».

Unë e dija që sonte Lisaveta do të dilte për të kërkuar «milorin e humbur». Ajo kishte shkuar te pylli me akacje, që në fshat e thërrisnin «Grazhdi i Bletëve», se në verë, ky pyll i vogël gumëzhinte nga bletët.

Aty u takuam me Lisavetën. Ishin mbështjellë akacjet plot nur si nuset ditën e dasmës, u vareshin lulet tufa-tufa si vile rrushi të bardhë e këto vile të buta si kadife e plot aromë, aq të freskëta, aq lozonjare e aq ledhatare na përkëdhelnin fytyrë e flokë, gushë e supe e përkëdhelja e tyre s'kishte të mbaruar, sepse Lisaveta s'kishte ndër mend të nusëronte asaj nate dhe unë kurrsesi s'i ngjaja atij dhëndrrit të përrallës, që rrinte në krye të shkallëve e dhëndërronte!

Kalova dorën mbi krye e i ndjeva flokët më të shtruar e më të butë. Nuk e kuptoja përse: nga qetësia e brendshme, nga ajri i vakur apo nga mbrëmja e butë.

— Babai nuk të do, i foli edhe emta, por ai ngul këmbë. «Kam dhënë fjalën gjetkë, thotë, i dhashë fjalën Anastas Çeturit e mbaroi; atje ka të hajë e të pijë si zonjë». Por ti, Vaso, mos ki merak. . .

— Ti a më do mua?

— Pse pyet marrëzira?

— Po thuama. . .

— Po unë përse jam këtu?

Dhe këtu më lindi që t'ja numëroja fijet e qerpikëve. . . një për një! Një për një e një nga një!

U ndie një çap i shqetësuar që afrohej. Vetëm atëhere vumë re se nata kishte rënë e hëna s'kishte dalë!

— Ti, Lisaveta, fshihu këtej.

Një si hije diçka kërkonte nëpër errësirë. E njoha në të parë. T'i fshihesha? E përse?

— E mo, Rrako, a e gjete «Dhespotin»?

— Po ti, e gjete ftujën?

— Mua s'më ka humbur, gjithnjë e kam patur...

— Thashë de... po ajo atje kush është?

— Kush të të pëlcastin.

— Të të rrjedhin e t'i mbash në dorë.

Ja kështu ju vërsulëm njëri-tjetrit.

— Ti rri aty mënjanë! — i thashë Lisavetës.

Ç'burrë do t'i thosha vetes unë kur do vija Rrakon poshtë me ndihmën e një gruaje!

Kurse ajo vinte rrotull, kafshonte gishtat me dhëmbë e nuk dinte se ç'të bënte. Të rrinte, keq; të ikte, ca më keq! Por vërsulja jonë mbi njëri-tjetrin ishte si e çmendur. Përplasjet tona ishin të tilla sa degët, rakitat vërtiteshin me aq forcë, sa, po të të qëllonin, të linin në vend.

Dhe medoemos në këtë ndeshje e në këtë rrahje, që ishte vërshim i një urrejtjeje të gjatë e të egër, m'u kujtua një ngjarje pak a shumë si kjo. Dikur kisha parë me sytë e mi një ndeshje meshkujsh për një femër.

Në pellgun e madh që formohet nga rema, një mëngjez u gjend një ari i mbytur. Askush s'e dinte si ndodhi përveç meje që u ndodha asaj nate dëshmitar i një skene me të vërtetë të çuditshme. Ishte natë dhe ishin tre arinj. Me sa dukej dy meshkuj e një femër. Dhe të dy meshkujt u përfytën. Ishte një zënkë e egër dhe e çuditshme në ujë. Arinjtë shkulnin hunjtë e trashë të remës, rrëmbenin vandakët e gjedhovinave, që kthenin ujërat e qëllonin njëri-tjetrin si njerëz dhe pëllisnin e klithnin e ç-

rreshin me ca zhurma, që të kallnin tmerrin. Ariu që rrinte mënjanë te mezhda medoemos ishte femra. Të dy meshkujt s'ju ndanë njëri-tjetrit. Përleshja vazhdoi me të qëlluar me drurë, me të qëlluar me vandakë, me gurë, me shputa, me kokë. Ndeshje trup me trup e dhëmb për dhëmb. Ajri anë e çark u qelb nga era e tyre e rëndë, erë bajgash, djerse dhe egërsire. Më në fund, njëri nga arrinjtë u kapit dhe, ashtu i dërmuar, i gjakosur, i çjerrë dhe i dërmuar në trup e në shpirt mbeti si i zalisur vetëm me kokën mbi ujë dhe e pa armikun e tij triumfonjës tek u nis pas femrës në shtegun më lart. . .

Edhe unë nuk di sa grushte dhashë e sa mora asaj nate. Ai luftonte si qen. Në një çast, më futi dhëmbët në sup e më kafshoi aq fort në mish, sa e ndjeva që atij ju mbush goja plot me gjak e mua m'u lag llëra. Por në këtë çast e kisha shumë pranë e ja këputa me grusht në bark. Jo lehtë, por duke vënë gjithë peshën e trupit te forca e grushtit! Në çast u zbraps, ulëriti dhe u ngjesh sheshazi për-tokë duke tundur kokën nga poshtë lart si ndonjë kalë teknefes. U rrahëm aq fort, sa ramë të dy të kapitur njëri këtej e tjetri andej. Si nëpër ëndërr e pashë Lisavetën që m'u afrua dhe më fshiu gjakun, por s'di nëse ajo qau, sepse sytë më shihnin turbull sikur më ishin veshur me perde, më bëhej se e shihja vajzën duke qenë syhapur i kredhur në një pellg me ujë.

— Të ikim! — më tha, dhe vështroi nga ai që akoma s'e kishte marrë veten prej grushtit në bark. Vështroi nga Rrakua dhe m'u duk sikur i erdhi keq, m'u bë sikur deshte t'i fshinte gjakun edhe atij dhe s'më erdhi mirë. Isha i dërmuar, gjaku më hipi në

kokë e nga gurmazi më doli një çjerrje e egër. Isha i këputur, i lodhur, gati i ngordhur, por zilia (si e quanin ne xhelozinë asaj kohe) po më gërryente të tërin. Para kësaj ndjenje të fortë, grushtet që hëngran dhe dhëmbët, që më kafshuan ishin një gudulisje.

U larguam bashkë me Lisavetën.

— Ik, tashti, shko kërko «Dhespotin»! — i thirra rivalit.

Ajo po më çonte në shtëpi. Isha mbështetur në supin e saj, e kisha krahun qark belit të saj, i ndjeja krejt format e saj ngjitur pas vetes sime dhe, të them të drejtën, s'më vinte keq për të gjitha ato që hëngran. Kur arritëm te dera ime, ajo s'deshte të hynte brenda... E vështrova me ca sy që do të kishin bindur dhe ujqërit, që tashti ishin mbledhur te Përroi i Hajdutëve dhe po i bënë «Dhespotit» gjyqin e fundit. Dhe ajo hyri me sytë përdhe. Motrat m'u derdhën sipër e s'u bëhej të besonin asgjë. Nuk dinin se çfarë të bënin më parë: të më pllakosnin mua me qepë e kripë apo të prisnin nusen që sapo futi në prak këmbën e djathtë.

Isha si isha, i fola:

— Erdhe, mirë se erdhe, rri e mbaroi puna!

Ishte vazjë që besonte shumë, e padjallëzuar, si lulja e bajames.

— Ta bëjmë punën me të mirë, Vaso!

— Por në qoftë se yt atë s'pranon gjer në fund?

— Atëhere po...

Dhe ajo iku në shtëpi të vet dhe më la në duart e motrave. Shkuan dhe thirrën Simon e Naçit. Erdhi plaku me veglat e xherahut dhe me atë gjuhën e tij të hollë:

— Mirë të paska rregulluar i biri i Anastasit, hë, djalë, ta dish se ç'domethënë dru prej pasaniku e inat prej çorbaxhiu. Kështu i do punët i pangopuri, ai që e ka barkun me dhjamë, ai i do koriet të paprera, tokat ndënë ujë, ormanet me plepa, mullinjte me dy gurë e domosdo edhe gruan të bukur!

Dhe një ditë u ngjita në tavan dhe nxora kryet nga baxha e çatisë. Që të mos bija në sy, vura përpara një degë nga të blirit dhe vështroja nga shtëpia e asaj. Më në fund, ajo pa fletët e blirit dhe filloi një ecë e jakë nga shtëpia në çesmë. Pastaj doli në oborr të vet e, duke u folur dy motrave të saj më të vogla, me bishtin e syrit hetonte nga unë. Dhe... vajzat e vogla nisën ta vërtitnin litarin në erë, kurse ajo, goxha çupë, aty në oborr të vet qarkuar me avlli, aty nën dardhën e madhe, nisi të kërcente e të hidhej në litar duke vështruar këtej. Vërtet se isha mjaft larg, vërtet se hollësi të tilla si sytë, vështrimet, gërshetat e gjunjët e më the të thashë, nuk i vështroja dot hollë-hollë... por ju e dini se isha djalë njëzet e pesë vjeç dhe në një moshë të tillë punojnë më fort sytë e mendjes se sa sytë e ballit!

Pas disa ditësh Rrakua më dërgoi fjalë. S'e di nëse ai vetë apo bashkë me të atin. Kështu dërgohej fjala asaj kohe. Shkurt, me ca fjalë të hedhura dosido e si me shaka, por prapa atyre fjalëve fshihej dufi, inati, urrejtja, e dhuna:

«A do të heqësh dorë nga Lisaveta, apo ç'thua? A e di ti se ku kalon vija e ujit, që ti vadit arën tënde?»

Por unë asaj kohe isha nga ata që ja merrja

këngës duke u ngjitur në të përpjetën e madhe të malit, prandaj ja ktheva aty për aty:

«Unë i di edhe vijat, që vaditin kokën e çifut Anastasit me gjithë të birin. Ç'pandehin ata, se mua s'më rri maçoku më bisht?!»

Isha mbrehur me Anastas Çeturin, të cilit prapa krahëve i thërrisnin Tasi Gishti ose Tasi Teknefesi. Anastasi kishte qënë për shumë vjet si kandarxhi në Mal të Shenjtë ku punonin si druvarë burrat e fshatit asaj kohe. Kandarxhiu për llogari të tregëtarit peshonte me kandar qymyrin, që dorëzonin druvarët dhe gjithnjë mundohej t'ua hidhte punëtorëve për llogari të të zot e për llogari të vet. Por që t'ua hidhte me zgjuarësi, zoti Tasi, gjatë peshimit, i mëshonte fshehurazi shtizës së kandarit me gishtin e vogël. Dhe i mëshonte aq tinëzisht e me art, sa ja kishin ngjitur «Tasi Gishti». Nofkën «teknefesi» Tasi e gëzonte sepse nga urrejtja e inati, druvarët, pas peshimit «me ndihmën e gishtit», i shkundnin thasët aq me forcë, sa pluhuri i zi i qymyrit ishte në gjendje t'i vuloste Tasit jo vetëm hundët, por edhe grykën. Kështu që zotit Tasi s'ju nda kurrë ajo e teshtitura, që të ndotte e të kallte krupën kur e dëgjoje. Pastaj, kur kurbeti i Amerikës e bëri batalll atë të Malit të Shenjtë, zoti Tasi tha se shpëtoi nga dumani i zi i skelës së Dafnës dhe u hodh matanë detit të madh «për të mbledhur para me lopatë». Këtu gjeti punë për duart, por jo për gishtin. U mërzit dhe u vërtit poshtë e lart rrugëve, gjersa hyri në një depo si rojtar me shpresë të mbështetej te gishti i vogël, por pronari ja vuri drurin që javën e parë, sepse nuk e duronte dot të

teshtiturën e tij. Por me gjithë këto, falënderjes gishtit, Tasi nga Mali i Shenjtë solli para të thata, kurse nga Amerika solli vetëm «engleçen»¹⁾ e tij që mburrej se e thante fare.

Pasurinë e shtoi duke blerë ara e livadhe në shkurtin e atij viti të zi kur ra tërmeti. Dhe si njeri që i njihte mirë kohërat, Anastas Gishti tregëtonte, shkruante senete e mernte firma vetëm për vetëm në atë muajin më të shkurtër të vitit, atëhere kur mbylleshin rrugët nga dëbora, kur ulërinin ujçërit rrugëve të fshatit, kur delet në haure hanin dëllinja e kur në hambarët binte miu e thyente kokën!

* * *

Ishte dita që i vajta Lisavetës në shtëpi. Më ndali plaku Simo Naçi në rrugë dhe më tha:

— Dëgjo këtu, hap sytë këto ditë. . .

Më sëmboi në zemër dhe më shkuan të ngjethura gjer në thëmbrat e këmbëve.

— Pse?

— Anastasi ka hapur butet me verë.

— Për dasmë?

— Ndofta, por ai zien verën për raki.

— E pastaj?

— Marifete të vjetra. Kur zien raki pasaniku, ruaju se të vret e. . . «isha i pirë». — Dhe Simua më shkeli syrin, pastaj shtoi:

— Kam edhe ca fjalë, por një ditë tjetër, shko tashti dhe març ti edhe hakën time.

Unë hakën e Simos! Çfarë haku?

1) Anglishten

Ishte një zakon i vjetër asaj kohe, pagan. Vajzat e fshatit varrosnin Nënë e Diellit. Dhe kjo Nënë e Diellit ishte një kukull prej balte që kishte për arkivol një qeramidhe të kuqe, përsipër mbuluar me lule shqerra, pastaj e kredhur në një sepet të madh mbushur me bozilog të thatë: Fill pas varrosjes djemtë e fshatit bënin rendje me kuaj të rinj, pa shalë e pa samar.

Dhe asaj dite kisha vendosur të dilja i pari dhe duhej të dilja medoemos. Për këtë ditë e kisha kullotur doriun një javë të tërë nëpër mezhda me tërfil e nëpër përrenj me bar skrips.

Në mëngjez vajzat e varrosën Nënë e Diellit në një lëndinë anës së lumit, atje ku nënat, gjyshet e katragjyshet patën varrosur atë Nënë Dielli, për mijëra vjet me radhë, atë Nënë Dielli që ishte mësuar të vdiste një herë në çdo vit. Pastaj vajzat dolën për sehir. Por... nga rendja me kuaj unë dola për turp. Përpara çau Rrako Çeturi gjithë bujë e brohori duke u kapardisur majë kalit sa unë desh plasa. Dhe që aty shkova te lëndina e kurbatëve dhe takova Xhezo Kurbatin. Ishte një burrë shtatgjatë dhe i shkathët, me fytyrë si të lyer me lëng vishnje. I tregova hallin dhe i kërkova që kalin tim ta bëja tramba me kalin e tij më të shpejtë, bile t'i jepja edhe yst. Kurbati qeshi dhe në fytyrën e tij të zezë i ndritën dhëmbët e bardhë.

— Dëgjomë këtu, djalë... unë Gjokun ta shesa, por nuk shesa dot bashka me hambarë me elb të Anastas Çeturitë!

Kryulur u ktheva sërish te lëndina e madhe. Rrapo Çeturi përsëri po fluturonte me kalin hipur e i binte rreth e qark lëndinës si heroi i ditës, si

fitimtar i rendjes. Ndjeva se përsëri po më dhimbte supi ku dikur ai më kishte ngulur dhëmbët. Lisavetën s'guxoja ta vështroja, por edhe ajo s'deshte të më shihte ashtu të turpëruar, s'deshte edhe ajo që i biri i Tasit të shiste të trasha e të tundej e të shkundej majë kalit me atë cohën e kuqe ndër duar që e sillte dhe e vërtiste në arë si flamur të fitores. Dikush tha një fjalë që të hidheshim në lumë e të shihnim kush do të dilte i pari në not. Por kjo s'vlente asgjë. Sepse, po të zhvisheshim ne, vajzat duhej të iknin dhe kuptohej që s'ja vlente barra qiranë. Dikush tjetër foli për rendje pa kuaj, por Rrakua, kapadai, mblodhi buzët:

— Jam mësuar me kalë unë...

Një tjetër foli për mundje trup me trup, por Rrakua e hodhi tej edhe këtë:

— Se mos jemi dema ne...

Atëhere më erdhën në ndihmë sqifterët! Rreth e qark vorrezave tona, kemi pasur ca plepa gjigantë (përfytyroni nja dyqind plepa rreth lëndinës ku kam vendin e fundmë edhe unë). Brenda radhës valavitëse të plepave kemi të përzjer edhe drurë molle e qershie si edhe një bredh gjatosh. Në këto plepa sajonin foletë sqifterët grabitqarë e që nga maja e këtyre plepave nisnin fushatat grabitqare e plaçkitëse për zoga të njoma, për rosa të mitura e për arra të qëruara. Po a kishte burrë të ngjitej gjer atje lart! Këputej maja e plepit si presh kreko e ikje matanë sa të hapësh e të mbyllësh sytë. Të qëlloje foletë me armë, kjo ishte punë që s'bëhej, sepse atëhere mbretëronte si mbret në fron mbretëror ai sovrani august që ishte shkëputur si rrufe prej qiellit dhe s'kishte lënë mënjanë as tym e as mjegull!

Dhe... ne e kishim namin si fanolistë dhe kusuri vetëkuptohet. Ca çunakë të shkathët i kishin qëruar foletë, por... foleja e plepit-mbret ishte atje lart e më lart e paprekur, e pakapshme, krenare dhe gjembashe, nanurisej e falej bashkë me plepin dhe fletët shamatore, kurse sqifteri i saj me thonjtë e mprehtë e sqepin e kthyer hynte e dilte gjithnjë i ngarkuar me plaçkë lufte... Tani, ato vajzat që patën qarë e varrosur Nënë e Diellit, po këndonin aty te sheshi i madh, kurse unë s'desha të këndonin. Nuk desha të këndonin ato, se zemra ime qante. Rrako Çeturi më mundi në rendje me kuaj e unë këtë s'mund ta kapërdija. U lëshuam të gjithë nga plepi-mbret. Kush është i zoti?! Ja ku është maja e tij! Futa sakaven e vogël në brez, nxora opingat, por... më preu, sa isha gatitur vetë, Rrakua pat nxjerrë këpucët dhe i qe vërvitur plepit. Medet! Ai po më rrëmbente gjithshka. Deshte të dukej vetëm i biri i pasanikut dhe unë të katandisesha në një lolo! Tani ai po ngjitej duke shtrënguar pas trungut gjunjët, gjoksin dhe pëllëmbët. Kaloi pjesën më të vështirë e pa degë, arriti më lart dhe u vërvit përpjetë si një mace e egër. Vërtet po arrinte te maja, por këtu ishte e keqja, kur ja edhe sqifteri i egër e pa dhe ju lëshua sipër! Shpendi dinak, duke treguar kthetrat e veta, duke karkaritur e vikatur, po i vërsulej mbi kokë e, megjithëse Rrakua i kërcënohej dhe qëllonte me grusht, shpendi s'kishte ndër mend të tërhiqej. Por era ulëriu lart e britmat u derdhën poshtë. Rendi atje Anastas Gishti e, duke bërtitur e teshtitur, shante, çirrej e mallëkonte dhe urdhëronte të birin të zbriste poshtë. Anastasi dridhej e tundej si epileptik sa i ra përtokë nofulla e

sipërme e dhëmbëve të vënë. Rrakua s'bindej, jo se i thirri i ati, por s'bindej sikur edhe djalli t'i fliste... Unë e pashë, e kuptova, e ndjeva. Rrakua u tremb, se tani maja e plepit nën peshën e tij dhe nën pre-sionin e erës po rrotullohej e po anohej, hepohej e çakërdisej si direku i një barke në det në mes të furtunës. Nga e gjithë turma atje, askush s'pipëtinte, përveç Anastasit që qante, bërtiste dhe i falej zotit, që nisi t'i blatonte koshe me bletë e koshere me misër.

Kur Rrakua e pa pisk, u bind dhe zbriti dhe, sapo i zunë këmbët tokë, ju vërvita vetë plepit. Rrako Çeturi shtrëngoi buzët dhe më vështroi me urrejtje, kurse i ati teshtiu, turfulloi e murmuroi. Me siguri ishte duke shtuar blatimet, mjaft që unë të këputesha nga lart e të thyeja arzen e zverkut.

Sa më shumë ngjitesha lart, aq më fort dallohej fshati, çatitë, rrugët, oxhaqet. Vinte erë dëllinje e djegur; në qeramithanë po gatuanin baltë për të sajuar çerepë. Arrita në një lartësi me bredhin. Boçet si prej bakri, me ca si vetulla të holla, sapo kishin filluar të djersinin rrëshirën. Ngjitazi me bredhin ishte qershia e madhe me ato degët e përhapura sa andej-këtej, aq sa nën të mund të mërzente gjithë kopeja e fshatit. Kishte nisur vapa e, sa më shumë shtrëngonte zhegu, aq më tepër dukeshin të venitura e si të drobitura fletët e qershisë e aq më fort shquanin të ndezura në të kuq kokrrat e qershive.

Arrita!

Sqifteri m'u sul sipër si i tërbuar, por me një furi edhe më të papërmbajtur. Kishte marrë zemër nga tërheqja e Rrakos. Sapo hëngra një çukitje me sqep në kokë, shkula sakaven dhe ju kërcënova



shpendit. Ishte një dyluftim i egër. Dhe në këtë ndeshje sqifteri kishte aftësinë që s'e ka asnjë zog tjetër: qëndronte pezull në erë. Dhe kështu, duke u përfytur, tundte krahët e tij të fuqishme dhe të murme. Por... edhe një këmbë, edhe dy çape, edhe një... Erën e prisja me tehun e sakavës kur sqifteri më sulmoi ballë për ballë. Turma atje poshtë po më jepte zemër, motrat po bërtisnin e shkulnin flokët, kurse Rrako Çeturit ja pashë sytë dhe ja lexova: Ai po i lutej zotit që unë asaj dite të varrosesha bashkë me Nënë e Diellit, ndofta si kurban për «Dhespotin», të cilit ende, s'po i dukej nishani.

Por s'paska më të shëmtuar dhe më të egër se sytë e sqifterit! Unë ata asaj kohe i krahasoja vetëm me sytë e Rrako Çeturit dhe krahasimi më dilte mëse i plotë. Në një çast e qëlllova sqifterin me tehun e sakaves, e qëlllova diku në këmbët e tij të shëmtuara e të verdha dhe më erdhën gjer aty disa pupla të zeza, pastaj pika gjak sqifteri... ndërsa dhe era frynte si e marrë! Gollogushët e sqifterit krakavitnin sikur i kishin vërvitur në det. Sqifteri luftonte trimërisht e s'më ndahej, kurse bota përposh më sillej e më pështillej si të ishte fugë. Më dukej se më kishin rrëmbyer valët e një deti të egërsuar e më hidhnin e më pritnin si të isha gogël. Kur animi dhe hepimi shkonte përpara e anash... këto i duroja me dhëmbët shtrënguar, po, kur era më vërviste e më shtynte, praptazi, atëhere, të them të vërtetën, më kalonin rrëqethje në shpinë, pastaj në krejt qenjen, sepse nga çasti në çast mund të fluturoja në humnerë. Por më në fund, futa dorën e djathtë në folenë gjembashe, sqepat e gollogushëve më gërvishën, sqifteri i madh thuajse u çmend

fare e ma lau kokën me gjak, më çori me thonj në tullgë, pastaj në llërët, por unë s'ju ndava. I rrëmbeva të tre gollogushët në njerën dorë dhe... ja këtu shpërtheu dufi im... e mata me sy largësinë, fuqinë e erës, qarkun e lëkundjes së plepit dhe fiu...

Të tre gollogushët i vërvita tutje, në një shenjë të caktuar! Pas tyre u vërsul si i çmendur sqifteri i madh, që vikati e ulëriu. Por zogjtë e tij mbërritën atje ku duhej. U përplasën përmbi çatinë e Rrako Çeturit. U mbusha me frymë dhe bëra të zbrisja. Po pikërisht në këtë çast nën këmbët e mia diçka kërkëlliti, pastaj s'di sesi ngjau, por e kuptova në çast. Maja e plepit u thye, u shkëput, unë e shtrëngoja atë dhe bashkë me të fluturoja në hava. Turma atje poshtë klithi, qielli m'u ndeh përposh, toka m'u ngjit lart, por... Pata fat. Më ndihu era, përmbledhja e mendjes dhe fletët e shumta të majës së plepit. U përmbysa mbi tumbën e bredhit, pastaj u përplasa mbi qershinë e madhe, rashë mbi degët, rrëshqita pjerrtazi mbi to dhe gërsheti i dendur i degëve u tund, u lëkund e u kolovit poshtë e lart... por më mbajti!, Trualli përposh u mbush plot me kokrra qershii të kuqe. Majën e plepit s'di kur e lëshova e nga më fluturoi. Sapo u gjenda në tokë, fare mbi këmbët e mia, motrat m'u lëshuan sipër. Edhe ajo pandehi se ishim te Grazhdi i Bletëve dhe ma kapi kokën me të dy duart dhe ma shtrëngoi fort! Oh! Po ta dija kështu! Rrakua ishte atje afër dhe dridhej, ishte zverdhur në fytyrë më fort se thonjtë e sqifterit.

Dikush nga turma hodhi një fjalë:

— Përmbi çatinë ku ranë gollogushët janë mbledhur maçokët e fshatit!

— Urra!

Plasi një e qeshur dhe një zhurmë, një thirrje gëzimi, që ishte më shumë një shprehje dufi, inati e urrejtjeje. Duke ikur tatëpjetë, Anastas Çeturi teshtiu fort e, duke vështruar turmën me sy të egër-suar, vërshëlleu një parashikim, që ishte më shumë një kanosje:

— Hë! Do mos vijë shkurti përsëri a!

Mendova se nga ngjarja e ditës, Tasi me të birin do të hiqnin dorë nga një vajzë që sheshazi, në sy të fshatit, i kapi kokën me të dy duart të birit të botës. Por nuk ndodhi kështu. Ata njerëz ishin të trullosur, si të përbuzur. Po asaj mbrëmjeje i ishin betuar priftit të fshatit se kishin për të përmbysur gjithë tokat dhe Lisavetën do ta merrnin për nuse, se ndryshe s'béhej! Mbi këto edhe e shoqja e Tasi Gishtit pat dhënë një premtim:

— Do të nxjerr nga sëndyku karficën me pesë lira dhe do t'ja mbërthej Lisavetës mu në gjoks!

M'u mbush koka se ata ishin gati të përdornin mënyrat më të pandershme, mjaft që t'i dilnin mbanë dëshirës së tyre. Thuhej se, sapo të zinin dorë e të shkëmbenin nishanin e fejesës, do ta linin Lisavetën faqe gjithë fshatit! Unë ua hidhja planet në erë, po ç'ti bëja vajzës? Edhe shpresonte të mar-tohej me uratën e babës, me fustan të bardhë dhe me të vëllain në dasmë që ishte në kurbet dhe e prisnin të kthehej. Por ja ku dha kokë intriga. Erdhën e më thanë:

— Vëllai i Lisavetës ka dërguar kartë dhe kërkon për nuse motrën tënde, kështu hapet krushqia dhe mbyllet sherri.

Po më futnin zjarrin brenda në shtëpi dhe u turbullova edhe më keq, kur vura re se edhe sime motre i hanin hundët...

Renda nga oborri i asaj dhe u vërtita rreth një copë herë nëpër errësirë. Në një kohë, ajo doli me një kandil në njëren dorë, kurse në tjetrën kishte gjymin e madh. I fola që këtej gardhit.

— Shuaje kandilin!

— U çmende? Ikë, se del im atë dhe bëhet e madhja.

— Bëj si të them, se hyra!

— Mos kështu... si fëmijë!

— Mua po më lot koka, ti...

Hyra. Dhe aty te koka e gurtë e pusit ja thashë të gjitha me një frymë.

— ...Tashti si të duash, merre Rrakon dhe e mbajç me shëndet pendolirën, por ta dish, kur të ta mbërthejnë në fustan, gjëlpëryeri në zemër ka për të të hyrë.

Ajo nënqeshi.

— Pse bëhesh si foshnje, ata edhe gjerdhanë ari më kanë premtuar...

— Mbaji me shëndet, grykën kanë për të ta mbytur.

Dhe ika e kapërceva gardhin me një ndjenjë të papërmbajtur dashurie dhe urrejtjeje, dhembjeje dhe ngashërimit. Po s'kisha hedhur as pesë çape, kur ajo doli te gardhi e më foli:

— Vaso! Vaso! Dale, kthehu!

U ktheva. Unë këtej gardhit, ajo andej.

— Ç'do? Folë!

— Pse je kaq i egër?

— Se ti je e lehtë nga mendtë.

— Ashtu!

— Po.

— Mirë. Ikim, që tashti po deshe, por me një kusht.

— Folë.

— Të ikim që këtu, që sonte, të shkojmë larg, në kurbet. Unë, po u vodha nga shtëpia, nuk rroj dot më këtu, kam frikë, kam edhe turp.

— Jo. Kisha për të ikur, por tashti s'iki. Shpinën nuk ja kthej unë Anastasit, as të birit, e as djallit me të birë. Jo!

Dhe u ndamë. Ajo matanë gardhit, unë më këtë anë.

Por vajzën e patën vënë re tek fliste me mua dhe asaj nate kishin patur sherr në shtëpi. Veç një emtë i mbante krahun, kurse i ati, si i tërbuar, e kishte rrahur dhe kishte marrë vendim ta mbante mbyllur brenda dhe ta ruante ditë e natë. Pastaj kishin nisur një letër për të vëllain e Lisavetës: «Të nisesh një orë e më parë, se jot motër ka lojtur nga mendtë dhe, kur të vish, e merr vesh më mirë».

Dhe që të nesërmen, Anastas Çeturi zuri të hynte e të dilte te Golja si krushk i shtëpisë.

* * *

Ishim në një dasmë asaj nate. Dasmë prej bujku, ku therrej edhe kau i pendës dhe lopa e qumështit e ku turbulloheshin kokët e fluturonin mendtë

nga rakia, therrej në çardhakun lart edhe gomari i shtëpisë.

Kënduam e lojtëm valle sa thamë mjaft... Po Rrakua deshte të dukej e të kapardisej me vallen e këndezeit. Kjo është një valle e çuditshme, më shumë e përzishme se gazmore. Doli Rrakua në mes dhe nxori gjoksin përpara. Përveshi mëngët e këmishës së bardhë prej mëndafshi dhe ngriti lart një këndezeit të kuq me ca si thekë të zeza nëpër pendët. Pastaj nxori një shishe me raki mani dhe me të lagu këndezin kokë e këmbë. U kërkoi sazeve një valle, ndezi shkrepjen dhe këndezi mori zjarr, u mbulua nga flakët mavi. Sapo Rrakua hodhi çapet e para të vallës, këndezi filloi «të këndonte», të rrihte krahët, të çirrej. Mundohej fatkeqi të fluturonte e të shpëronte, por Rrakua e shtrëngonte fort dhe e tundte si shaminë e kuqe të vallës. Dasmorët herë thërrisnin e herë bërtisnin ashtu si i mësonte rakia, kurse gratë shanin e mallëkonin.

Pastaj u shtruam tryezave. Por në një çast Rrakos si duket i kishin ikur mendtë nga rakia dhe, duke dashur të më vinte në lojë, vështroi nga unë dhe ngriti gotën.

— Brompt, ore ti, atje!

U drodha me gjithsej. Heshtje. Sikur ra vetëtimia e tani pritej krisma. Dasmorët u panë sy në sy, një gotë tringëlliu, një maçok nën tryezat po grindej me një tjetër e diç zvarrisnin... kurse unë u kërrusa sado pak, kapa mësallën e tryezës dhe fshiva buzët, se më ishin lyer me lëng jahnie. Të gjithëve u shkoi mendja se do ta pështyja, por unë s'desha t'i prishja dasmën të zotit të shtëpisë dhe e

vështrova armikun drejt në sytë e tij të shëmtuar, ngrita dorën dhe i foli:

— Bromp sa për sonte!

Dhe dasma vazhdoi. Dhe pimë e kënduam, ngri-
tëm dolli dhe u përqafluam, derdhëm raki flokëve,
xhaketa e kapeleve, gjersa nga rakia e pirë dhe e
derdhur poshtë, u qulloshën me rroba, me flokë me
hundë e me opinga. Dhe aq fort sa njëri që u ndodh
më i fortë (se i pirë ish) bërtiti:

— Amani, o shokë, mos ndezë njeri cigare, se
do pëlçasë flakë e do marrim zjarr me gjithsej!

* * *

Një natë të tërë qeni i shtëpisë s'pushoi së le-
huri e s'vura gjumë në sy. Dola jashtë disa herë me
radhë, por s'dallova dot gjë të saktë. Vetëm në një
rast pashë një hije njeriu, që shkau te qoshja e
m'u duk sikur ishte Golja, i ati i Lisavetës. Por
pastaj mendova: «E ç'do të kërkonte ai? Do të më
kenë gënjyer sytë.»

Por në mëngjez rendi ime motër në odën ku
flija dhe më foli me rrëmbim:

— Vaso, Balua është shtrirë në mes të oborrit
dhe ka ngordhur!

Këto i dëgjova symbyllur, se mezi m'u hapën
qerpikët. Kur dola në oborr, në nofullat e kafshës
së ngordhur vareshin ca jargë të gjelbëra. Pra ma
kishin helmuar qenin. Kush? E kush tjetër! Po
përse? Si paralajmërim se ngordhja mund të më
gjente edhe mua! M'u dhimbs qeni plak, me të isha

rritur dhe prej tij kisha gjithë ato kujtime, që ka çdo djalë fshatar për Balon, për Murxhon a për Toron e vet të vogëlisë. Po tani ç'rrugë do të merrnin punët? Çfarë mendojnë të bëjnë anastasët dhe rrakot? Papritur, një mendim më shkoi në kokë: «Helmin s'mund ta kishte hedhur Golja. Jo. Helmi ishte i dorës së Tasit e përpjetë». U dëgjua zhurma e veglës së kuisë prej bakri. Ime motër që po fshinte dhe lante rrugën para shtëpisë, u fut sërish në oborr me fshesë në dorë, me flokët e rrëzuara nëpër linjën e bardhë të kokës. Në pulpët kishte plot pikëza e sum-bulla uji.

— Vaso! Tre xhandarë po vijnë këtej.

— Le të vijnë.

Dhe i prisja, por ata kaluan para shtëpisë, me armët në krahë, me strehët e zeza ulur mbi sy dhe me bote të meshinta në këmbë. Me ta ishte edhe Tasi Gishti. Ky diç u murmuroi dhe ata vështruan nga shtëpia ime. Nuk u kthyen, por e kuptova. Kalimi i tyre këtu ishte një farë presioni, një farë kanosjeje. Kishin ngrënë e pirë gjithë naftën dhe tani donin të më trembnin. Sikur të ngordhja, s'kisha për t'u përuhur. Jo. Kurrë!

Por qarku po mbyllej. Diçka do të ngjiste. Përsëri hyri ime motër në oborr:

— Vaso, sot mos dil, të keqen motra, do të vete të lëroj unë. . .

— Jo. Ti laj hundët e tua!

Vajza mbeti në mes të oborrit me fshesën në duar.

Mbreha pendën e qeve, mora hostenin në dorë, sëpatën në krah dhe vetiu sytë më shkuan te ka-

marja prapa portës. Atje, kur isha i vogël mbaja llastikun dhe, sa herë e ndjeja veten ngushtë, shkoja e merrja. Por tani llastiku im me guralecë e me fiçorë s'më ndihte dot. Duhej diçka më shumë.

Kalova parmendën së prapi mbi zgjedhë dhe u nisa. Shtiza e parmendës zvarrisej në rrugë e në kumin e freskët e pak të lagësht të mëngjezit; ajo linte një vijëzë, një vrage, një zikzake e dredhëzë, por në fund të fundit, shtiza sido që të dredhonte, një rrugë e kish drejt e në arë, atje ku unë do ta shpija me siguri.

Në kohën e mesditës, ime motër më solli drekën në arë. Ishte një lakror me arra pjekur në çerep dhe një pagur me dhallë. Ishte një motër që e kisha në shtëpi dhe për të cilën mendoja se i hanin hundët për të vëllain e Lisavetës. Më hodhi një «puna mbarë» dhe, kur unë e vështrova drejt, ajo uli sytë përdhe. Kur unë i ulja sytë, ajo gëlltitej dhe më vështronte në fytyrë. Të paktën kështu më dukej mua.

— U lodhe, vëlla?

— Jo, nuk u lodha.

— Dëgjova se ja kishe marrë këngës.

— Edhe ai këndezi në dasmë dukej sikur këndonte. . .

— A do të të mbledh ca manaferra të ëmbla?

— Jo, se kam ngrënë ca të tharta.

Ajo u drodh me gjithsej dhe më vështroi drejt e në sy:

— Vaso!

Kjo ishte motra ime, më e vogla, më çapkënja, më e bukura. Ajo që kisha dashur më shumë, ajo

që e kisha rrahur dhe shkukur flokët kushedi sa herë. Sa shumë kujtime më shpërthyen nga ai vështrim i egër dhe krenar. Nuk foli, por u gëlltit dhe lotët ju derdhën tatëpjetë. Tani ishim gati fytyrë më fytyrë e sy më sy. Një qyqe po grindej nga kumbullat, një mëllenjë rrihte me sqep trungun e gorrices, një tog turtullesha po guisnin më tej.

— Vaso!

E kjo thirrje e motrës ishte një klithmë e fortë me zë të çjerrë, e dalë nga zemra, klithmë që kishte dhembje e dashuri prej motre. Shihja prakun e syrit të motrës, atje ku buronin ata lot të mëdhenj si sumbulla e në secilin lot vështroja fytyrën time, e fytyra ime derdhej tatëpjetë në pëqi të motrës. Po përsëri e shihja fytyrën në lotët e tjerë e në bebëzat e asaj që më dukej se lëshonin xixa.

Një tog harabela u ngritën nga shtegu i arës, nëpër ferrat dhe drizat u duk koka verdhashe e Goles. Erdhi gjer atje e s'më tha as puna mbarë, po hyri drejt e në fjalë:

— Ti, çupë, nis u për në shtëpi!

Vajza u bind. Dhe sa pa ikur mirë motra, ai m'u vërsul:

— Përse më bie më qafë, more djall! Se mos u tha fshati nga çupat! Lermë, o djall, lermë edhe mua të marr një copë tokë, lermë të bëhem kamës edhe unë, se mos Anastasi ka lindur me këmishë, do të më japë një copë arë, sot përgjysmë, nesër do të bëhet imja. . .

— Sa t'i pijë lëngun sat bije e pastaj të jep drunë, mos kështu, Ligor, as barin e zgjebes s'të jep pasaniku, e njeh mirë me kë ke të bësh? Ai është i lik në zemër, cingun në shpirt dhe dhelpër në punë, sepse është i tillë, pa ka vënë pasuri. . .

Por Golja s'deshte t'i dëgjonte këto. Përplasi këmbët përtokë, pështyu me inat dhe iku duke m'u kanosur:

— Kur të shikosh majën e veshit. . .

Kur shtrëngoi vapa, çmbreha qetë dhe u nisa për në fshat. Kafshët m'u lodhën dhe e mbanin gjuhën përjashta. Kisha hedhur sopatën në krah, hostenin në dorë e po kthehesha në shtëpi me pendën përpara. Bënte vapë, dëgjohej veç zhaurima e gjinkallës dhe zëri tinzar i mprehtë i zekthit. Kaloja afër kishës nën hijen e plepave. Ishte zheg, ajri dridhej, fletët shamatore të plepave gati i kishte kapur gjumi kur nga oborri i kishës dëgjoj dy zëra, pastaj teshtitjen e njohur të Anastas Gishtit e më pastaj thirrjen e priftit:

— Vaso, o mëkatar i zotit, lëre pendën e qeve, se e pret jot motër dhe eja këtu!

Hodha sytë nga ata. Balli i Tasi Çeturit dukej si një copë rrogozi, kurse prifti dukej më gazmor.

— Urdhëroni e flisni, uratë!

— Po ja, për ty bisedonim, o i krishterë ortodoks. . .

Urata bëri hyrjen me troparin e njohur:

— . . .dhe falna fajet tona dhe mos na shtjerë në ngasje. . . por shpëtona nga i ligu. Amin!

Kjo lutje bëhej për hesapin tim.

— Ç'kërkoni nga unë, uratë?

Prifti tundi krahun dhe nxori dorën nga mënga e gjerë e ramos dhe filloi të më mbante «llogo»:

— Të lësh rrugën e djallit dhe të vish në rrugën e zotit tonë Jesu Krishtit.

— Unë, uratë, s'kam të bëj fare me djallin, ti ndofta. . .

Këtu ndërhyri Anastasi dhe, pa më vështruar drejt, ma pat:

— Pse, more djalë, duke qenë milor, mbrehesh me asllanët? Pse fut hundët në një punë të mbaruar me kohë e të vulosur dhe të firmosur? (Anastasi fliste gjithnjë me gjuhën e seneteve).

— Jo, zoti Tasi, ti s'ke të drejtë.

— More, po mos më trego të drejtën mua, po hiq dorë nga ajo martesë.

— Ashtu? Ti dashke të mbyllet dera ime?

— Jo, ore, martohu ti. . .

— Po me kë të martohem, o?

— Me kë të martohesh! Merr, ore. . . po deshe merr nuse Nënë e Diellit.

Anastas Gishti e gjeti të udhës të më vinte në lojë:

— E ç'jetë do të kalojë ajo goxha çupë në shtëpinë tënde?! Përshesh me dhallë do të hajë.

— Ajo do të punojë me mua e do të rojë si ja do zemra. Pse? Zotrisë sate s'i pëlqen jeta ime?

Anastas Gishti qeshi me cinizëm, mblodhi hundët sa i dolën prej tyre ca qime të dyshimta e i zbuloi aq fort dhëmbët e vënë, sa nofulla e sipërme ju shkëput e nëpër atë nofull laramane gjuha e tij vërshëlleu si nepërkë:

— Jeton bleta në majë të malit, jeton edhe miza nën bisht të kalit! Ha, ha, haha!

— Ti mund të zbardhësh dhëmbët tërë ditën e tërë natën, por Nënë e Diellit le ta marrë yt bir, se Vaso Vasili s'ka ndër mend të ikë kurbeteve dhe të tjerët t'i rrëmbejnë atë që do, si e ke bërë dikur zotrote. . . ore gjak le të derdhet, kurrizin s'ke për të ma parë, ti sot kërkon të qeshësh, por qesh mirë ai që qesh në fund!

— Ashtu? — Anastas Gishti teshtiu, fshiu hundët e krojti mjekrën.

— Kam parë unë edhe të tjerë si ti, po prit, prit, se sivjet lajthitë janë plot e përplot, ja, sa të vijë shkurti, pa do të të shohim edhe ty. Do të vish me gjithë tët motër e do të më lëpish këmbët.

— Unë ngordh dhe s'të bie ndër këmbë ty. Ngordh! E kupton këtë?

Kur e pa prifti se sherri po merrte spicë, e gjeti të udhës të ndërhynte.

— Ti, o i krishterë ortodoks, s'duhet të shkelësh porosinë e tetë të dekalogut që thotë: «Po të shkau syri pas gruas së botës, ke kryer veprën e kurvërimit në shpirtin tënd, prandaj atë sy kreje, nxirre.

— Uratë, më duket se ti po lulëzon nga mendtë. Lisaveta s'është gruaja e askujt, ajo është çupë, më do dhe e dua.

— Ti po fut djallëzinë te djalli, sepse gruaja, sipas dhjatës së vjetër, është ajo që gënjeu Adhamin dhe e çoi në skëterrë, këtë mos e harro dhe prandaj, o i krishterë ortodoks, gruan e varrosin një pëllëmbë më thellë...

— Uratë, ty s'të ka hije...

— Dhe të lutem shumë atë sëpatë hiqe tutje, se s'ta shoh dot, se e di ç'ngjau në darkën e shpërfytyrimit? Pjetri qëlloi Judën me thikë dhe i preu veshin dhe Jesui mori veshin e prerë, e ngjiti në vend me frymën e shenjtë dhe i tha nxënësit të tij: «Pjetër, fut thikën në vend, sepse kush godet me thikë, nga thika ka për ta pësuar!»

— Uratë, kur ta sjellin shpirtin majë hundës, edhe sëpata duhet përdorur.

— Jo, jo, se osmanët e romanët, e galët me

Napoleonin për zjarrin e me shpatën ngritën perandori, që u bënë shkumb e hi, kurse Jesui vetëm me ndihmën e fjalës ngriti një perandori, që sapo vjen e po rritet.

— Këto gjepura, uratë, unë s'i ha, mua mos më nxirrni ferra rrugës, se mua as veshi më mban pluhur e as këmba ma duron gjembin.

Gjer këtu e Anastas Gishti shfryu edhe një herë, ajri ju suall në qiellzë e ju vërvit me zhurmë nëpër hundë, përplasi këmbët e, duke u larguar, më mallëkoi:

— Ikë tutje, satana!

* * *

I qeshë lutur Lisavetës kaq herë: «Dua të të shoh duke punuar në arën time dhe bashkë me ty të punoj edhe unë». Por ajo s'deshte të vinte. «Bëhemis gazi i botës», thoshte e ma mbyllte gojën.

Ishte një ditë e diel, dita më të ngrysur. Ajo ishte argat bashkë me shoqe në një arë për mbushje misri dhe pas pune (që niste me lindjen e diellit dhe mbaronte me perëndimin e tij) ishin lëshuar për të tëharur bar në grunjarët që edhe s'kishin ngalluar. Ato andej lumit, unë këtej dhe kurrë s'ma merrte mendja se ajo mund të ndahej nga shoqet e të hidhej në arën time.

Unë mbusha misër sa u lodha, sa m'u frynë sytë e m'u drobit trupi, por isha i ri e fuqia më përtërihej aty për aty dhe nuk e di përse nuk më ikej nga puna. Pastaj edhe unë gatita katër vandakë me bar e i lidha të katër me legëtyra. Vajzat andej nxitonin nëpër arë, u dëgjoja zërat dhe shihja linjat e

tyre të bardha të kokës nëpër gjelbërimin e grurit. Në një çast dikush më thirri. Njëra nga vajzat, kushërira ime e largët, doli te mezhda e më tha:

— Vaso! O Vaso! . . . a na i çon thasët me mushkë gjer në fshat?

— Gjer në fshat? Thasët? Me mushkën time?!

Isha gati t'i çoja jo vetëm thasët në mushkë, por edhe ato të katra, bile me gjithë thasë dhe më krahë! Tri vajzat e tjera shtireshin sikur s'deshnin të më futnin në mundim, e sidomos Lisaveta. Por kushërira as tërhiqej e as më ndahej. Me siguri edhe ajo e kuptonte dëshirën time.

— Punë e madhe! — u tha shoqeve. — Ne ja shpërblejmë, i hyjmë në arë dhe i mbushim misër, shatat i kemi.

Hodha një çap përpara.

— Kështu, po, pranoj.

— Eja atëhere, eja na i ngarko thasët.

— Ejani ju njëherë. . .

U afruan në breg të lumit e këtu munda t'i shihja nga afër. Edhe ato ishin me sy të enjtur nga të punuarit përmbys mbi misrin. Hynë në ujë të z bathura si ishin, u ranë valëve mes për mes. Lagën pulpat dhe bishtat e shatave në mykat e u futën në arë. Unë ruaja, përgjoja, e vështroja atë e më dukej se po e përpija me sy. Bishtat e shatave i kishin të shkurttra, se po t'i kishin të gjata, s'i merrte njeri për punë.

Mbushja e misrit!

Nga larg duket si një lektisje romantike. Vajza të reja, me llërë të bardha, me sy të ndritshëm, me këngë në gojë e gaz në buzë, në mes të një deti të gjelbër, nëpër fletë gjatoshe si shpata që fëshfërijnë!

Edhe kështu mund të jetë, por është njëherit një punë e vështirë dhe e lodhshme. Duhet punuar kërrusur, me shumë kujdes, se godet rrënjët, aty-këtu dalin edhe filiza fasule e kungulli, imoniku, ka dhe bozilog për erë e domate për turshi, duhet shkrifur toka, duhet tërhequr për t'u mbledhur kumale pas rrënjës, por këto duhen bërë shpejt, se koha s'pret, ara është plot e përplot me misër dhe djersët të kullojnë ballit dhe dreka... misërnike me dhallë ose me narden.¹⁾

Nuk e di përse asaj dite e asaj mbrëmjeje s'më bënte zemra të merrja shatën dhe t'u prija vajzave në punë, as më bënin këmbët të merrja mushkën e t'u çoja barin në fshat, por rrija atje në arë si hu gardhi nën shpotitë e vajzave, që shtiheshin si engjëj, gjoja se s'kuptonin asgjë. Por unë turpin po e haja me bukë e nuk tundesha vendit. Desha ta shihja atë në arë duke punuar dhe mendimi im prej fshatari (mendim i mbujtur në shekuj) më bënte krenar: «Kjo copë tokë është imja ashtu sikurse edhe kjo grua është imja».

E shihja Lisavetën përpara në mes të kërcejve njomëzakë, e kërrusur si ishte, më hidhte ca vështrime qërtimi, por unë s'nginjsha dot me atë patë të bardhë në arën time dhe ndjeja një shqetësim të ëmbël e një gëzim të papërmbajtur, sa më vinte t'ja merrja këngës, të hidhje valle e të rrokullisesha përmbi vandakët me bar, që ishin shtrirë atje sikur do t'ja merrnin gjumit.

Muzgu doli nga lugina e lumit, që andej dolën edhe llapashitjet e ujërave, nga ferrat dolën xixë-

1) Lëngu i zier i kumbullave.

llonjat, kurse ne dolëm nga ara, i ramë lumit mes për mes me mushkën pas. Ato mbanin anën, unë ngarkoja thasët, shtrëngova fort litarët pas kaptellit dhe... ush përpara.

Po binte nata, ishim të lodhur, por ishim të rinj, ecnim nëpër monopetet e arave, nëpër rakitat e holla, yjet regëtinin larg, kurse xixëllonjat na shkonin anembanë duke lënë pas, veç për disa sekonda, atë trajektoren fosforike të dobët e të ndritshme sa mezi ta dallon syri.

Në një çast ajo gjeti mënyrën, m'u afrua dhe më hodhi veç dy fjalë:

— Sonte ruaj koritën e vaditjes.

Koritën e vaditjes! Ta ruaja? Po prej kujt? E prej kujt tjetër...

Kur u ktheva nga fshati në arë që të ngarkoja vandakët me bar... kapa të parin, bëra ta ngre po, për çudi, masa jeshile m'u derdh poshtë e më pllakosi hundëve aroma e barit të njomë. Të katër legëtyrat ishin prerë me thikë. Tinzari s'dukej gjëkund, por unë e merrja me mend.

Arrita në shtëpi. U shtrova dhe hëngra plot një tenxhere me përshesh me dhallë. «Në shkoftë ai te korita ime e vaditjes, do shkojë vonë». Këtë mendim ma ushqeu gjumi e lodhja. «Fle një copë herë e përsëri ngrihem». Sa vura kokën në jastëk, ika menjëherë, por s'di sa kohë pat kaluar kur kërcëva i trembur dhe, me një këmbë mbathur e me një z bathur, u derdha nëpër çardhak, shkallëve tatëpjetë, përplasa portën e shtëpisë dhe u zhduk në errësirë.

Ishte natë e thellë. Yjet ishin larg, të ftohta, por xixëllonin me ca si bishta të hollë pas. Të paktën

kështu më dukeshin mua që rendja dhe fërkoja sytë. Rendja aq shumë, sa e ndjeja të veshi qarkullimin e gjakut. Më kullonin djersët në tëmtha e në gushë, nën sjetull, trupi m'u qull, goja më nxirrte afsh të nxehtë. Zuri më dhembte nga e djathta e barkut, gogësija me shfryrje të shkurtëra e të befta. Desha të arrija sa më parë. Pas lumit kuaknin bretkosat, erërat frynin nëpër gjiret e dëllinjave. Më në fund, pa e ditur se ku ndodhesha, i lodhur dhe i kapitur nga rendja, u përplasa përtokë. Këtu, sa më ndaloj buçima e veshëve, dëgjova gurgullimën e qartë të një kroji; u habita! M'u bë se ai krua s'kishte qenë kurrë atje, sikur s'kishte patur rrjedhur atje, por vetëm tani mbiu ashtu papandehur, sikur e polli nata... Dhe s'kishte qenë vërtet! Zhurmat e ujërave që dëgjoja ishin derdhjet e koritës së vaditjes. Pra ma kishin prishur, ma kishin thyer, ma kishin bërë copë. Sa vrasje e sa gjak është derdhur nëpër koritat e nëpër shtigjet ku ndahet uji i vaditjes! Të kisha kapur njeri, rripa për opinga kisha për ta bërë! Unë e dija fort mirë se kush m'i bënte këto, por duhej të duroja, duhej të prisja, duhej... as unë s'e dija se çfarë duhej bërë!

Të nesërmen, herët në mëngjez, shkova të kositja livadhin. Bari kishte filluar të lëshonte lule dhe gonxhet e tërfilit akoma ishin të njoma. Ja nisa punës me qejf sa pa dalë dielli. Shtrova nja dy brazda dhe po ecja në të tretën kur... krak! Kosa zuri në gur dhe xixa zjarri fluturuan nëpër kërcëjtë e barit! U kërrusa dhe e gjeta gurin! Gur i hedhur atje jo më parë se të djeshmen. Me kohë e kisha pastruar livadhin prej gurëve, por ja që sot kishte plot të tillë dhe jo vetëm ai që më bëri dëmin.

Nxora nga torba kudrën e vogël dhe majthin, e kalita shpejt e shpejt dhëmbin e sapoçelur në tehun e kosës dhe... përsëri ja nisa punës. Punoja dhe mendohesha: «Ku do të dalë kjo punë? anastasët dhe rrakot s'kanë ndër mend të më lënë rehat, po më shpojnë e po më trazojnë edhe atje ku s'të shkon ndër mend. Çfarë u thotë mendja vallë? Duan të më lodhin, duan të më gjunjëzojnë, të më trembin; S'kam për t'u përkulur. Jo. Njëmijë herë jo».

Papritur ndjeva një dridhje në bishtin e kosës, një farë rëndimi, pastaj një fishkëllimë të frikshme... Një gjarpër u pre më dysh nga tehu i kosës, zvarraniku kërceu përpjetë me kokën lart, por kërceu lart nja katër pashë, trupi i tij i sakatosur shndriti një çast nën rrezet e diellit, unë u zbrapsa një çap, ngrita kosën lart dhe e qëllova edhe një herë. Dhe përsëri kosa e sapokalitur e preu më dysh. Por koka... duhej shtypur koka! Ju vërsula atje ku ra, nëpër bar, hidhej, përdridhej, shkiste dhe dalloja qartë gojën e tij të helmët dhe shigjetëzën e zezë që e lëvizte me një shpejtësi të çuditshme duke m'u kanosur edhe me atë si kokërr bizeleje të gjelbër mu nën qiellzë... Ja vura këmbën mbi kokë dhe i rëndova. Nëpër shputën e llastiktë të opingës u përhap helmi i gjelbër.

Pas disa ditësh, me qetë përpara, shkova në arë që natën. U nisa nën zhurmën e shtizave të parmen-dave që zvarriteshin rrugëve dhe nën trokëllimën e kllapave të drunjta të portave. Ishte koha kur shtrohej vesa e pikonin qershitë. Hyra në arë dhe nisa të lëroja. Toka e ugarit ishte e butë nga shiu i ditëve të para dhe kishte vlagë. Frynte erë pas shelgjeve të lumit, shkumëzonte lumi më poshtë, pastaj, pa-

pritur, një cicërimë zogu, një, dy, tre. Filloi të gu-
mëzhinte korija përtej. Bilbilat u zgjuan nga ai gjumi
i ëmbël i mëngjezit dhe ja nisën këngës së tyre.
Pastaj u ndalën një grimë si të habitur nga cicërimat
varfanjake të harabelave, sikur u mërzhitën nga brit-
mat monotone të qyqeve dhe përsëri ngritën lart
sqepëzat e tyre të vegjël e nisën të këndonin drejt
hapësirës me ata zëra gazmorë e të dredhur si ka-
mbana të qiellit e të ëmbël si timpane të argjendë.
Errësira nisi të çartej nga shtiza drite. Përrenjve
zu të rrökullisej nata. Qielli po ndriçohej dhe papri-
tur ra një heshtje në korije dhe në ferrat. Shpeshët
e ndalën këngën, heshtën një çast! Pse? Po lindte
dielli! Ai nxori vetullën e tij prej rubini të përfla-
kur. Zogjtë e panë dhe ju falën. Veç njerëzit nuk
heshtnin para kësaj mrekullie. Njerëzit nëpër fu-
sha, të mësuar me lindjen e diellit ditë e përditë,
thujse nuk e vunë re fare.

Por tani më duhej të lija mënjanë diellin dhe
zogjtë e të vrisja mendjen për atë brengë, që po
më hante e po më brente. Dola në krye të brazës
dhe hodha sytë nga fusha. Diku dallova Simo Naçin
tek ecte kërrusur pas kulprave. I hoqa otreshin
pamendës e u nisa pas mezhdave me tërfil. Sa u
afrova... shtanga...! Te cepi i arës, nëpër ferrat,
dalloj Simon në pritë me sëpatën ngritur. Dikë pris-
te, dikush kanosej nga ai teh i mprehtë. Sa bëra
t'i flisja, ai m'u lut me duar, me sy, me buzë bile
edhe me rrudhat e ballit që të qëndroja dhe të
heshtja. Hej, drej o punë! Ç'ka ky njeri? Vallë
Anastasin pret kështu me sëpatën ngritur!

— Shëët!

Afroi bishtin e sëpatës te hunda e vet, u shëm-

tua keq në fytyrë e përsëri m'u lut. Krejt qenja e tij sikur më thosh: Aman mos folë, prit!

Kur papritur, plaku kërceu e u vërsul, sëpata e tij qëlloi e ai bërtiti:

— Hë, qen, de, se më plase!

Dhe pastaj me zë të ndërruar:

— Hajde, o Vaso, hajde, tashti, afrohu!

U hodha përpara dhe me një frymë u gjenda përballë tij.

— U trembe a? — dhe më tregonte përtokë... një iriq i vrarë, i prerë më dysh. Iriq i zi me atë turirin si noçkë.

— Më batërdisi ky i shkretë, m'i griu rrënjët e misrit, gjer sot e ruajta dhe i punova qëndin.

Buzëqesha.

— Vonë e ke misrin, xha Simo!

— Ç'të bësh, o bir, e mbolla një herë arën me buxhak, kjo e mbjellë është herë e dytë.

— E di, xha Simo.

— Fukarallëku; unë e bëj si ai miku, dua të marr dy lëkurë nga një kec.

— Të dy ulëm kryet. Plaku vazhdoi:

— Por s'do t'i ndahem, do t'i rri sipër me plehë e me të vaditur.

— Mirë, po vallë do arrihet?

— Në punoftë edhe reja...

— Po s'punoi...?

— Po s'punoi! Merr Lisavetën për dore dhe eja nga tetori të hamë misra të njomë.

Zbraza frymën dhe, duke vështruar plakun, qesha me krejt fytyrën.

Papritur, Simua ngriti kryet dhe fytyra i mori një pamje krejt tjetër:

- Po... a e more vesh?
- Çfarë?
- Po ta shkojnë ujët ndënë rogoz, po ta futin në valle edhe tët motër. Nxitohu, se përndryshe do të të iki zogu nga dora. Ç'pret më, vajzën e mbyllën brenda si një bagëti, e rrahën, me litar e kish lidhur i ati, ai hajvani. Sollën edhe xhandarët që të të trembin.
- Po me zor s'mund ta martojnë.
- Të kesh frikë nga i ligu dhe nga budallai, djalë. Se janë takuar dy kokë: Anastasi dhelparak nga njëra anë dhe Golja gomar nga ana tjetër. Prandaj, dëgjomë mua, të ligut vëri ligësinë, dhelparakut bëju dhelper.
- More, xha Simo, po a e di ti se ç'më bënë një natë?
- Hë...
- Ma helmuan qenin.
- Ashtu! — plaku hapi sytë dhe egërsoi fytyrën.
- Duan të më trembin, xha Simo.
- Jo. S'është aty puna, ata duan të të vjedhin, e di mirë unë...
- Të më vjedhin?
- Po. Thonë se ti i ke lidhur magji Lisavetës dhe tashti duan ta zgjidhin magjinë, e mirë po... për t'u zgjidhur magjia, duhet një plaçkë e jotja.
- Po mirë, mund ta gjejnë.
- A... jo... duhet që ta vjedhin natën sa pa dalë hëna, për ndryshe nuk zihet magjia.
- Simua u mendua një copë herë:
- Dëgjo, Vaso, Goles i duhet vënë festja pas kokës.

— Duhet.

— A më lejon t'ja vë unë?

— Vërja.

— Do t'i them: Që të zgjidhet magjia, mund të vjedhësh edhe misër në arë të Vasos, por, meqë është jashtë shtëpisë, duhet që vjedhjen ta bëjë vajza vetë dhe ti ta ruash pas...

— Po a dëgjon ajo?

— Shkoj dhe i them unë nga ana jote, të bindet dhe të shtihet si e shastisur. Ajo e di se ç'e pret tashti, i vajti në shtëpi kapteri me dy xhandarë, nuk i lanë fjalë pa thënë... dhe ta dish, po erdhi i vëllai, ai është i rrëmbyer dhe i krisur nga mendtë...

— Po këto, a do t'i hajë Golja?

— Kur të pëlqen e ha.

— Po më ngjet si në përrallë.

— Po edhe përrallat kështu kanë marrë krye. Golja një copë mish me dy sy është, vetë kërkon ta futë kokën në kapistall që Anastasi pastaj ta heqë zvarrë, ta ketë edhe krushk, edhe hyzmeqar. Kërkon me çdo kusht një copë tokë, si ai qeni që zuri kockën e theu dhëmbët.

— Po ti, xha Simo...

E nuhati mendimin tim dhe s'më la të mbaroja..

— Unë... kështu... sepse Anastasi, i biri, i ati, i gjyshi dhe katragjyshi, brez pas brezi kanë bërë si u ka dashur qejfi edhe me njerëzit, edhe me tokat, edhe me vijat e vaditjes, edhe me çupat e bukura. Pastaj (këtu fytyra e plakut sikur u nguro) Anastas Gishti vetë më ka punuar qindin kur isha i ri.

— Domethënë e shoqja e Anastasit...

— Jo, jo, ishte një tjetër. Kur u ktheva nga kurbeti, e gjeta grua të Tasi teknefesi, rrojti tre muaj dhe ra e vdiq...

— Po, për këtë diçka kam dëgjuar.

Heshtje. Vështronim ndër këmbë. Thneglat u sulën pas iriqit të vrarë, tehu i sëpatës vezullonte në diell.

— Dhe nxitohu, djalë, nxitohu, se ja, ja...

Me majën e opingës së vet Simua më tregoi iriqin.

— Ky është Anastasi, ky është Rrakua, vrima nën dhe hapin ata, se për zanat e kanë, për zanat dhe për zemër, dëgjomë mua, djalo... Dhe një fjalë të fundit... këto ditë ha sa të mundësh thana të kuqe e lajthi të pikuar.

— Po përse këto?..

— Lëngu i tyre të jep kurajë kur piqesh me vajzën.

Në gusht, kur kërcasin kallëpët e misrit, nga lëngu i tepërt lëshohen baldosat që nga strofullat e tyre dhe bëjnë kërëdinë nëpër ara. Dhe prandaj netve të gushtit ndizen zjarre anës së arave me misër dhe djemtë e fshatit varin drurëve teneqe të vjetra, që i rrahin me çomage, tundin këmborë e zile, sepse gjuhët e flakëve dhe tingujt e këmborëve e trembin baldosën vjedhacake.

Ishte një natë e tillë. Fusha mbase donte të flinte, burimet mbase donin të dremitnin, edhe lumi ndofta donte të përgjumej, por s'i linin të qetë as zhurmat, as këmborët e as këngët e djemve. Gjithë-sia dukej e zezë dhe **veç** zjarret skuqnin si mullarë prej flake. S'më nxinte vendi, sepse nga lindja ishte

një shirit i gjerë prej resh e, kur të dilte hëna...
Ja këtu qe e gjithë puna... kur të dilte hëna!

Dikush qëllonte teneqenë me shkop, të tjerët
rrinin kërrusur pas zjarrit, çobani i shqerrave nu-
mëronte me shkop çetelet që ishin ditët e punës së
tij, të tjerë piqnin misra të njomë, i vërtitnin si
peshq nëpër shpuzë, pastaj, që të merrnin shije, i
mbështillnin me ceflat e gjelbëra. Dukej njeriu nga
larg sa ishte brenda fjollës së flakëve, por, sa hidh-
te tri-katër çape, si me magji humbiste në errësirë.
Kurse mua s'më nxinte vendi. Duhej të fshihja
shqetësimin, sepse një fjalë ose një lëvizje e tepërt
mund të më kushtonin shumë. Më dukej se jetoja
dy net së bashku.

Por nata ishte shumë e bukur! Po më thithte me
tërë magjinë e saj.

— Po ti, Vaso, s'ke frikë nga baldosat?

— Kam mbërthyer ca purteka te shelgu i për-
mbysur mbi lumë, rrjedha i godet purtekat dhe bë-
het zhurmë, baldosa s'afrohet:

— Qenke i zgjuar! Ua ke hedhur baldosave!

— Ai ja hedh kujt të mundë!

— Ku t'i ndezë!

— Ku t'i dalë!

— Gjer t'i dalë!

S'kisha as kohë e as kokë për t'u përgjegjur.
Mërzeja rreth zjarrit dhe s'merrja dot vesh se ç'kohë
ishte. Këndezat e fshatit gjer këtu nuk dëgjoheshin,
orë s'kisha e s'më mbetej veçse të numëroja rrahjet
e zemrës. Por atë natë edhe zemra më rrihte shumë
nxituar dhe s'dija nga t'ja mbaja. Orë kishte i
biri i Tasi Gishtit, ai ishte në një zjarr më tutje,
por atë s'mund ta pyesja kurrsesi.

Papritur, nisën të dëgjoheshin ca tinguj kitare, vegla më e re në fshat. E kishte Rrakua dhe i binte mirë. Nuk e desha, por i jepja hakun. . .

Dëgjoheshin tinguj kitare nën shelgjet, në mes të arave me misër, në mes të livadheve të kositur, në mes të cflimave të bulkthëve, tinguj kitare nën dritën e largët të yjeve, nëpër gurgullimën e përrrenjve, nëpër murmurimin e krojeve, nëpër frymëmarrjen e burimeve e nën murmurimin e lajthishteve. Edhe vetë dikur (nga zilia e marazi) pata marrë ndër duar një kitarë. . . por hə, hə. . . gishtat e mi dashur padashur kapnin nga dy tela e më shumë. . . Duar bujku e druvari, merre si të duash.

Shokët filluan të më gërgisnin:

— O djema!

— Hë?

— Ama e bukur ajo çupa e Goles!

— Fshiji jargët, fshiji!

Dikush këndonte:

*Të prita te gardhi, më dole te muri,
qepallat e gjata, si hala prej gruri!*

— A vemë për dardha, o! (Vemë» kish edhe një «vjedhim», por këtë s'e shqiptonte njeri).

— Unë jam gati, a vjen, o Vaso?

— Jo.

— S'i paske qejf dardhat a?

— Hajde, o Vaso!

— S'janë arrirë, jo.

— Ja, për atë bukë, janë arrirë!

— Ou, ti i nxjerr dyzet ujqër nga një drizë!

Xhelua hoqi gunën mënjanë dhe nxori një hel-

metë të vjetër. Helmetën e mbante pas bririt, që kishte përposh. Ishte helmetë austriake nga të princ Jozefit dhe ishte plot me dardha. Cipa e tyre vezullonte paksa në dritën e zjarrit.

— Merr, Vaso, ka edhe të buta, ta mbushin gojën me lëng të ëmbël.

Xhelua diç trazonte mbi zjarr. Kishte një enë balte dhe në të trette plumba.

— Ku i gjetët, o?

— Ka sa të hanë lopët, pllajave e brigjeve.

— Është bërë luftë këtyre anëve.

— Po tashti ç'i doni, o?

— Ku dihet, o! U vjen dita, o!

— O shokë... më pihet ca qumësht!

— Vemë nga Shefkiu!

Gjer atje dëgjoheshin tingujt e një fyelli më të qarë, i binte fyellit Shefkiu që flinte me dhentë në ugar.

— Hë, mo, do t'i vemë Shefkës?

— Ai s'ka mashtrapë, s'ka si e pi qumështin.

— Punë e madhe, vëri buzët dhe pije si e ke pirë te jot ëmë!

Të dy shokët ju vërsulën njëri-tjetrit, u përfytën duke qeshur, u rrëkëllyen, u shgërryen dhe u zhdukën nga fjolla e dritës. Dëgjoheshin gërgitjet e zërat e tyre hendeqeve.

Reja e zezë, deshte të na fshihte, por era... era, që më rrëzoi nga maja e plepit, ajo më erdhi në ndihmë! Ajo fishkëlli pas lumit e nëpër dëllinjat dhe u ngjit lart në qiellin dhe atje fshiu renë e zezë. Disku i hënës kishte dalë i tëri përmbi Malet e Viçit. A isha tepër vonë? Një hije e zezë m'u duk se shkau përpara. A thua Golja të ketë qenë aq me

mend sa të vijë e të më ruajë? Ara ime ishte nga lindja e unë u nisa drejt perëndimit:

— O Gaqo! Po vete gjer te Burimi i Qezarit!

Dhe që nga fjolla e dritës së zjarrit, humba në errësirë drejt perëndimit. Me një frymë u gjenda tek ara ime. Heshtje. Qetësi. Natë. Hëna që atje lart më dukej se më jepte zemër. Këtu duhej të kishte zhurmë, e, sapo erdha vetë, u vendos qetësia. Vura veshin. Asgjë s'pipëtinte. Por ajo heshtje më dukej se ishte gënjeshtare. Papritur diçka zuri të pikonte. Po. Po. Nga thesi i mbushur plot kallëpe misri të njomë, nga thesi i shtrënguar me litarë dhe i ngarkuar në shpinë, pikonin pikëla lëngu të gjelbër. Lëng i gjelbër nga ceflat e lëng i bardhë si qumësht nga misri njomëzak. Lëng pikonte, sepse ishte gusht, koha kur kërcasin kallëpët e misrit nga lëngu i tepërt. Ajo medoemos ishte fare pranë. Ju derdha sipër.

— Lisaveta, jam unë!

Ja kapa litarët e tendosur, i kishte të lidhur nyje mbi gjoks. Bëra t'i zgjidhja, por gishtat s'më dëgjonin fare, nuk i zgjidhja dot dhe shkoi e vate, thuajse litarët kishin hyrë në gjoksin e saj. Atëhere shkula kosarin nga brezi dhe preva... litarë, spangon, një bisht të gërshetit të saj që ishte mpleksur atje dhe thesin e tërë! Shkanë tatëpjetë kallëpët e misrit si peshq krapinj dhe litari u bë copë-copë. U përhap aroma e misrit qumështor, e fletëve me vesë dhe e xhufkave të njoma.

— Aman, Vaso, do vijë babai, shpejt!

Por Golja s'kishte qenë aq budallë. S'e pashë, por ato çape në arë, ato misërishta që thyheshin krap e krup... Ish i tëri ai, sa të më fliste, i fola:

— A... kështu e mëson tët bijë ti... të vijë natën dhe të më vjedhë misrin?

— I biri i Nases, me tët atë kemi qenë si vëllezër!

— Lëre tim atë atje ku është, Lisavetën e dua dhe më do dhe do ta mbaj.

— Kurrë!

— Atëhere do të thërres berihaj dhe të mbli-dhet këtu fshati i tërë, ju kapa me thes në duar.

— Thirrë, por ta dish, do vijë edhe Rrakua, ai ka edhe kobure!

— Edhe top le të ketë, ja marr dhe ja hedh në...

— Hiq të them.

— Baba, mos, dëgjo...

Dhe fjalë pas fjale biseda u nxeh dhe sherri plasi. Një e prekur, një e shtyrë, një e sharë dhe ai vjen e ma lëshon kopaçen mbi kokë sa bota më erdhi rrotull, hëna m'u duk diell, yjet m'u vërsulën nëpër arat me misër. M'u drëdhën mendtë dhe gju-njët, por s'kishte as vend për t'u përmbysur e as për t'u rrëmbyer e as për kokë shqiptari! U mbajta. Unë e di se si u mbajta.

Por ai s'u ngop me aq dhe m'u lëshua sipër. Instinkti për të mbrojtur fëmijën... Hajvani, pandehte se e bija ishte një copë tokë, një mëshqerrë ose një copë mish dhe po ja vidhnin. Gomar fare, dyfek i plasur, nga ata të moçmit.

Nga përfytja jonë gati një shinik vend i arës sime u bë shesh e lëndinë. Misërishtat kërcëllitnin, shtriheshin, kallëzit e misrit këputeshin e përplase-shin, toka e prashitur me preshajkë dhe e mbushur kumale me shatë ishte e butë si sfungjer. Ishte imja dhe më dha zemër të mbahesha dhe të duroja. Li-

saveta na vinte pas duke kyçitur gishtat e duarve, duke shkukur flokët, duke u lutur me një zë të tillë, që do të kishte zbutur edhe ujçërit e Përroit të Hajdutëve!

— Amani, mosni! Amani! Vaso! Baba! Mblidhni mendjen, u bëmë gazi i botës!

Ishte natë, veç hijet e shelgjeve shtriheshin nëpër arë, dëgjoheshin shkrofëtitje dhe gulçime.

Hëngra aq shqelma e aq grushte, por unë s'e qëllova asnjëherë. E vura poshtë, supet përtokë, gju-rin mbi gjoks, inatin me kokë, por inatin s'ua dhashë krahëve. U mbajta dhe i fola:

— Mjaft! Fëmijët e mi do të jenë nipat e tu, nga kjo tokë do të ushqehen.

— Hiqmu!

— Ti më rrahe sa deshe, unë dorë s'të ktheva...

— Qëromu tutje, çupën e kam të fejuar.

— Ama, dashke ta shesësh si thes me kashtë!

— Baba, kot, e ke, unë...

— Ti e ke fajin, bushtë!

— Ti më solle këtu.

— Ajo është tjetër punë.

— Aaa... do të më bëje magji, o Gole?

— Do prishja magjinë që ti i ke bërë sime bije.

Plaku u grrit, gulçoi fort, vështroi anembanë.

Përsëri i fola:

— Dëgjomë...

— S'dua të të dëgjoj... sapo vajti puna gjer këtu, (dhe psherëtiu) ajo të kthehet në shtëpi...

— Kurrë!

— Vaso, bindu, e ke prind!

Por ju thashë që në krye, Lisaveta ishte ca naive, si lulja e bajames.

— Jo — ju gjegja — ti zgjidh e merr, ja këtej, ja andej.

Tani hëna kishte marrë tatëpjetën e po zbriste nga perëndimi drejt një shtrati me re të murme. Po shtrohej vesa, po zbeheshin zjarret nëpër ara. Koriya me akacije «Grazhdi i Bletëve» po oshëtinte nga flladi i agimit.

Golja u ngrit, u shkund nga dheu, që kishte përsipër e, duke përplasur hapat nëpër arë, iku e u zhduk drizave i kërrusur, kokëzbuluar, shpatullrëzuar, në çdo çap që hidhte, i lëkundej koka.

Etja më kishte bërë shkrumb gojë e buzë.

— Eja!

U shtrung¹⁾ pas meje e s'deshte të psherëtinte. Ndaluam te «Grazhdi i Bletëve», përfundi te Burimi i Madh. Nata ja kish mbuluar ujërat me petalet e trëndafilave të egër. Mezi shquhej në errësirë përskuqja e petaleve të bardha, po përsëri shquhej.

Dhe Burimi i Madh regëtinte ngadalë dhe petalet lëkundeshin e dukeshin si flutura, që donin të ngriheshin e të fluturonin.

1) U shtrung — u ngjesh, u afrua, thuhet vetëm për njerëz.

NJË DITË NË MES TË PYJEVE

Kisha shkuar me pushime në një fshat të largët malor që, pa e tepëruar, mund të them se është i tëri i kredhur midis pyjeve. Lartësia këtu është nja njëmijë e shtatëqind metra mbi nivelin e detit dhe medoemos frymëmarrja është pak e vështirë. Por megjithatë njeriu e ndjen veten të lehtë, këtu, s'ngopesh dot me gjumë, s'ngopesh dot me bukë aqë sa pleqtë e thonë me shaka: «Këtu edhe haliçe të hash, stomaku t'i tret!»

Midis shumë njerëzve që patën ardhur si unë, ishte edhe vajza që po mbaronte fakultetin e letërsisë dhe për të cilën pandeha se ishte e huaj. Por shpejt e kuptova se ajo ishte vajzë e këtij fshati, e kthyer tashti vonë me një brengë të madhe në zemër. Marieta — kështu e quanin atë — kishte sjellë krejt librat e fakultetit, kish marrë me vete shkrime e dorëshkrime, tekste e dispensa dhe gjithë ditën e diellit rrinte e kërrusur mbi to. Vajza desh të zgjidhte temën për mbrojtjen e diplomës dhe po ta shohim hollë-hollë, një punë e tillë është mjaft e vështirë.

Një mesditë u ndodha me disa të tjerë diku te një krua i madh i fshatit, kur dëgjoj njërin që thoshte:

— Ejani nesër me mua! Ejani, se do t'ju shpie nga Liqenëzat, në një vend ku luleshtrydhet do t'i

mbledhim me shporta, salepin me thasë e çajin e malit me dengje e me vandakë. Në paçi frikë se mos ato kokrrat erëmira shtypen apo shtrydhen në kaçilet, mund të shtrihemi barkazi e, pa i kapur me dorë, por veç me buzë, të ngijemi se tashti janë arrirë, po kullojnë lëng e përhapin një aromë që të prish mendjen.

Ky që fliste kështu ishte Jani. Dhe Jani është për t'u besuar se ai i njuh shtigjet me gishta, i njuh malet me pëllëmbë, Gramoz e Moravë bashkë.

Dhe ne, që si thashë, kishim vajtur për pushime në ato anë, dhamë fjalën për një shtegëtim që të niste me lindjen e diellit dhe të mbaronte me perëndimin e tij. Disa prej nesh ishin vendës, ne nja dy të vajtur dhe pranuan Janin për udhëheqës meqenëse ky është bërë gjahtar që atë vit kur kapërceu një plevit me ujë.

— Sot dhe sa të më punojë dora e këmba — na tha Jani — s'kam ndërmend të ndaj nga vetja as çiften, as gjerdhanin, as çantën e bile as edhe palcoren e vjetër prej komiti! Për plevit e përpjetë, për plevit e tatëpjetë, ilaçin e kemi pyjeve e maleve andej nga sitet ajri i kulluar që t'i jep gjakut një vërshim të tillë sa, fare pa droje mund t'i thuash Flemingut¹): Rrofsh dhe më të lumtë për të tjerët! Sa për mua, rroftë pylli, rrofshin edhe ato kokrrat e dëllinjës që unë i pi me çaj, rrofshin edhe kokrrat e trëndafililit të egër që i ha me grushta. Pastaj do t'u çoj edhe nga Vëra e ariut, atje ku më doli ai i mallëkuari e... kur punoja me rininë në Tropojë më 1945...»

Fjalëve të Janit ne u bëjmë një zbritje me për-

1) Aleksandër Fleming, shpikës i penicilinës.

qindje që disa herë e kalon numrin nëntëdhjetë e pesë!

Por sidoqoftë sot Janin e kapëm keq në një fjalë:

— Po Flemingu, o Jani, ka vdekur, a e di ti këtë?

Ai u gëlltit e vështroi anembanë, por na shkaut si ngjalë, falë asaj gjuhës së tij të shkathët prej gjahtari:

— Njerëz si Flemingu nuk vdesin kurrë!

Kështu që u nisëm të nesërmen herët në agim.

Ishte mug, qielli ishte i larë, kuqëlonte nga lindja e malet e mëdha anembanë po shkundnin mugëtirën e natës. Hije nëpër gropat, lagështi e vesës ndjehej, edhe pak ftohtë, por fare pak. Aromat e pyjeve vinin nëpër çatitë e mbuluara me rrasa guri e derdheshin nëpër rrugët e ngushta të fshatit duke trazuar qetësinë e trandafilave, të luleshëngjinit edhe të atyre luleve me kërcëj të gjelbër, që kanë ca vile të kuqe si gjak. Gurët e kalldrëmeve ishin të qarkuar me atë barin, që zvarritet udhëve e, ky bar i hollë (si një tërfil në miniaturë), e kishte pikuar vesën përmbi gurët.

Më lejoni tani të paraqit anëtarët e grupit, apo personazhet e tregimit ash'u si dolën një nga një kur ne u kalonim ndënë shtëpi dhe u trokitnim në dritare me një shkop të gjatë, që qëllonte xhamet e trazonte filizat e bozilokut nëpër saksitë.

— Mirë mëngjez, xha Llazo!

Nënqeshi me ata sytë e zgjuar e të vegjël e rrudhat e shumta të fytyrës sikur i lëshonin atë nënqeshjen e tij me një ironi të dukshme:

— Mirë mëngjez, o ftujakë!

Në krah kishte torbën, në duar shkopin, plaka

i futi në xhep pagurin e plumbtë, hodhi shkopin në dorën e majtë dhe nisi të ngrinte të djathtën për të bërë kryqin aty në prak të portës, por ndërroi mendje, se na vështroi ne me Janin...

— Nisemi?

Që pas ju derdhën nja tre kalamaj të përgjurmur, por të shkathët.

— I kam nipa, më erdhën mbrëmë nga Tirana për pushime. Hej, ti Fatos! Mbylle dyqanë!

U bind i nipi kokulur, po përsëri qeshi dhe ju bënë dy gropëza ndër faqet.

Edhe se ishte mëngjez dhe ne s'i kishim marrë të plota xhirot e bisedës, na la vragë fytyra njomëzake me qukëza dhe këtë hijeshi të Fatosit e brohoritëm. Qeshi xha Llazua, po përsëri psherëtiu:

— Sa më mirë sikur ta kishim vajzë!

Disa tinguj kitare. Kthiem kryet andej. Po na afrohej inxhinieri i ri Nail Kalindi, sapo larë e rruar freskët, plot jetë e gjallëri, me një vështrim pak krenar dhe si i nxituar. Kishte një këmishë të gjelbër me kuadrate të zeza me dy kopsat e sipërme të shkopsitura. Në duar mbante kitarën, në krah një pushkë sportive të ngarkuar ca si tepër me instrumenta e tejçyra.

Naili është qitës i njohur në gjithë vendin.

— Mirë mëngjez, xha Llazo! Mirë mëngjezni, o shokë!

— Mirë mëngjez, o pëllumb i Llazos!

Një dru mani po pikonte vesë nga fletët e tij kur notat e kitarës kumbuan në një copëzë gazmore dhe ja atëhere trokëlliu kllapa e drunjte e një porte, fërfëlloi një fustan që kishte të bënte me fletët e

manit që pikonin vesë, pastaj u dha në prak personazhi më interesant i ditës. Ishte Marieta Mendizi, vajzë njëzet e një vjeçe. Moshën e saj nuk e përcaktonin as dosja që kishte në njërën dorë, as çanta që mbante në tjetrën, por vetë Marieta që shkëlqente në gaz e në risi.

Vajza ka flokë të gjatë e të verdhë dhe sy të zes (një përjashtim që natyra e bën më të rrallë). Por ka një dendësi të tillë flokësh si një shpërthim vitaliteti dhe bukurie. Korit tonë të urimit mëngjezor, ajo ju përgjegj me një buzëqeshje, që i takonte pikërisht njeriut, të cilin ajo nuk e vështroi në sy.

Edhe se e nisur për eskursion, Marieta është veshur bukur e me shije, ashtu si i ka hije një vajze, që po mbaron fakultetin. Në grykë fustanin e ka të mbyllur me një kopsë të vetme, nga e cila i varen tri-katër fije të bardha, që mbajnë katër kokrra të kuqe si fruta koçimare. Sa për cilësitë e tjera të vajzës, këto do t'i tregojmë «në lëvizje», si thonë piktorët.

Te një portë tjetër, jashtë fshatit, u vonuam e bashkë me aromën e bozilokut na dyndi nuhatjen era e djathit të butë, pastaj e një kulaçi të grunjte që, si dëgjohej, sapo ishte zbuluar nga shpuza dhe dikush po ja rrihte me gishta koren e sipërme: gup gup gup! U këputën disa fletë pjergulle.

S'di përse në ato çaste ra heshtja në grupin tonë, telat e kitarës s'u trazuan më, dëgjoheshin vetëm frymëmarrjet e ne fusharakëve, që në lartësi të tilla, ndihen më të qarta. Ja, ishte në këto e sipër kur u dëgjuan flatra shpendësh nëpër uturimën e ajrit, dhe, tek ata tre shkëmbinjtë e kuq aty më lart, erdhën e qëndruan katër thëllëza mali! Ne,

me një marrëveshje të heshtur, mbajtëm frymën për të vështruar atë si vegim të rrallë, që na e dhuroi ai mëngjez vere, si premtim për orët e mëvonshme. Duke gëzuar dhe kënduar, ata zëra gazmorë shpendi, s' di përse m'u bë se kishin diçka të përbashkët me tingujt këmbëngulës të kitarës. Ndofta sepse thëllëzat këndonin e njëherësh vështronin larg, sikur që larg do të afroreshin flatra thëllëzash të tjera! Mbetëm ashtu në përgjim dhe në një çast pashë flegrat e Marietës, që u drodhën, kurse mua m'u kujtuan vjetët e largët të fëmijërisë dhe fushat me dëllinja e shtegëtimet javore për të gjetur fole thëllëze që s'ka djalë fshati që mund të mburret se ka gjetur. Dhe kushedi sa do të vijonte vegimi ynë, kur Fatosi, çunaku me gropëzat në faqet, foli:

— O baba Llazo, këto thëllëza qenkan ngarkuar me thana të kuqe, nga një paskan në sqep e nga pesë a gjashtë i shtrëngojnë ndër thonj...

Por thëllëzat ikën në çast duke përplasur krahet nëpër ajrin e mëngjezit, kurse thanat e djaloshit i morën me vete!

Ishim pak a shumë ndër këto kur u hoq një lloz dhe u çel porta. Në fillim dolën nja pesë a gjashtë kalamaj, pastaj doli xha Tasi, një plak bojalli me nja tetëdhjetë e ca vjet në shpinë, me një fytyrë të kuqe, flokë krejt të bardhë e sy të kaltër. Ndër faqet ka edhe ca si njolla të errëta që të kujtojnë jetën e tij prej mërgimtari nëpër minierat e botës që nga Australia në Argjentinë e gjer në Evropën e Perëndimit. Mban një kostum të errët, një kravatë me ngjyra të ndezura, një paletë këpucë me qafa, por fare pa ripëza, veçse me nga një gjuhëzë llastiku, këpucë praktike për një plak aq të gjatë, që e ka

zor të përkulet për t'i mbathur. Në duar ka dy çanta të rënda, në kreun e njërës përpiqen e trokëllinjë tri gryka shishesh.

Xha Tasi ka një veçori në të folur. Flet sikur mban fjalim dhe fjalët i thekson fort, sikur i numëron germat nëpër gjuhë një nga një që t'i dalin të qarta, të kumbueshme dhe me një si afsh të thekshëm të kraharorit.

— Po si m'u gdhitë, o bij të dashur?

Lëshoi çantat përtokë, na zu për dore të gjithëve, kurse kalamajtë i përkëdheli, pastaj ngriti krahet lart dhe ktheu fytyrën nga pyjet:

— Sot do të kënaqemi nëpër male! Ta dini nga unë! S'ka si mëmëdheu...!

Pastaj, duke u kthyer nga shtëpia e vet:

— Natali! O mbesë e dashur! Na e jep këtej atë të uruar bulirë! Dua të pi ujë me atë, atyre burimeve, mban erë dëllinjë dhe fshat! Eëë ashtu! Pa shih, i paskan vënë edhe pipë prej gëzhoje! Ja kështu më pëlqen mua! Me pipëzë të verdhë! Ore, dëgjomëni mua... s'ka si mëmëdheu!

Xha Llazua kishte vënë përpara gomarin, kurse një kërric i njomë dhe i bukur, me një zilkë në qafë, na u derdh nëpër këmbë sa fëmijët u gjallëruan dhe u lëshuan pas tij.

— Dale de, dale, do t'ju hipi nga tre e nga tre në gomar!

— Jo, jo, unë do të hip mbi kërric!

— Po ai është i vogël!

— Jo, jo, dua, dua...

— Ti do, por ai të hedh poshtë e të bëhet koka me gjak.

Në grupin tonë shikimet po kryqëzohen dendur që tani në mëngjez. Jani mundohet të fshehë një

nënqeshje dhe dorën e mban të kapardisur përmbi grykën e çiftes, kurse xha Tasi po brohorit për natyrën e për mëmëdhenë, për krojet e për ujërat. Mua s'di përse më kujtohet mushti i kuq i rrushit!

— Sa i bukur ky kërrici — foli Marieta dhe s'u mur vesh nëse e kishte vërtet te kafsha e vogël apo desh t'i dëgjohej zëri.

— I bukur? — foli Llazua. — Kështu, o bijë, kështu kam qenë edhe vetë kur isha i vogël, mos më shih tashti që më mbeti një dhëmb i vetëm.

Kalonim tani nëpër korie të pastruara nga ferrat dhe minjollat sapo kishin marrë vrull, sapo ishin veshur me pulla të bardha e sapo u kishte djersitur zhuku nëpër sqetullat. Pastaj na doli përpara një lirishte plot e përplot me lulekuqe, një si det i tërë me petale të buta, të lehta e kuqaloshë që përkunden ngadalë e lëshojnë një erë të fortë. Në përhumbemi pas asaj bukurie por Jani gjahtari mbledh buzët:

— Këto s'janë gjë... kur isha me rininë në Tropojë më 1945, kam parë ca lulekuqe, që i kishin petalet sa një pëllëmbë njera!

Fëmijët u derdhën pas luleve dhe nisën t'i këputnin, pastaj, duke i njomur me gjuhë, mbushën ballët e faqet me to. Xha Llazua shpjegon:

— Ky është një zakon i lashtë, edhe vetë kur isha fëmijë kështu bëja, është besimi se lulekuqja të shëron dhembjen e kokës. Dhe vetëm tashti vonë kam mësuar se me lulekuqet përgatitet aspirina. Populli e ka ditur fuqinë shëruese të kësaj luleje shumë kohë më parë se ai mjeku italian që shpiku aspirinën.

Jani dalloi rrënjë salepi nëpër shkurret më lart,

nxitoi atje dhe nisi t'i shkulte. Pas tij rendi dhe inxhinier Naili. Ne dëgjonim dialogun e tyre:

— Jam munduar të zgjidh një mister, — thoshte Jani — s'di si shtohet salepi. I kam shkruar edhe revistës «Ylli» e përgjegje s'kam marrë. Kam pyetur disa agronomë, ngrenë supet. Kam mbjellë vetë, s'më mbin; kur isha me rininë në Tropojë më 1945...

— Do ta ndjek unë këtë — e ndërpret Naili (dhe diçka shkruan në blokun e vet).

Pak më tej u duk një djegurishte e vjetër. Njiheshin rrallë e më rrallë nëpër bimësinë e egër koka të zeza trungjesh. Por... pikërisht këtu... Thesar, hapu! Trualli i gjelbër ishte plot e përplot me luleshtrydhe të kuqe!

Se kjo perlë e maleve është tekanjoze, mbin ku të duash, drizave, ferrave, përrenjve e gërxheve, edhe në fushë, edhe në mal, edhe në saksi, por... gonxhe e fruta nuk zë. Është nazemadhe e lozonjare, nuk e do diellin gjithë ditën dhe fytyrë me fytyrë, ajo veç kërkon të lozë me të, kërkon të përdridhet pas rrezeve të tij, flladin e kërkon, por jo ballë për ballë, e do më të fishkëlluar nga lart e nëpër dëllinjat, e do një farë fshehtësie, nuk do ajër që t'i vijë rreptas nga hapësirat, por e do që t'i vijë me përkëdheli nëpër shkurret e nëpër barërat! Luleshtrydhen atyre maleve e krahasojnë me një vajzë fshati që s'është puthur ndonjëherë.

Por si për t'u përmbushur premtimi i Janit, këtu u shtriva si mbi ndonjë burim me pëllëmbët mbështetur pas barit të livadhit dhe me buzët te luleshtrydhet e kuqe! Nuhata fort! Aroma e tyre të depërton thellë në kraharor, thellë në mushkëri si era e luleshëngjinit, porse ky e ka aromën si të

ashpër, kurse «vajza e paputhur e fshatit» ka një aromë që të çmend!

Kur hodha sytë nga studentja e letërsisë, vura re se kokrrat e kuqe të koçimares loznin edhe ato me kokrrat e luleshtrydheve!

Edhe fëmijët medoemos u derdhën me ura e britma; ne shkonim pas tyre më me ngadalë, kurse Jani hoqi çiften nga krahu dhe ju ngazëllyen sytë nga gëzimi ynë. Kur hodha sytë nga kampioni i vendit në qitje, m'u duk se ai atë qilim të begatshëm të natyrës nuk do ta vështrojë drejtpërdrejt, por vetëm nëpërmjet syve të Marietës.

Tashti vajza është ulur mbi një shkëmb pranë djegurishtes. Me sytë e saj të zes vështron pishat e gjelbëra, pastaj qiellin blu, më pastaj livadhin që duket si i mbjellë me lulekuqe. Me buzët e saj ka krijuar një ovale.

Marieta ka ardhur për pushime në shtëpinë e vet dhe, në të njëjtën kohë, pregatit mbrojtjen e diplomës. Naili s'po i ndahet; ata diçka pëshpëritin; xha Llazua s'po flet, por dhëmbi i tij i vetëm, sytë e vegjël dhe rrudhat e ndehura, flasin më shumë. Dëgjova që m'u zu emri në gojë. Vajza po më ftonte pranë, por me një farë droje. Ju afrova. Ajo mbante një palë këpucë kamoshi gri. Dhe pushi i butë i kamoshit është mbushur plot me petale të njoma tërfili. Tashti vajza është mbështetur përgjysmë me shpatulla te një pishë e kuqe, me këmbët në anët e shkëmbit. Dy flutura të bardha të praruara si me ar ndjekin njëra-tjetrën duke u vërtitur rreth pishës së kuqe e pastaj shkojnë e ulen në pulpat e saj të mbushura e të derdhura.

— Kam dashur t'ju kërkoj ndihmë, por më jeni dukur njeri i rëndë.

— Unë?

— Kështu më jeni dukur.

Pauzë, heshtje. Fryn era nëpër pishat e pyllit.

— Pak më parë vura re se po mendoheshe.

— Po përfytyroja fakultetin, shkallët e mëdha, sallat plot vajza e djem. Korridorin me bankën e madhe ku lëshon letrat postieri. Disa vërtet i sjell postieri, disa lëshohen aty, «gjoja» i ka sjellë postieri, ka edhe letra që zhduken pa lënë gjurmë.

— Po e përfytyroni bukur, vazhdoni. . .

— Konvikti ynë, godina nr. 18, thirrjet gazmore nëpër korridorët, nganjëherë kemi edhe britma zënkash, kemi një sallë studimi shumë moderne. Nata në qytetin tonë të studentit është e bukur. Sidomos rreth godinës Nr. 18; këtu dëgjohen më shumë këngë dhe tinguj kitare.

— Jam duke shkruar diçka për jetën e rinisë studenteske, mund të më thoni gjë për pedagogët...

— Pedagogët tanë! Kemi profesorë të zotë dhe secili ka një mënyrë të vetën kur hyn në sallën e leksioneve. Njëri vjen i qetë, një tjetër, si pa të keq, fishkëllen ngadalë, njëri hyn i vrerët duke kruar kokën, një tjetër sikur kërkon diçka me ngut nëpër xhepat, kurse është njëri që hyn gati triumfalisht duke recituar:

*«Endi molla, endi dardha,
endi kraharuar bardha. . .»*

Por ky pedagog është shumë i zoti dhe flet shumë bukur.

— Po a shprehen rrjedhshëm?

— Jo të gjithë në lartësinë e duhur, disa përdorin shumë parazitë si «domethënë», «si të thuash».

«s'di si ta them», .. është njëri që nervozohet tej masës dhe lëshon sentenca: «Ti s'do të bëhesh kurrë pedagog letërsie», por harron se vetë s'është i tillë. Aty në seminarët tona studentët seriozë dhe që punojnë, rrinë në bankat e para, ata të «rrogës bazë» struken qosheve nga fundi dhe shkruajnë letra e vjersha që i dorëzojnë në pushimin e madh... Por tashti për mua po mbaron jeta studenteske, po pre- gatitem të mbroj diplomën.

— Po me se do paraqiteni?

— Ja, këtë s'e kam përcaktuar akoma saktë. Kam menduar për tema: Ndikimi i folklorit mbi poezinë, fryma popullore në poezinë shqipe; kam menduar për krijimtarinë e Foqion Postolit, pastaj më ka shkuar mendja te krijimtaria e ndonjë shkrimtari... por të them të drejtën, unë akoma po luhatem dhe po vozit në një det shqetësimesh...

— Sidoqoftë, — ja ktheva — sot do kesh rastin edhe të shohësh shumë, edhe të dëgjosh mjaft. Mos harro, vajzë, se gurra e popullit është gjithnjë e pashtershme. S'është çudi që sot copëza nga folklori dhe nga jeta t'i marrim drejt nga burimi?

— Nga burimi?

— Po. A nuk i sheh këta pleqtë tanë! Duhet të nxitojmë, ata po ikin një nga një, kujtimet e tyre mbase do t'i marrin me vete në kohën që ne mendojmë për krijimtarinë e shkrimtarëve bashkëkohës. Me bashkëkohësit do kemi kohë të merremi, por ja një terren ku rinia shkollore shumë pak tregon interes, xha Tasi!

— Urdhëro, o bir!

— A do merrni mundimin sot të na tregonit këngët e vjetra, ato që këndonit dikur në dasmat?

— Dita jonë është, djalë, sa të ulet dielli nga

perëndimi, ne do kemi kohë që t'i kthejmë përmbys edhe dasmat, edhe zakonet, edhe pyjet, hajde, bromb, ju kam gjetur! Nail, o bir i dashur! Bjeri asaj së shkretës kitarë.

Dhe ja nisëm të gjithë përnjëherësh:

*Thonë se në Maj as pleqtë s'kërrusen,
thonë Maji qenka çapkën vetë,
ndaj i fsheh bilbilat nëpër fletë,
të përgjojë çiftet kur të puthen!*

Ishte një këngë kjo nga ato që kitara u shkron më për shtat, u ngjit, u jep hov, ngrohtësi e një mall që ta zalis kokën. Dhe fill pas vargut që e kënduan të gjithë, inxhinieri e mbushte ajrin me ca tinguj të shpejtë kitare, të harmonishëm e të ngrohtë, që na ndezën një si flakë në kraharor e na u duk sikur zemra desh të na dilte nga kafazi i vet dhe na u kujtua se është hare, është gaz, është mrekulli, është një lumtëri e pafund që jemi njerëz dhe mundemi të ngazëllohemi kështu! Në ato çaste m'u duk se përbrenda zu e më këndonte shpirti vetë!

Xha Tasi u ngrit në këmbë dhe brohoriti:

— S'ka si mëmëdheu! Më të lumtë, o bir i dashur! Do të të puth një herë në ballë! Zemra të këndoftë!

Po xha Llazua s'ju nda:

— Lëre, o shtrigu i djallit, se mos e zë malli djalin që ta puthësh ti.

Po xha Tasi s'u tërhoq, e puthi dhe e nduku inxhinierin ashtu si ja filloi.

— Brump këtu!

Llazua i kishte mbushur gotat me majë:

— Të bromtë e mira, o vëlla!

— Hajde me shëndet... me rrugë të mbarë!

Sytë e xha Tasit xixëlluan e vënguan nga xha Llazua, por s'ja la pa paguar:

— Më rrofsh, o vëlla i dashur... po, për rrugën e mbarë... ai që thotë, radhën e ke zotrote, o t'u mbylltë dera me grurë!

Po frynte era, krikëllonin minjollat, oshëtinte pylli nga kënga jonë dhe, kur e lamë ne këngën, përsëri u ngrit lart kori i pafund i zogjve të malit. Grifsha këlhiste diku në mes të qiellit përmbi djegurishten, mëllenjat kërcenin përmbi degët, një gor ziosh u hodh nga maja e drurëve sikur përçeshte nuselalat pikaloshë, që vërtiteshin nxituar nëpër zhigrat e pyllit.

Për të vënë në lëvizje të tjerët, duhet të tundesh vetë.

Ju drejtova xha Tasit:

— A s'mban mend vjersha të kohës sate?

Plaku kroj kokën prapa, pastaj fërkoi veshin e djathtë:

— Ish, more, po si ish? Ish një këngë që e këndonin të hënën në mëngjez kur shkonin me pemë te nusja e sapomartuar. Por të kuptohemi, në dasmat e botës, se unë shkova fir. Shkova fir, o bir i dashur, se kisha gjashtë motra për të martuar, dy pleq për të pleqëruar dhe gojë të një fshati të tërë për t'i zënë... Dale, se diç më kujtohet:

*Në çardak, moj nuse,
në çardak digjet qiriri!*

*— Shkova, nëne, shkova.
shkova dhe m'u ndez qiriri.*

*O qiri, more qiri,
këtë që më bëre ti,
s'ma ka bërë asnjeri!*

Inxhinier Naili duartrokiti:

— Shumë e bukur, xha Tasi! Shkruaje, Marieta!
Ndërsa vajza shkruante, plaku mendohej, pas-
taj foli:

— A kini gjë tjetër për të lexuar ju? Do ta
dëgjoja me shumë qejf.

Vajza shkoi afër inxhinierit, u përkul mbi të,
flokët e saj të shumtë preknin ballin e djaloshit; ai
diçka i kërkonte, ajo nisi të nënqeshte e kokrrat e
koçimares loznin valle nën kraharorin e saj, pastaj
pohoi me krye dhe u ngrit; lidhi një shami të kuqe
në kokë, cepat i kapi nyje nën gushën e bardhë,
pastaj mori bulirën e hodhi në krah, ju afrua bu-
rimit dhe nisi të mbushte ujë. Këtu inxhinieri filloi
të recitonte duke lexuar tekstin:

*Kroi i fshatit tonë, ujë i kulluar,
ç'na buron nga mali duke mërmëruar.
Venë mbushin ujë vashat anembanë,
cipëzën me hoja lidhur mënjanë*

.....

*Kroi i fshatit tonë tetë syllynjarë,
nër tetë krahina qenka kroi i parë.
Qenke një në botë, s'paskëke të dytë,
ç'na shëroke plagët, ç'na shëroke sytë.*

*Kroi i fshatit tonë, n'atë mal me fletë,
derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
posi mall'i zemrës mu në gjë të shkretë.*

*Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
posi mall'i vashës, që të djeg më të fshehtë,
Posi mall'i trimit, që buçet përtpjetë,
obobo, si malli, që nuk vdes për jetë!*

Tashti brohoritja e xha Tasit s'kishte të pushuar.

— Llazo, o t'u mbylltë me grurë, e paska qarë me lot ai shkollari!

— Kjo poezi, xha Tasi — foli inxhinieri — është marrë nga populli, por poeti e ka limuar, e ka pasuruar, e ka bërë më të bukur.

— Po ja këtë dua të di unë, si i thonë kësaj?

— Kësaj i thonë, të marrësh miell nga populli dhe të bësh kulaç.

— Tashti të kuptova, o bir i dashur, po s'ka si mëmëdheu ynë, s'ka si mielli i tij, s'ka si era e tij, s'ka si pyjet tona! S'ka!

Dhe dalëngadalë hymë në një bisedë ku pleqtë herë dëgjonin njërin e herë tjetrin, pastaj shiheshin sy më sy e sikur peshonin ato që dëgjonin.

— Meqenëse folklori ka ndikuar mbi poezinë, edhe natyra jonë e mrekullueshme ka ndikuar mbi këngën e popullit.

— Logjika e thjeshtë aty të çon, — ndërhyri Marieta, që në ato çaste më dukej herë si mësimdhënëse e herë si nxënëse — kam vëzhguar kostumin kombëtar të grave në këto anë...

Këtu xha Llazos s'ju durua:

— E, o Nail, o inxhinier... po ti s'e ke parë Marietën të veshur me kostum të tillë?

— Dale, mo, t'u mbylltë dera me grurë, mos na

çaj dërrasa tashti, ti qenke tuaf fare, Naili me Marietën kanë qenë edhe në det. . .

— Pra, kostumi kombëtar i grave, e theksoj, i grave, sepse ndikimi i jashtëm qoftë mbi veshjen, qoftë mbi këngën e gruas mund të jetë i paktë ose nuk ekziston fare për shkaqe që vetëkuptohen; me siguri të kjo veshje kemi ndikimin e natyrës sonë dhe ndikimin e shpirtit tonë kombëtar. Xibuni ngjet nga forma si krahët e shqipes. Ngjyrat janë krejt kombëtare. Gajtani i përfundmë i xibunit (vepër arti në qëndizmë) me ngjyrën e vet të jep përshtypjen sikur vajzat në vërshim e sipër, duke u vërtitur në valle, duke përkëdhelur faqen e livadheve me fundet e xibuneve, u është ngjyer gajtani në lëngun e luleshtrydheve.

— Më pëlqejnë këto nota poetike.

Sytë e Marietës xixëlluan dhe ato kokrrat e kuqe si të koçimares u lëkundën mbi kraharorin e saj.

— Edhe çorapet kanë ngjyrat e të gjitha luleve të këtyre maleve. Mesi i kostumit është tepër i ngushtë (shenjë e shtatit të hedhur e të shkathët). Kraharori ka linja të bardha e të vendosura si petallet e trëndafilut të egër dhe këto petale kanë oja të verdha ashtu si i ka lulja pestilet me polen. . .

Nga ky vërshim i vajzës bëra çmos të mos ngelsha vetëm nxënës:

— Po vallja, Marieta! A e keni vënë re devollitshen e pashoqe? Mbaji shënim këto. Valle me kërcim, bukuri e harmoni të tillë që të mbërthen me dinamizmin dhe lirizmin, kurse në çastin që bëhet «prerja», ka çaste të tilla shpërthimi të muzës popullore, që të ngazëllon aq shumë, sa edhe ti që bën sehir, dashur padashur ja do hidhesh në valle vetë, ja zë e lot valle zemra jote. . .

Por Jani ynë është shpirt i mohimit dhe flet:

— E ç'lidhje mund të ketë vallja e natyra e poezia e folklori... kur isha me rininë në Tropojë më 1945, loznin një valle ata kuksianët...

— I drejtë vlerësimi për vallen kuksiane, po sa për lidhjet që ti më duket se i mohon, s'ke të drejtë. Ti thua se ç'lidhje mund të kenë pyjet me vallet! Po pa shihi ato kreshtat e pishave andej matanë! Tashti po i nget era, shih... a s'lozin valle? Pa vëri re ahet bardhoshe atje poshtë... mua më ngjasin si dibranë në valle veshur me ato shallvaret e bardha!

— E po tashti a bëjmë më tutje?

— Po nga do shkojmë?

— A nuk thamë se do mbledhim çaj mali e salep?

U ngritëm të gjithë. Ecnim për njësh, në një farë kolone. Përpara çante Jani me çiften në krah dhe me një hap të shkujdesur. Pas tij kalamajtë, vajza e djem të mbathur me pantallona të shkur-tëra dhe veshur me bluza të shumëngjyrshme. Marieta ecte e gëzuar, përkëdhelte me duar dosjen e saj dhe më kot mendohej Naili ta shkulte nga mendimi duke lojtur me kitarën e tij. Dolëm te kreu i një humnere. Dhe pikërisht këtu, m'u duk sikur natyra nisi të shpaloste bukuritë e saj:

Sheh anëmbanë, si prej vetiu ngre duart lart dhe, ndërsa je i mrekuallar, pëshpërit:

Mbretëria e gjelbërimit!

— Ne themi — e gjelbëra — dhe ndofta përfytyrojmë tërfillin, që nanuriset në mëngjezin e kthjellët e lëkund ato bulëzat e imta të vesës, ose përfytyrojmë fletën e madhe të arrës, që të deh me aromën e jodit, ose të shumtën përfytyrojmë kokrrën

e njomë të bizeles! Po pa bëj të numërosh morinë e të gjelbërës! Mos u lodh ta numërosh duke e kulluar numërin nëpër gishtat e duarve të tua, as duke shtuar edhe ato të shokut; as edhe gishtat e shokëve, s'ja del dot. Më mirë nise me fijet e flokëve të tua në je djalë njëzet e një vjeç e poshtë ose më mirë, në je vajzë dhe i ke flokët si Marieta jonë.

Në pllajën poshtë nga e majta na del një varg gërmadhash të vjetra. Gurë shumë të mëdhenj e të shkuar nëpër duar gdhendësish e tani si të lyer me atë ndryshkun e lashtësisë që ua ka veshur koha dhe shekujt. Prekim disa prej tyre. Janë fare të lehtë, si prej alumini, gurë të shkuar nëpër kushedi sa zjarre.

— Këto janë gërmadhat e Nikolicës së lashtë!

— Ka qenë qytet i madh!

— Aq i madh, sa ka patur katedrale e mitropoli, përpara Nikolicës, Kosturi ka qenë një fshat.

— Në kemi një libër të Nikolicës së lashtë. Është një psaltir i shtypur në Voskopojë më 1741. Në fund të librit ndodhet një kushtim i shkruar në ditën kur është shkatërruar fshati nga turqit. E ka shkruar prifti. Por urata si duket ka qenë aq i tmerruar dhe i turbulluar, sa ka harruar të shënojë datën.

— Punë për kompetentët, — thotë Naili — ata që vijnë pas nesh le të përdorin shkencën dhe kiminë për të përcaktuar sa e vjetër është boja gushpëllumbi në faqen e fundit të psaltirit. Ne këtu kemi veç një këngë:

*Se ç'të dogji turku,
të shkretoi për jetë,
o Nikolic' e shkretë!*

Kaq dhe asgjë më shumë. Gërmadhat dinë, edhe lumi i Devollit ka parë dhe dëgjuar. Por ata uturijnë dhe mërmërojnë. Nuk tregojnë asgjë. Veç Pukevili shkruan: «Shkova në një fshat të Devollit, bëhej panair në dimër, murgjërit më treguan një bust të Skënderbeut, që ai vetë ua kishte dhuruar. Dhe murgjërit e ruanin bustin e heroit të tyre». Panair në dimër ka patur vetëm Nikolica. Për vite e vite me radhë janë endur këtyre gërmadhave kërkonjës thesaresh. Gjurmët e punës së tyre njihen edhe sot, por ato të gjitha kanë shkuar fir. Asgjë nuk është gjetur. Dhe ne e dimë se pas nesh do të vijnë të tjerë, më të shumtë, më të fortë dhe ata me siguri kanë për të rënë në gjurmë të sakta. Por kjo e jona është vetëm një urim dhe një dëshirë.

Nga një lëndinë plot me dritë dhe ngjyra të nderzura hymë në një ambient hijesh dhe lagështie. Na u prenë fjalët. Asgjë s'pipëtin. Askush nuk këndon. Dhe vegjetacioni këtu është sa i dendur, aq edhe i errët. Thikë përballë nesh, ngrihet trangu i një mali. Ai është i pyllëzuar me pisha e ahe shekullore. Askush s'ka vënë shpatë aty, zjarri nëpër shekuj asnjëherë nuk e ka depërtuar dot nga lagështia dhe...

Një rropamë dhe zhaurimë e furishme. E ndjejmë ajrin të lagur.

Përballë nesh shohim atë shkëmbin gjigant, prej të cilit buron lumi i Devollit. Është një gojë në shpat të malit. Nga ajo teptis përjashta lumi i tërë, shfryn e gogësin ujë dhe ajër! Dhe ne i ndjejmë në fytyrat tona, cikërimat e ujit dhe valët e ajrit.

Vendi anembanë, larg e larg, ka gurë shtuf e të bardhë. Veç gryka e ujërave është e çarë në gur të zi si abanos. Vëmë re përtokë afër burimit. Veç

atje gjejmë gurë të zinj si ai masivi i shpërthimit... Të krijohet përshtypja sikur barku i tokës është çarë atje, e ka dërmuar shkëmbin që brenda dhe gurët e zinj i ka shpërndarë aty pranë. Kur ka ndodhur kjo? Kushedi sa mijëra vjet më parë. Dhe nga ai vërshim i paprerë ujërash, nga ajo zhvendosje dhe uturimë e ajrit aty rreth, gjithshka dridhet. Dhe të gjitha ato pisha të përziëra me ahet kanë mbirë, janë rritur e mbahen akoma, gjithnjë duke u dridhur nga sulmi i ujërave. Po vallë sa mijëra vjet ka që ky lumë buron këtu? Sa legjenda janë krijuar rreth tij! Si vinin këtu stërgjyshërit dhe faleshin? Dhe e quajnë këtu «Burimi i Devollit»! Nuk di përse më shkon ndër mend dhe nis e numëroj me veten time: Mos vallë Devoll — dea-dea vol kalim i Deas, volta e Deas. A thua se ky ambient i jashtëzakonshëm këtu nuk i ka mjegulluar mendjet e njerëzve prehistorikë! A nuk ka qenë ky burim një Dea, një perëndeshë e ujërave!

Vendësit e sotshëm thonë se pleqtë i janë falur gjithnjë lumit të tyre. Gojëdhënat thonë se ujërat e Devollit «janë pikë e flori». Ndofta prandaj historiani Pukevil shkruan: «Banorët e Devollit nxjerrin ar nga ujërat e lumit të tyre».

Dhe Pukevili i huaj, duke mos ditur t'u hyjë fjalëve të popullit, na tregon një mënyrë foshnjare dhe krejt naive: «...nxirret ari nga ujërat duke e ndehur në rrjedhë lëkurë qingjash»

Kalojmë varg në një rrugë të ngushtë mbuluar nga minjollat njomëzake të ahut, qielli s'duket fare. Papritur, nën udhë fishkëllim i njohur i tehut të celiktë kur kosit barin.

Kapërcejmë zhigrat e ahishtes dhe zbresim poshtë... Një livadh tepër i gjerë me një kurorë bre-

dhash e ahu anembanë... Hijet e drurëve varen në për barin e njomë. Sepse kur në fushë livadhet janë shkumbosur, këtu sapo nis e kositet bari dhe çdo mëngjez të mbyt vesa. Por... ja edhe kosari! Kthehet nga ne dhe atëhere e shohim se është vajzë. Na mbytin aromat e ëmbla të barit, që sapo është shtrirë. Kur pashë vajzën, mendova: «Ja një punë e prapësht për një femër, ky kryetari i kooperativës...»

Vajzës i uruam punën e mbarë dhe ju afruam. Bishtin e kosës e vuri përtokë, duart i ka te presa e s'di kush vezullon më shumë, tehu i ndritshëm i kosës apo sytë e saj. E quajnë Shqipe, ka dy sy shumë të mëdhenj, një vështrim të gëzuar dhe dy llërë malësoreje që, jo kosën për bar, por edhe varenë për shkëmbinj do ta fluturonin... Jo gjithnjë i kam marrë anën kryetarit të kooperativës.

Nga pishat na doli një plak. Unë këtë e njoh me kohë. Është tepër i gjatë dhe ndër duar ka një kuti shkrepseje. E përshëndetëm. Menduam se xha Ethem i kish mbetur pa duhan, prandaj Naili i zgjati paqetën e vet.

— Falemi nderit, po unë nuk tymos.

— Po kutinë e shkrepse?!

Qeshën sytë e tij të përzemërt dhe vështroi nga vajza. Edhe ajo qeshi.

— Këtu në këtë kuti, o miq, kam mbyllur katër mbretëresha!

Bëra një hap prapa! Vështrova anembanë... rrëzët e Gramozit e të Moravës bashkë, pashë Malin e Kuq dhe borën e shkrepseve, pashë edhe nga Dea e Devollit... M'u bë sikur isha në ëndërr dhe po dëgjoja një përrallë. Por plaku e hapi ngadalë kutinë dhe ne vërtet shohim në të të katër mbretëreshat.

ai i ruan që të mos i fluturojnë dhe i ikin. Ethemi qenka rojtar i bletëve të kooperativës dhe i ka zgjojet këtu pranë.

— Të më falësh, xha Ethem, po, kur më fole për mbretëresha, unë thashë se mos ti... nga pleqëria...

Ai nënqeshi.

— Kishim një kryetar aty para disa vjetësh, se ç'i kishte hipur në kokë dhe thoshte:

— Më të mos u thoni matkave mbretëresha!

— Po si t'u themi, o? — pyesja unë.

— T'u thoni një emër tjetër, por jo mbretëresha, gjejeni vetë.

Por unë kam rrahur mendjen shumë, por emër tjetër s'u kam gjetur.

U futëm nëpër zgjojet e bletëve. Ato janë vendosur në tri radhë valavitëse. Këtu aromat të dehin aq fort, sa ta turbullojnë mendjen fare. E s'e kupton dot se si derdhen e përhapen kundërmimet. Janë të rëshirës, që e kanë djersitur dërrasat e bardha të zgjojeve, janë të mjaltit, që Ethemi e nxori për miqtë nga kolibja e tij, janë të boçave të bredhit apo janë aromat e luleve dhe barit, që Shqipja përsëri i është lëshuar, dhe po e shtron poshtë!

S'e kupton dot!

— Mjaft i hatashëm!

— Bar për plagë!

Marieta mrekullohet, Naili përgjon hojet e verdha, fëmijët janë grykës e s'kanë të ngopur, kurse pleqtë sa e vënë në gojë.

— Duhet holluar me ujë.

— S'është kushedi se çfarë — thotë Jani. — Kur isha me rininë në Tropojë më 1945, kam ngrënë ca mjaltë në Gjakovë...

Përsëri desha ta gërgas Janin, por e lashë, sepse m'u kujtuan vargjet e Çajupit për mjaltën e për baltën.

Por... një piskamë që nga hendeku i livadhit. Fatosin e ka thumbuar një bletë. Shqipja po i fërkon faqen me një lloj bari, që kushedi se çfarë është. Llazua mundohet të qetësojë nipin e i thotë:

— Mos klaj de, mos klaj!

Dhe këtu Marieta hyn në një labirint të ngatërruar gjuhësor. Më pyet:

— Si shpjegohet që pleqtë tanë, edhe gjyshja ime sot e kësaj dite thotë «klaj, glemb e klumësht»?

— Po ti si mendon?

— Kam pyetur një pedagog në fakultet, por ai ngriti supet, më tha vetëm se këto i takojnë çamërishtes dhe... pikë.

Mendova: «Kjo vajzë u kthye nga fakulteti me një barrë libra pas. Ka një muaj që po shfleton tekstet që të kapë temën dhe s'po e kap dot. Po përse nuk u vu të përgjojë rrënjët e veta. Është e re, s'ka përvojë. Dhe kjo është fare e kuptueshme. I them:

— Devollin nga Çamëria e ndajnë gjithë këto krahina e treva: Kolonja, Leskoviku, Përmeti dhe Libohova. Dhe nga të dyzet e tetë katundet e Devollit vetëm në katër fshatra gjejmë në përdorim klë-në dhe glë-në, edhe në të folme edhe në këngët e folklorit; po, është një këngë ku kemi fjalën «glemb», por të më falni, nuk mund ta shqiptoj dot, sepse fjala «glem» në këtë këngë rreh të kamuflojë një diçka. Të ishe studente e mjekësisë, ndryshonte puna. Por ne kemi xha Ethem, unë e njoh me kohë dhe kam folur disa herë me të, ai do na japë një fill:

— Xha Ethem, si e quani ju këtu lumin që sapo buron?

— Lum i Sulit.

— Po pse i Sulit?

— Ish një fshat Sul, ja atje më poshtë, njihen veç gërmadhat, por është prishur. Këtu kalonte rru-ga e Grebnesë dhe e Janinës.

— Po kur ka ndodhur kjo?

— S'e di besa.

Marieta shqetësohet:

— E humbëm fillin e Adrianës — më thotë.

— Jo, vajzë, kemi një burim historik. Pukevili në veprën e tij historike shkruan: «Kur u prish krejt Suli, suliotët ikën dhe u ndanë në dy drejtime: Një pjesë shkuan në Korfuz dhe pjesa tjetër në Shqipërinë e Jugut» Dhe ja, Marieta, këtu erdhën karvanet e suliotëve. Po si ishin ato karvane? Ngar-kuar kuaj e mushka me velenxa të trasha leshi. Dhe velenxat mbanin erë gjak. Burrat i mbanin ar-mët peshë. Ballët e trishtuar të suliotëve, sytë e mëdhenj që panë vallen e Zallongut, fytyrat me plagë thike e plagë zjarri. Karvanet e suliotëve! Të pamposhturit! Të pashtruarit! Të paepurit! Ko-kat e suliotëve që habitën botën. Ecin dhe s'flasin, as këndojnë. Jo! Në kokë dhe në zemra vlon e pa-përmbajtura, e pakrahasueshmja, e paharruara kënga e Marko Boçarit:

Qante një turkezë e bukurë,

seç na qante për aganë,

fora, Marko jataganë!

Dymbëdhjetë Marko Boçarë,

dymbëdhjetë kushërinj të parë,

*seç i prite mu ndë ballë,
fora, Marko jataganë!*

*Marko Boçar'i pamundur
kish kollanë e patundur,
plumbi Markos s'vete humbur!*

Këtë valle gjer tani, vonë e loznin vajzat valle ditën e pesëmbëdhjetë të gushtit, të veshura me xibunat e bukur. E loznin për trimërinë e Marko Boçarit.

Eh, Marko Boçari! Ti na del para syve të mendjes i madh dhe i ashpër, i qetë dhe i vrërët, trim dhe zemërmadh. Atyre që sot të quajnë grek, ti ua ke mbyllur gojën që më 1800. Unë të shoh, o Boçar, nën kubetë e Shën Spiridonit në Korfuz. Në duart që mban pallën, ti ke një pendë pate, përpara një divit dhe përballë teje një frëng. Është «qafiri Pukevil» që shkruan «Ce lexique est ecrit de la main de Marc Botxarie a Corfu 1800 devant moi. Poqueville»¹). Dhe Marko Boçari shkruan dhe flet:

— Grekët e Pukevili i thonë «galla», ne i themi klumësht, grekët i thonë «gllosa» ne i themi gluhë; se si i thoni ju frënce, besa besën nuk e di»²)

— Mendoni se suliotët ardhën këtej?

— Po. Ja ku janë gërmadhat, ja ku është edhe lumi, por nuk na flasin, Marieta, ata vetëm mermë-rojnë. Po gjyshja juaj a thotë klan e glemb?

— Po.

1, 2) Këto që cituam janë marrë nga fjalori greqisht-shqip i Marko Boçarit, dorëshkrimi i të cilit ndodhet në «Bibliothèque Nationale Paris» nën numrin 252, faqet 1, 94 dhe 97.

— Vërë re. Në Devoll edhe sot kemi mbiemrat: Suli, Sulioti, Sulari dhe Sulovari. Filologu K. Kurila, vdekur në moshën 90 vjeç, shkruan në vitin 1944: «Përsa i përket gjenealogjisë sime... Kur u prish kalaja e Kurelës nga turqit në Sul, pleqtë tanë ardhën dhe ngritën fshatin Kurilë në Devoll. Por Kurila e Devollit më vonë, aty nga viti 1821 mori pjesë në kryengritje dhe pësoi prishjen e dytë. Dhe babai im me shokë, bashkë me fshatarë të tjerë nga katundi Zicë i Sulit ngritën fshatin Ziçisht në Devoll».

Jemi me filologun gjer atje ku prishet Kurila për të dytën herë. Por ndahemi prej tij përsa i përket fshatit Ziçisht. Ky fshat ka pritur shumë suliotë, por ka qenë i ngritur shumë më herët...

Gjer këtu dhe Marieta u ngrit në këmbë. Ishte gati të brohoritte, m'u duk se sytë e saj s'na shihnin më ne, as Nailin. Ajo vështronte nga lumi i Sulit si e përhumbur, si e habitur, e përpirë e tëra pas një fije, pas një mendimi...

— Po unë... po kjo, ideja, filli, teza! Diploma!
Xha Llazua filloi të na tregonte:

Në Ziçisht rron edhe sot Eleni. Gjyshi i saj, Theodhori, ishte suliot, Theodhor Katara. Nuk i jepnin nuse, se numërohej i huaj, «muhaxhir». Por në fshat kishte lindur një vajzë e bukur, aq e bukur, sa ja kishin vënë syrin ta dërgonin në haremët e Stambollit. Atëhere doli Theodhor Katara në lëmë të fshatit dhe u tha burrave: «Nemani mua Katerinën e Dimashëve e besa po, kujt t'ja mbajë... ja sheshi dhe mejdani, ja dhe Todo kapedani!» Dhe, sa u lind fëmija e parë, Katerina ndejti në një guvë të Moravës, afër stanit të dhurve. Pastaj kemi edhe Jani Suliotin në Dardhë. Gjyshi i Janit shpuri të birin në Sul për herë të fundit aty nga viti 1914.

Vajti dhe i gjeti akoma në këmbë shkallët e gurta të shtëpisë ku kishte lindur. Kur u nis nga Dardha, ishte tërë gaz e qejf, kur u kthye... që nga Suli e gjer në Dardhë plasi së qari.

Më 1930 kam qenë me dhen gjer në krahinën e Sulit të Pargës. Vend i mirë për kullotë, po gërmadhë. Kam njohur atje një vendës suliot, e quanin Mina Dashi, fliste shqipen si ti e si unë, por ishte trim i marrë. Këndonte një këngë, së cilës unë i mbaj mend vetëm dy radhë: «Rapëz e Agji, Manëz dhe Kastri. . .» Këto ishin emrat e fshatrave të vogla, që akoma kishin mbetur nga Suli i madh. Po më shumë s'më kujtohet. Një ditë (kam qenë atje) Mina Dashi kishte vënë ndër këmbë një dash dhe po e qethte me gërshërën e madhe. Ja se ku i qaset një korofillak grek dhe i kërkon taksën. Mina Dashi u xhindos dhe ja ktheu:

«U s'i kam dhënë lesh turkut, jo suratit tënd, hiqmu, se të mbërtheva me gërshërë pas murit!»

Edhe unë kështu e di. Klë-ja dhe glë-ja përdoret vetëm në katër fshatra të Devollit dhe e kanë sjellë këtej suliotët e shumtë që erdhën pas prishjes së madhe. Po kështu flasin edhe arbëreshët më në jugë, po kështu edhe kapedani i lalëve shqiptarë të Moresë, Ali Parmaku, që ja ktheu Hurshid Pashës letrën, me të cilën pashai i kërkonte të dorëzonte Kalokotronin:

*Se Ali Parmaku jam,
e derdh gjakun gjer mbi glu!*

* * *

Shqipja po kthehej në fshat me kosën në krah. Nxitoi të na ftonte të shkonim bashkë me të:

— Ejani, — na tha — unë nxitohem se kemi provat e festivalit.

Marieta s'ju nda:

— A kini këngë të reja në festival.

— Kemi.

— A do na e këndoje njërën.

Por Shqipës me kosën në krah aty në mes të rrugëve me bar i vinte zor të këndonte, na tha vetëm vargun:

*Ç'i grise shamitë së lari në krua,
syt' i ke në ujët, mendt' i ke te mua.
Nga praku në portë shkon thua më thua,
si zog zemërtrembur, verdhur bërë ftua.*

*Llambat se ç'u ndezë, kandilet ç'u shuan,
fshati na gojosi, dritat na zbuluan.
Dil të dalim hapur, dil për krah me mua,
kush na pat gojosur, le t'i thahet gjuha!*

Ne nuk shkuam në fshat, se kishim rrugë tjetër dhe Shqipja u nis vetëm. Këtyre maleve pa armë s'kalonin as burrat, pa le pastaj një vajzë. Le që kjo është një përjashtim. «Një vajze si Shqipja me atë kosën në dorë edhe Isuf Arapi do t'i bënte rrugë...» thotë duke qeshur xha Tasi.

Dhe Tasit i vjen mbarë të tregojë. Ai nuk do të mbetet prapa xha Llazos. Mendimi se Marieta jonë e gjeti më në fund fillin e diplomës së saj kaloi gojë më gojë midis nesh dhe ne të gjithë e shoshitëm dhe e biseduam këtë.

— Kemi një këngë të bukur, e lozte valle mçtra e vogël

*Njëzet e pesë gërsheta
t'i numërova, pa rash' e fjeta.*

Ish pastaj vallja e Isuf Arapit. Po përse e quanin kështu? Ta marrim me radhë. Isuf Arapi erdhi këtej për t'u prerë kokën njëzet e shtatë hajdutëve, që s'ju bindën Aliut. Dhe ua preu. Të pesë fshatrat e këtij pellgu e brohoritën Isufin, por Isufit i shkau zemra pas valles së bukur e trimërore. Darka e dreka në çdo fshat, kurse vallen e kërkonte të luhej nga njëzet e shtatë herë! Kur loznin vallen djemtë, Isufi hiqte armën nga krahu. Kur vallen e luanin çupat, Isufit i pikonin armët vetë dhe humbiste i tëri. Thonë se Arapit ju dërmua zemra pas një qytetareje, por Isufi ish oficer i Aliut, s'ish frëng i Napoleonit!

Marieta kukurisi e foli ngadalë:

Kjo më kujton Marie Çerain dhe marshallin në «Përrenjtë ku llapashiten trofta».

Arrijtëm në pllajet e larta të Gramozit. Zu të na dehte era e dëllinjave dhe e xhumbrices. Larg, pas shpateve të blerta, duken sikur rrëkëllehen ngadalë ca si vezë gjigante... Janë kopetë në kullotë. Më lart duken përrenj malesh të mbuluar me borë. Masa e bardhë shndrit nëpër tisin mavi të maleve. Dhe këtu na sulmuan këmborët e deleve, zilet e deshve të kopeve, na u vërsulën blegërimat e qingjave dhe jehonat e luginave që sillnin gjer këtej ushëtimat dhe erën e gjësë së gjallë në kullotë. Gurgullima burimesh, lehje qensh, hingëllima kuajsh dhe britma çobenësh. Na sulmoi ajo era e ëmbël dhe e fortë e çajit të njomë, e atyre bisqeve të buta në ngjyrë të vajit, që për asnjë çast s'i linte qetë filladi. Dhe pllajet me çaj shushurinin e lëkundeshin si një det i tërë, që dallgëzon me valëza të vogla.

— O burra, të mbledhim çaj, se do kthehemi në fshat si na ka hije!

Dhe u përkulëm pas çajit, kurse Marieta më duket se s'e ka mendjen fare!

Lart në qiell silleshin skifterët, që vërsuleshin pingulthi mbi çaiet e kullotave duke gjuajtur brumbuj e karkalecë.

Një zë u ngrit diku anash. Ishte zëri i xha Tasit:

— O Llazo! Po hajde këtu, o t'u mbylltë me grurë!

Plaku kishte zbuluar një burim në mes të fashave të dendura të fierit. Atje Tasi kishte shtruar çka kishte në çantat dhe na ftoi të afroheshim të gjithë. Shishen e rakisë e kishte futur në burimin e ftohtë, por, sa i shkova pranë, ai s'më la të mundohesha. Më zgjati gotën e mbushur plot e përplot:

— Të kam gjetur, o bir i dashur!... ë ashtu, gjak e dhjamë, na edhe ti, o inxhinier, me fund! S'ka si mëmëdheu!

Vasili i shkoi pas qejfit:

— Aaa... të lutem shumë, xha Tasi, ne të dy do ta pimë si vëllezër e si shokë. Ngrehu!

Fytyra e plakut qeshi, pastaj ai u ngrit dhe ju vërvit Llazos:

— Llazo, o t'u mbylltë me grurë! Pa shih cilin kam unë shok e vëlla!

Dhe, duke krijuar dy si unaza me duart e njëritjetrit, ngritën dollinë me fund:

— Rroftë mëmëdheu, o bir i dashur! Ja kështu!

Ai u ul këmbëkryq dhe fjalën s'e la:

— Se mos thoni se vetëm ju kini çallëstisur për Shqipëri! Në kurbetin e parë u ktheva nga Australia pa një grosh në xhep. U futa në pampor dhe punoja me lopatë në furrat. U nismë nga Mellburni dhe dollëm në Napoli. Vetëm në Aleksandri qëndruam. Këtu pampori u mbush me qymyr, kurse

unë mora një deng «ashtu si duhej» nga vetë duart e Thanas Tashkos. Kapedani i pamporit ishte italian, nënkapedani grek. Ky i dyti më thotë: — «Ç'ke në këtë deng, o arvanit?

— Meze për raki qirie nënkapedan, — ja ktheva — kam marrë cironka të thata prej ato që kripin felahët këtu në rërën e Misirit».

Po, kur sosmë në Napoli, ky kapedani i pamporit i bije kalemit dhe habitet. I gëzuar sa s'bëhet thërret: «— Paskemi arritur tri ditë më parë... ore, kush punon atje në furrat e qymyrit?

— Një njeri që s'ngjet si njeri — i thanë.

— Më thërret mua ky kapedani, o tu mbylltë me grurë dhe më pyet:

— Arap je?

— Jo.

— Mullat?

Në vend të përgjegjes, unë, gjysmë i zhveshur dhe i nxirë nga qymyri si isha, fshij surratin me të dy duart dhe i përngrihem drejt. Ama kisha një trup... S'kish djalë të ma kapërcente në Australinë e tërë. Dhe kështu ja kthej:

— Jam shqiptar, o t'u mbylltë me grurë (desha të thosha me «makarona», por s'ja thashë).

— Hë, albanes — mërmëriti.

— Po ç'më pandehe, zotrote!

— Qënke vërtetë djalë i fortë, m'i ke furnizuar furrat kaq mirë, sa na nxore në Evropë disa ditë më parë.

Dhe, duke m'u afruar, më hedh dorën në qafë, më heq mënjanë dhe më thotë:

— A rri të të mbaj këtu në punë, do të të paguaj sa nënkapedanë!

— Jo, or t'u mbylltë me grurë, ju marinarët

s'kini as shtëpi e as katandi, ju në çdo skelë kini nga një grua, unë, që thua zotrote, kam gjashtë motra për të martuar...»

Dhe për motrat u ktheva këtu për të ikur përsëri. Gjithë jetën punova për prikën dhe për pajën e motrave, kurse vetë mbeta qyqar, më keq se gratë që kanë nxjerrë nga gjoksi i zhuritur këtë këngë:

— *Sihariq moj motër, sihariq,
se burrat tanë arritnë Leskoviq.*

— *Po dë qoftë se do na vijnë,
sihariq do jap florinë*

*Po dë qofshin burrat tanë,
sihariq do jap fustanë.*

*...Dë qofshin burrat e botës,
mur më mur do t'i bje kokës!*

— He, a kini ju të rinjtë këngë kaqë të bukura e kaqë të hidhura!

Marieta, si për të falënderuar xha Tasin, qeshi me të gjithë fytyrën e saj dhe u duk sikur qeshi edhe kurora e saj e flokëve të shumtë.

— Hë, mor bir, — m'u kthye xha Tasi mua si mbaroi këngën — mere ti këtë miell dhe gatuj një kulaç më të mirë.

Dhe përsëri u kthyem te biseda e parë. Marieta u afrua më fort dhe lapsi i saj nxitonte mbi letër. Xha Tasi vështron majat e bredhave:

— Ç'vështron ashtu, xha Tasi?

— Më duket, o bir, më duket sikur shoh Ali Pashën duke shkukur mjekrën anës gjolit të Janinës. Pastaj, o bir, më duket sikur shoh atë djalin me takije mënjanë tek ai kroi me tetë sulinjarë! Krua

me tetë sulinjarë e me një kope çupash anembanë. (Pastaj duke rënkuar). Domethënë ju shkollarët e rinj s'i hidhni poshtë këngët e vjetra?

— Si e mendon këtë, — ju përgjegj Marieta — t'i hedhim poshtë, është njëlloj sikur të mohojmë vetëveten. Njëherë shelgu tha: «S'jam bir i rrënjëve» dhe u përmbys i tëri.

— Folklori, xha Tasi — vijoi inxhinieri — është dokumenti më i pakundërshtueshëm i qenjes së një kombi. Bismarku na mohoi dikur kurse plaku ynë i madh Thimi Mitkua ja mbylli gojën në sy të gjithë botës!

— Ja mbylli?

— Ja vulosi fare kur botoi visaret e para të folklorit tonë. Vitet kalojnë, edhe shekujt, dhe ja sivjet folklori ynë zuri vendin e parë në Dizhon të Francës...

Kokrrat e koçimares gati fluturuan nëpër fushën e Marietës.

— Edhe në varr do jetë inatosur Bismarku.

Të dy pleqtë tanë dukeshin të kënaqur dhe gazmorë:

— Bukur flisni ju të rinjtë, s'jua mohon njeri, edhe bukur shkruani.

— Jo, xhaxha Tasi, — ju drejtua Marieta, — poeti i parë, të cilit i lexuam vjershën këtu, është djalë, kurse i dyti është në moshën tuaj.

— Po a ke vjersha të tjera atje në dosje, o vajzë?

— Kam mbledhur, xha Tasi, unë po përgatitem për të mbaruar shkollën e madhe dhe më duhet të provoj edhe një herë ndikimin e këngës së popullit mbi poetët tanë. Dua të kujtojmë këtu edhe një poet të moshës sate, i cili thellësisht është ndikuar nga folklori dhe nga fryma popullore dhe nga ana

tjetër, të më falësh, po s'e kam për keq, ky poet ka diçka të përbashkët me ty!

— Me mua, o bijzë e dashur! Poet më bëre mua?

Inxhinieri mori një libër nga dosja e vajzës dhe recitoi:

*«Un, jam një arbëreshë, rroj këtu në rrëza,
Një gjak e një gjuhë kemi me thëllëza,
pëllumb e sorkadhe jaemi far' e fis
kemi dhe shqiponjën gjyshen e shtëpis!
Bija, mbesa mbledhur, buza duke qeshur,
fut' e bardh' e ngjeshur, llër' e njom'
përveshur*

*punojn' e gëzojnë, ashtu u ka hije
Njëra hollon petët, tjetra mbar' e bie.
Njëra ja mer këngës, tjetra po heq valle,
njëra flet me vetull, tjetra me qepalle...
Ditën e mërkurë, posa që ra dritë,
nusja në qilar po bën kurabitë.
Llërët i përveshi dhe një fut e ngjeshi,
dy gropëzat ju dukën në faqe kur qeshi!»*

Fërgëlloi këtu edhe Fatosi i vogël e ne përsëri i pamë qukëzat në faqet e njoma të djalit. Xha Tasi foli i pari:

— Ja ky poet paska qenë usta i pikës, si e ka emrin, o Nail?

— Ali.

— Po ti a e ke njohur?

— E kam njohur, xha Tasi.

- Gjallë është?
- Jo, xha Tasi, ka nja dy vjet...
- Ashtu?.. Hajde bromp, këtë për shpirtin e Aliut! Si e kishte mbiemrin?
- Asllani!
- Eh i varfëri, asllan ka genë vërtet! Me shëndet, o bir i dashur, zoti na e vendostë Liken në parajsë pranë shën Andonit që të ketë një shok të kupës...
- Xha Llazua ja ndërpreu fjalën:
- Sa t'i veç pranë edhe ti...
- Ai që thotë, e t'u mbylltë me grurë! Po burrë i mirë ka genë?
- Kështu më pyeti xha Tasi duke më vështruar mu në sy.
- Burrë i mirë dhe artist, ka shkruar për patriotizmë, për Shqipëri, për punë e për zakone të lashta, po më shumë ka shkruar për dashuri!
- A i varfëri unë, ta kisha ditur, s'do ta kisha lënë të mbyllej dera me grurë. Po ku vdiq?
- Në Tiranë.
- E sheh! E merrja këtu në mes të maleve dhe të rronte dyqind vjet a më shumë, sa t'i desh xhani... kjo erë e maleve të mëmëdheut s'të lë të vdesësh kurrë. Po nuk më thua, vuante nga ndonjë e keqe?
- Më ankohej gjithnjë.
- Po përse, o bir i dashur?
- Psherëtinte e më thosh: «Për këto kohë që kanë ardhur, gjynah që s'jam të paktën nja shtatëdhjetë vjeç!»
- Po sa ishte?
- Tetëdhjetë e shtatë.
- A i varfëri vëlla...

Dhe xha Tasi psherëtiu thellë me atë kraharor kabanë dhe sytë ju njomën. Por Vasili s'desh ta lente të përlojetej:

— Dëgjo, xha Tasi, të shoh që u mallëngjeve, kurse unë dua të të shoh të gëzuar. Do të të lexoj edhe një vjershëzë të vogël të Aliut, kjo duket sikur është jo e bisedës sonë, mbase s'i duhet as Marietës për diplomën e saj, po, meqë e kemi këtu fjalën, të libri i Aliut, dëgjo:

*«Çeli edhe trëndafili, shemr' e manushaqeve,
Do u thur një këng' bilbili mollzave të faqeve,
mollzave që pika mua, me një pik të zez në mes,
që t'i thith një her' si dua, jam gati dy her' të
vdes!»*

Xha Tasi ngriti duart lart dhe i përpoqi i ngazëllyer, por në çast fytyra e tij mori pamjen e atij gjyqtarit, që e kap në fjalë fajtorin.

— Kjo vjershë është për ty, o bir i dashur, apo jo?

Dhe xha Tasi vështroi nga unë, sikur kërkonte ndihmën time. Dhe desha vërtet t'i marr krahun, u fola të gjithëve:

— Xha Tasi, të na rrojë sa malet, ne do t'i vëmë «nderin» në vend... Xha Tasi ka hak, kjo vjershë është për Nailin, jo më pak edhe për Marietën. Noli ynë i madh diku shkruan: «Mos ki dert, mor Kirenar, ta thur këngën një shqiptar». Kështu edhe ti, xha Tasi, mos ki dert se «hakun» do t'ja marim inxhinierit...

Të dy pleqtë qeshnin të ngazëllyer, qeshnin edhe kalamajtë, qeshnin edhe ujërat e burimit, qesh-te edhe Marieta me gjithë kokrrat e kuqe të koçi-

mares dhe më dukej se qeshte edhe pipëza prej gëzhoje e bulirës aty pranë.

— Kemi një vjershë të Naimit të madh, xha Tasi, me atë vjershë do t'i përgjigjemi inxhinierit, kampionit tonë në qitje. . .

Këtu xha Tasi e gjeti me vend të më ndërpriste:

— Kampion është vërtet! Unë vë me bast me kë të dojë dhe betohem për erën e maleve të mëmëdheut se kampion në qitje si Naili ynë nuk ka gjëkundi!

Plaku s'ishte aspak i pirë dhe, të gjithë ne, dhe më tepër Marieta e kuptonin se ku qëllonte xha Tasi me shprehitë e tij dashamire.

Recitova nja dy vargje të Naimit:

*«O veri! Pa hiq i thuaj sorkadhes qafëgjatë
Më ka dhënë pyllë mua, s'mblidhem dot as dit'
as natë.
Pyete vallë përse? Pastaj jakë e më rrëfe!»*

Plaku e dëgjoi me sytë përdhë, me vëmendje, me dëshirë, pak i kërrusur, pastaj më kërkoi ta përsëritja edhe një herë, edhe dy, edhe tre. . .

— Hëëë. . . Bukur, o inxhinier, bukur ta dhamë përgjegjen. Tashti që të «mbërthyem» keq, duhet të paguash gjobën. . . bjeri asaj së shkrete kitare, bjeri dhe të këndojnë! S'ka si mëmëdheu! Ta dini nga unë, s'ka si mëmëdheu! Gëzuar, o Marieta, ma trashëgoftshi jetën. Unë e ngrysa të ritë tha nëpër llagëme e nëpër furra, s'më pa syri një ditë të bardhë. Tashti në pleqëri më ra radha të kthehem në mëmëdhe dhe të shoh jetën, tashti sikur jam djalë. . .

— Po sa vjeç je, o xhaxha Tasi — pyeti Marieta.

Dhe plaku ja ktheu zjarr më zjarr:

— Njëzet edhe një, o bijëzë e dashur!

Gjer këtu edhe papritur xha Tasi sikur u vros. Ç'pësoi kështu papandehur? Ne asgjë s'mund të kuptonim. Pastaj nisi një farë vetëkuvendimi:

— Kaloi jeta ime e rëndë si plumbi dhe e hidhur si shafrani. Kam punuar dhe jam robëtuar sa unë e di. Por asnjëri nuk e di se ç'domethënë të ikësh nga kjo botë dhe të mos lësh prapa asnjë filiz e asnjë rrënjë. Kjo është plagë me thëngjill të ndezur sipër. Do plaki dhe do më kujtoni, prandaj, sa ditë më kanë mbetur, gaz e këngë dua t'i provoj tashti. . .

Megjithëse pamja e tij ishte shumë e vrerët, Llazua s'ju nda:

— Po jo të gjitha, o i uruar, se t'u prenë këllqet!

— A, vëlla Llazo, ti më një vërë i bie fyellit, ti ma ke lëkurën si të atyre buajve të Kordovës. Unë, ore, jam si ai lisi zgërbunjë në mes të djegurishtes. E ka rrahur zjarri, rrufeja e shqota dhe mbeti ashtu pa lëshuar një filiz.

— Mirë, vëlla Tase, por këtu s'kemi shami për të fshirë lotët, mjaft tashti, se na more mendtë. . .

— Po ç'mend, o tu mbylltë dera me grurë! Se mos ke mend ti?!

U ngritëm dhe nisëm shtegëtimin për më tutje. Na preu rrugën një burim i madh squfurik. Ujët kalonte nëpër haliçe e, haliçet nëpër ujë, dukeshin sikur tundeshin e lëkundeshin e loznin valle. Ishin mbështjellë të gjithë ata guralecë me një si membranë të bardhë nga squfuri e dukeshin si fshikëzat e mëndafshit.

Kaluam edhe nja dyqind hapa më tej kur na doli përpara një trevë si gropë në mes të pllajave

dhe, si në një pamje kartolinash... tri liqene të vogla!

— Liqenëzat e Gramozit!

Liqenëzat që na premtoi Jani! Diametri i secilit s'i ka as të njëqind hapat. Mbërrijmë te liqeni i parë. Ka plot shavare, presa e steka si shkopinj me ca kokëza si prej kadifeje. Në fund të ujërave duket qielli, pastaj pllajat me çaj, bluzat e fëmijëve, pushka sportive e Nailit sa edhe ai përjashtimi i rrallë i natyrës me atë kurorë flokësh të lëmuar dhe të butë si ajo farë kadifeje, që kanë stekëzat e shavarit në breg. Brenda në liqen s'duket asgjë e gjallë, ndofta nga lartësia e madhe mbi nivelin e detit, ndofta nga ujët e ftohtë të borës që tjeret gjer këtu. Ku ta dish! Vetëm herë pas here disa insekte të çuditshme, vërsulen mbi cipën e ujërave dhe çajnë nëpër të duke hapur një si farë vijëze; duken pikërisht si ata silurët që lëshojnë nëndetëset në luftë, por në miniaturë. Pastaj qindra e mijëra flutura e pilivesa venë e vinë përmbi ujërat e, kur nisa t'i mbaja sytë mbërthyer mbi liqen, pasqyrimi ma prishti mendjen fare dhe m'u duk sikur liqeni nisi të sillej e të vërtitej, sikur ja filloi të rrotullohej rreth vetes si një gur i çmuar dhe i ndritshëm, që lëshon vezullime dhe përmbledh në suazën e vet gjithë ato ngjyra gazmore të luleve të çajit, gjithë ato valle fluturash të bardha, e ngjyrë ari, gjithë ato hije të zgjatura njerëzish, që gëzohen dhe i mbajnë sytë poshtë nga qielli i larë dhe i kredhur në ujëra.

Liqeni i tretë ka shteruar më shumë se gjysmat e ujërave.

— Fenomen ky i sivjetmi — thotë Jani dhe mori çiften në dorë.

— Do t'i qëllosh fluturat?

Ai nënqeshi dhe mua, nuk di përse, më shkoi mendja te Flemingu. A mundej vallë të merrte me mend shkencëtari i madh (kur ishte gjallë) «sfiidën» e një Jani nga Shqipëria?

Nëpër rudhat e tokës që e kishin liruar ujërat, dalluam disa mbeturina lufte. Ishin të mbështjella me lëmashqe, po përsëri njiheshin.

— Janë sharapnela gjermani!

— Ne duhet të jemi të parët që i shohim, sepse thatësi si kjo e sivjetmja, s'mbahet mend në këto anë.

Vasili u afrohet predhave, Marieta i bën shenja që të largohet prej tyre, por ai ulet, i vështron mirë e mirë, pastaj çohet dhe sheh kodrat përtej, majat më tutje dhe përsëri mendohet. Vete e vjen inxhinieri i ri nëpër truallin e zbuluar të liqenit dhe gjurmët e tij dallohen nëpër tinën. Pastaj u flet fëmijëve:

— Pa ejani me mua.

Kampioni i qitjes hapi dosjen e madhe të Marietës, nxori që andej një copë letër sa një gazetë dhe e shtroi poshtë. Me një laps gtafiti dhe me dorë të shkathët filloi të pikturonte dhe t'u tregonte fëmijëve:

— Ja, këto janë pozicionet e luftës së njërës palë, ja këtu mitrolozat, këtej grykat e zjarrit të rëndë... kurse kundrejt, kësaj ane kemi pozitë e anës tjetër... ja këtej...

— Po partizanët cilët janë, o xhaxhi Naili?

— Po ja pra t'u bëjmë yjet në ballë, ja një yll, ja dy, ja tre e kështu me radhë. Ja këtej gjermanët me kryqet e thyera...

Njëri nga fëmijët vuri duart e veta nënë bel dhe foli:

— Po pse, o xhaxhi Nail, gjermanët. . . të thyera i kishin kryqet?!

Ne të gjithë qeshëm.

— Jo kryqet e kërbishteve, jo. Gjermanët mbanin ca kryqe të thyera si shenja, ja kështu. . . Ja, këtu kemi liqenëzat, pra fusha e betejës shtrihej në këto gjerësi, kurse predhat e armikut duhet të vinin që nga ajo çuka përtej.

— Po ku e di ti, xhaxhi Nail? Ke qenë partizan ti?

— Jo, unë partizan s'kam qenë, sepse në atë kohë nëna më lëkundte në djep, por, duke matur largësinë, duke shikuar vendmbërritjen, gjejmë edhe trajektoren, domethënë rrugën e predhave.

— Është inxhinier, xhaxhi Naili, oj kokëzë — foli një çunak duke ju drejtuar një tjetri.

Tani fëmijët kanë gjetur lule trendeline dhe i hedhin mbi ujërat e kështu në cipën e liqenit duket sikur takohen harqe të verdha. Një gjeratore shënohet mu në mes të ujërave. Në grykën e saj silltet një silur vocërak. Toka shkruan e thatë, hap gjirret e saj të nëndheshme këtu në majat e Gramozit. I lamë liqenëzat dhe bëmë më tutje.

— Hej! Qëndroni! Shihni!

Te qafa lart një kope me drerë!

Një si valle e hollë duket nëpër këmbët e tyre sa mezi u shquhen thundrat nga pluhuri apo nga shpejtësia e rendjes. Njihen drerët meshkuj, ata i mbajnë lart ata brirët e çuditshëm plot me dega e biga; i mbajnë lart si noca përkrenare burrërie e herë-herë, ata brirë të lëmuar nëpër degët e pyjeve, u vezullojnë nën rrezet e diellit. Tani morën tatëpjetë dhe po u përshkënditen nëpër këmbë bisqe çaji e trendeline.

— Ua... sa të bukur!

— Sa të shpejtë!

— Si era...

— Kur isha me rininë në Tropojë më 1945, kam parë një dre sa një elefant!

Por kampioni i qitjes mbeti duarkryq duke tundur kryet.

— Ligj! Drerët janë të paprekshëm — dhe i vështronte me një admirim të dukshëm.

— «Takor» — foli xha Llazua — «takor» për drerët, po ariu që na batërdisi arat me misër e me patate! Besa besën unë s'pyes ligj për atë të nëmur. Le që ka fat ai i mallëkuar. S'i del ndonjëherë Janit përpara, pa ja tregon ky... Por më falni, Jani me ariun kanë ca llogari të vjetra...

Një nënqeshje e hidhur bën të shkrihet në buzët e Janit e nuk shkrihet dot, kurse sytë e xha Llazos qeshin me djallëzi:

— Hë, mo Jani, sikur na premtove se do na tregojë për ariun kur të dalë atje... apo do t'ja fillosh përsëri me atë «kur isha me rininë në Tropojë...»

Por këtu hyn në fuqi ajo zbritja me përqindjet maksimale.

— I del Janit ariu përpara (këtu e nja tre vjet më parë) mu në mes të pyllit, i ngritur më këmbë si njeri me putrat lart dhe i hungron: Huuu! Jani prapset, sepse (si thotë vetë) në këtë çast i kujtohet ligji dhe, duke ikur, (gjithnjë në emër të ligjit) një koçkor ja hap rripin e orës Bulova me 21 gurë dhe ja fluturon në erë. Pastaj Jani e pa me sy se si ariu kërceu kur dalloi atë diçka të ndritshme në orë, e kapi, e nuhati dhe... më shumë Jani s'mundi të shihte, sepse gjithnjë kishte parasysh rregulloren e

shoqatës së gjuetarëve ku ai paguan kuotë të rregullt.

Një nga fëmijët pyet si pa të keq:

— Po tashti, o xhaxhi Jani, ai ariu a e mban në dorë atë orën tënde?

Fëmija s'mori dot përgjegje, sepse Jani vuri re ca re të murme nga ana e perëndimit.

— Andej shkrepëtinte mbrëmë natën, por thellë ama...

— Me këtë thatësirë që po bën...

— Unë sikur e ndjej lagështirën, — foli xha Tasi — po më dhemb këtu në gju.

— A, ç'duhet kopanisur ai gjuri yt. Po mos kini frikë, ka pyje këtej sa mund të strehohet një ushtri e tërë.

— Punë e pëlqyer — flet xha Tasi sikur flet me vetëveten.

— Ku e ke fjalën, xha Tasi?

— Te kafshët e egra, o bir. edhe te zogjtë.

— Po pse?

— Andej nga isha unë, ish një rëmuje e vërtetë për këtë çështje. Ishin lëshuar gjahtarë nikoqirë të ngeshëm e vraj të vrasim zogj dhe gjënë e egër të pyjeve. Po e shfarosnin, po e batërdisnin. Në Itali nga shkova e nga kalova s'më zuri syri asnjë zog të vetëm.

Inxhinieri që e dëgjoi me vëmendje ja ktheu:

— Kam lexuar një studim të posaçëm për këtë që tregoni ju, xha Tasi. Skandinavët akuzojnë italianët për këtë shfarosje, kurse italianët ankohen se s'kanë punë tjetër. Zhdukja e gjallëresave është një problem jetik. Njeriut i shkatërrohet ambienti ku e ka vendosur natyra. Ja për shembull ta marrësh peshkun dhe ta lësh të jetojë në ujë të distiluar...

Pas një bregoreje na doli përpara një arë me luledielli. Kokat e tyre të mëdha janë rrethuar me ato dantellat e verdha e janë kthyer nga lindja si ushtarët më të disiplinuar të natyrës.

— Çudi! Luledielli në majë të Gramozit!

— Po t'i biesh tokës të lëshon, (dhe me zë të ndërruar) por edhe e kanë vaditur.

— Këtu kemi shenjat e qarta të nitrat amonit — thotë Naili. — Ju të gjithë më thërritni inxhinier dhe ndofta pandehni se unë mat rrugë apo ndërtoj ura. As njëra e as tjetra. Unë, xha Tasi, jam inxhinier kimist në atë gjigantin e Fierit, atje ku prodhohet plehu kimik për të gjithë vendin.

— Po pse s'ma ke thënë këtë, o bir i dashur!

Marieta nxitoi te ledhi i arës, u çua në majë të gishtave dhe bëri të kapte një kokë luledielli. Dhe ashtu kokrrat e koçimares ju lëkundën në erë, trupi i saj i zhdërvjellët u ndeh i tëri sa kraharori ju çua lart, gati ju dynd në gushë. Naili nxori blokun dhe shkroi në të: «Efekti i nitratit të amonit në lartësitë e mëdha». Pastaj më foli:

— Mbi këtë temë do të bëj një studim shkencor.

— A thua se këtu nitratit i amonit vepron më pak?

— Përkundrazi, duhet të veprojë më shumë, këtu ndikon edhe ajri i pastër, oksigjeni i shumtë, pastaj këtu ka plehra natyrale me një vlerë të paçmuar, fletët e kalbura, halthet e rëna në tokë, mërzmimet e gjësë së gjallë. Ja... le të shohim këtë rrënjë misri, që paska mbirë e vetme këtu, shih se sa shumë është zhvilluar.

Inxhinieri e vështron bimën me miratim, e përket me kujdes sikur ajo të jetë Marieta, i vjen rrotull dhe unë që këtej shoh fytyrën plot shëndet të

kampionit në qitje, flokët e tij gështenjë të çelur, sytë e rreptë, ballin e gjerë dhe gazin në krejt pamjen e tij. Flokët ja përkërdhelin fletët gjelbëroshe të misrit dhe ai diçka mendohet.

Më pëlqen ky djalosh i brezit të ri, që merret me qitje, që kalkulon trajektoret e predhave, djalosh energjik, që e ndjek punën e vet edhe këtu në majat e maleve, edhe këtu, ku një vajzë e re dhe e bukur ja nanuris ëndrrat e jetës.

— Më fal, — më thotë Naili — po për një çast m'u duk sikur hyra në botën tënde... M'u duk sikur krijova një figurë letrare... A s'të duket sikur ky kërcelli i misrit është zhytur në tokë me kokën poshtë, dhe atje poshtë kërkon dhe thith ushqim, dhe është gjithë qejf e shëndet se ka gjetur boll çka i duhet... Pastaj çdo mëngjez ky misri këtu mbledh pikat e vesës nëpër sqetullat e veta dhe si i dehur nga kënaqësia, ngjason me ndonjë qingj që ka kapur gjitë e nënës së vet, thith qumështin e shëndetshëm e plot lyrë, harliset dhe tund bishtin i kënaqur!...

Dhe Naili më tregon xhufkën e misrit tek tundet e lëkundet në erë.

— E, si të duket, a të pëlqen figura ime?

— Desha t'i shtoja edhe diçka të vogël po druaj se mos e bëj prozaike... Aty ku thua «qumështin e shëndetshëm e plot lyrë», mund të shtosh: «plot lyrë të siguruar nga ndikimi i nitratit të amonit...»

Por Jani gjahtari, ky gjahtar me shpirtin e mohimit në majë të gjuhës, e sheh rrënjën e misrit me përçmim:

— Kur isha me rininë në Tropojë më 1945...

— Rri, o Jani, tashti... Tropoja dallohet për

gështenja, në rafshnaltat e saj s'mund të zhvillohet misër. . .

Balli i gjahtarit u bë prush:

— Po të lutem shumë, ti pse ma pret fjalën. . . unë desha të thosha se. . . kur isha me rininë në Tropojë më 1945, shkova njëherë në Kosovë dhe atje, në fushë të Gjakovës, kam parë një misër. . . drapërin as që e pranonte fare, i vajtën me sëpatë!

Gjahtari ynë e gjeti me vend të shpërthente dhe fjalët nisën të thartoheshin kur hyri në mes Marieta dhe na hoqi armët. . .

Disa hapa më tej të dy pleqtë tanë kanë gjetur një burim të madh. Dëgjohet biseda e tyre dhe duken të dy tek nxitohen ta ndreqin.

— O burra, t'i vëmë edhe disa gurë për anash, ti bjeru ferave me sëpatë, unë po dal të gjej ca plloça.

Dielli është ngritur lart dhe me gjithë hijet e gjelbëra të pyjeve, me gjithë pasqyrimet e blerta të tokës, hapësira është mbushur plot me dritë. Marieta është shtrirë në mes të kaçubave me bar të trashë e të butë dhe sodit qiellin e kaltër me sytë e saj të zez; pleqtë po punojnë dhe mua më kujtohet zakoni i lashtë shqiptar: «Kur njeriu plakët, i trashen këmbët, se bëhet gati për udhë, kur njeriu ka ngritur një shtëpi, ka mbjellë qoftë edhe një pemë, ka rritur fëmijë, ai dashur padashur do të niset, por, para se të niset, është e udhës të mbyllë ndonjë gjak, të ndreqë ndonjë urë, të sheshojë ndonjë zënkë, pa është e udhës të lajë ndonjë pus dhe të ndreqë ndonjë çesmë apo burim mali. . .»

Dielli u ngjit në zenit! Vapë? Jo, jo, veç rreze të vdekura dhe të ngrohta. Fatosi i vogël nxjerr blu-

zën dhe kanatieren. Duket trupi i tij njomëzak dhe i mbushur. Edhe shokët e tij bëjnë si ai, veç një vashëzë bardhoshe me sy të shkruar, bën të heqë bluzën e përsëri nuk e heq. Lëkundet vajza, sapo ka filluar të rritet dhe i vjen droje.

Natyra e tërë po oshëtin maleve e bjeshkëve me atë muzikën e saj madhështore, të çuditshme e të pakapshme.

Pylli me trungjet e bredhave!

Bredha dyzet pashë njëri!

I përshkon era dhe ata krikëllijnë. Dhe këto krikëllima s'janë të lëkurës, as të degëve, as të trungut e as të majës kryqashe. Krikëllimi vjen nga brenda, nga zemra e bredhit, nga palca e tij e kuqe. Dhe s'di përse pylli me bredha më duket si një orgë gjigante që era ja trazon tastierat e saj të argjenda!

E keni dëgjuar zhaurimën e erës nëpër fletët e pyllit, nëpër gjiret e dëllinjave, nëpër fijet e telat e gjata të kuprave? Po boçat e borigave a i keni dëgjuar kur i përshkon flladi dhe ato zukatit si muzika goje? Po a i keni parë kokrrat e dëllinjave? Ato lëshohen që nga halthet e tyre dhe shkojnë e godasin lulekëmbanat, që shtrihen mbi lëndinë.

Era fryn kudo! Ajo u bie telave me rëshirë që ua shkul boçave të bredhit, era fryn nëpër dantellat e verdha të luledielleve, era i nget ujvarat dhe ngjyen frymën e saj nëpër to, era këndon nëpër të çarat e shkëmbinjve dhe nëpër degët e lisave, era këndon nëpër çerdhet e zogjve, nëpër brimat e gurit smërsh. Era i rrëmben të gjitha këngët e natyrës, i ngre lart në qiell dhe atje i bashkon me koret e pafund të zogjve, që nga çuçuritjet e bilbilave, në cicërimat e harabelave, në guitjet e pëllumbave e gjer te

kënga ledhatare e thëllëzave të malit! Era fryn nëpër tufat e bagëtive, u lëmon kumborat deleve dhe brirët deshve. Era që përshkon botën, e kreh, e lan dhe s'njeh kufire!

Nëpër baloshet e bredhave, ndërsa ne ecim, duket një barrakë dërrase. Nën strehët e saj ka thasë me pleh kimik, disa prej tyre janë të çarë, më tutje duken disa fuçi naftë, pastaj një piring me voze bulmeti; një qen doli nga qoshja, hungoi disa herë me përtesë, pastaj futi bishtin nën shalë dhe u zhduk. Mezi dallohet një kope delesh nën hijen e një borige. Dhentë janë strukur atje për të kaluar vapën.

Edhe një burim tjetër në mes të kaçubave dhe ne mblidhemi të gjithë rreth tij. Marieta merret me dorëshkrimet e veta, pastaj i lë ato mënjanë, qarkon gjunjët me krahët e saj dhe flet duke vështruar përçark:

— Kjo natyra e ka ndikuar dhe e ndikon folklorin, edhe kostumet e bukura, edhe poezinë, edhe vallet, edhe vetë jetën. Natyra ndikon edhe mbi ndërgjegjet e njerëzve, ashtu sikurse ndikon edhe mbi shëndetin e tyre.

— Për shëndetin jam dakord, — thotë Jani — për të tjerat... sikur s'ma merr mendja...

Xha Llazua ja pëlçet së qeshurës, sepse pret që Jani të vazhdojë me atë: «Kur isha me rininë në Tropojë më 1945». Por Naili nxiton dhe e merr fjalën:

— Gjithë kjo larmi ngjyrash dhe bukurie, s'ka si të mbijë përmbi një shkretëtirë. Jo. Përrallore është toka dhe nëntoka jonë. Por prindërit tanë, gjyshërit dhe stërgjyshërit, sa e kruanin tokën me parmentat e drunjtë, nëntokën ata e njihnin veç kur hapnin varret. Unë s'u habita sivjet kur folklori

ynë shpërtheu në Evropë. Unë s'habitem me shpërthime të tilla, ashtu sikurse nuk jam habitur për shpërthimet e puseve tona euruptive të naftës. Ne jetojmë mbi një truall përrallor...

Jani uli kryet duke dashur të fshihte një nënqeshje:

— Sikur po e rrihni shumë gjoksin, inxhinier... kur isha...

— Këtu s'ka rrahje gjoksi. I shihni gjithë këto halthe pishash? Këto pllaja me lule shëngjini, këto dëllinja të pafund, këto fusha me lulekuqe! Në qoftë se flasim me gjuhën e poezisë, ne, nga këta pyje me halorë mund të lëshojmë lumenj të tërë me lëng terperntine e me xhin, kroje me vaj lule shëngjini, përrenj me esencë mente, rëkera me vaj ushqimi, trena të pafund me amiant, me sqfur dhe male të tëra me petale lulekuqesh që atdheut të mos i dhembë koka për mijëra vjet me radhë...

Xha Tasi s'u përmbajt dhe u ngrit. — Kësaj i thonë: Mbajmë verë e pimë ujë.

— Opo më të lumtë, o bir i dashur! Dale të të puth një herë, se dashur padashur, një ditë do shkoj. Jetën borxh e kemi. Po ta dini ama, do ta lë mëmëdhënë në duar djemsh të mençur. Nail, o bir, bjeri asaj kitare, se do t'ja them një herë:

*O po ku ishe o po mirsevjen,
moj dardha me ren.*

*Vet' gatuan bukë, vetë shkon me dhen,
moj dardha me ren...*

Ne të tre, Naili, Marieta dhe unë, si ta kishim bërë me fjalë, nxorëm lapsat dhe mbajtëm shënim dhe xha Tasi s'na la pa rënuar:

— Përse shkruani të tre?
— Mua më duhen vargjet — tha Marieta.
— Mua më nevojitet fjala e panjohur «ren» —
thashë unë.

— Kurse unë diçka kam dëgjuar për renin, por
jam kimist dhe dua të të pyes, xha Tasi...

Plakut ju bë qejfi ashtu si ngjet me çdo njeri
të moshuar kur vë re se të rinjtë e sajdisin.

— Reni është një bimë me fletë si shpata, por
rrënjët e tij të bardha e të gjata si copëra litarësh
kanë vetinë që e ruajnë dardhën nga prishja dhe i
japin një shije shumë të mirë. S'keni dëgjuar ju?
Dardha me ren...

— Jo, xha Tasi.

— Sivjet do vë unë, kam për t'ua treguar.

Dhe xha Llazua s'e lë rehat:

— Në mos t'u mbylltë dera me grurë...

Por këtu xha Tasi s'do ta kthejë bisedën në
shaka:

— S'ka për të qeshur këtu, Llazo, mua po më
gëzohet zemra me këta të rinjtë e mëmëdheut. Andej
nga isha, pleqve s'ua varnin fare. I quanin matufë...
një e dy dhe ua pëlçisnin në sy: «Hej ju, shtrigje
trutharë, merrni nga një biberon e mos na çani ko-
kën...»

Pastaj kënga jonë shkoi gjatë në kaçubat rreth
burimit, kitara e qitësit na e ngrohte zemrën me
tingujt e saj, sytë e Marietës xixëllonin, kurse kok-
rrat e kuqe të koçimares për asnjë çast nuk gjetën
qetësi.

Në një farë kohe xha Llazua zu të kotej me të
madhe. Një lodhje ja dërshte gjyintyrët dhe
na foli:

— Kush të dojë mund të marrë një sy gjumë.
E dini si flihet këtu? Fët e fët, e të duket sikur
fluturon...

— Vërtet, o xhaxhi Llazi?

— Vërtet posi!

Fëmijët u strukën pas xha Llazos nën hije, ne
të tjerët aty rrotull. Plaku vu mbi fytyrë një tufë
fier, xha Tasi kapelen republikë, Naili sheh rreth e
qark e s'di ç'të bëjë, kurse vajza nxitoi. Ajo mbuloi
gjunjët e trandafilte me trikon e saj të kuqe e të
butë, ra në shpinë dhe (diçka të tillë s'e kisha parë
ndonjëherë) flokët e vet të shumtë i ktheu grumbull
përpara dhe me to mbuloi fytyrën. Vetë u shtriva
dhe vura mbi sy një tufë çaji të njomë.

Shumë shpejt ndjeva një gërhitje të lehtë e
pastaj Jani gjahtari, i cili ka nën kokë kondakun
e çiftes së vet:

— Iku xha Llazua de... Ja ç'domethënë të të
priten këllqet...

Por plaku e ndieu dhe s'e la bosh:

— Fli atje ti, zagari i djallit...

Fëmijët ende po pëshpëritnin:

— Vërtet fluturon po të flesh këtu?

— Ama u ngopëm me luleshtrydhe, lëre... do
t'ua prishim mendjen fare atyre shokëve në fshat!

— I patë ato gjylet në liqen?

— Unë për ditën e sotme do bëj një hartim.

— Edhe unë!

— Edhe unë!

Dhe dalëngadalë, fëmijëve sikur u ndahet mbi
fytyrë ajo vellua me pluhur nëpër këmbët e shpejta
të drerëve, dalëngadalë u afrohen mbi sy ato dante-
llat e verdha të lulediellit, dalëngadalë u përkasin

gepallat ato stekëzat e liqenit që i kanë kokëzat të veshura me atë pushin e butë, të trashë e ngjyrë kafeje. . .

Më zu gjumi dhe pashë një ëndërr të çuditshme. Pashë ëndërr sikur Jani gjahtari mori një letër nga larg. Mbi zarfin e bardhë e gjatosh ishin ngjitur disa pulla poste me pamje trandafilash të egër. Vullat postare kishin degëza me kokrra dëllinje. Letrën (dhe këtu ishte habia ime) ja dërgonte Janit «Instituti i kërkimeve «Aleksandër Fleming» dhe i shkruanin kështu me një shqipe të kulluar: «Lutemi na dërgoni një grusht me kokrra dëllinjash, që rriten në malet tuaja madhështore. Firmuar: Për institutin e kërkimeve. . . Carlz Dikens. . .»

Pastaj u zgjova.

Vetullat e fëmijëve në gjumë duken si shigjetëza, që gatiten të marrin fluturim. Fëmijët i kanë fytyrat të buta dhe u dallohen mbi gushë rrahjet e dendura të pulseve. Llazua tashti po flet e gërhet, xha Tasi po psherëtin e s'e merr gjumi, kurse fytyra e Janit në gjumë duket me një pamje të ashpër. Desha të shihja edhe më shumë, por s'kisha çfarë dhe kë, përveçse kërricin e njomë që erdhi gati fluturim mes nesh dhe na zgjoi të gjithëve. Dhe sapo u çuam njëri nga fëmijët tha dika që s'duhej thënë. Ai e tha dhe mua m'u kujtua përrallëtari i madh danez dhe tregimi i tij «Mbreti lakuriq».

— O xhaxhi Llazi, po Naili dhe Marieta ku janë?

— Kush t'i përgjegjej çunakut? Desha t'i përgjigjesha vetë, por s'dija nga t'ja nisja. Nuk dija sepse më parë duheshin pyetur grifshat që këlthisnin lart në qiell, duheshin pyetur mëllenjat topolake, që kërcenin lajthishtave, shelgjishtave apo

duheshin pyetur boçat e bredhave atje lart ku filladi s'i linte rehat e ato përkundeshin, lëkundeshin e vinin rrotull sikur ishin boshte dhe endnin e turrnin fijet e rëshirës që t'i bënë linja apo vello, apo duvak të bardhë! Hë? Kë të pyesim, o vogëlush, Cilin? Apo ta lëmë përgjegjen për ca vjet më vonë, kur ty do të ta mësojë koha?!

Xha Llazua qeshi me cepin e buzëve dhe me atë dhëmbin e tij të vetëm:

— I ka zënë qymyri, çuno...

Por në këtë çast xha Tasi rënkoi:

— Do të kemi shi, — dhe tregoi renë e murme, që afrohej nga ana e perëndimit — shiu sikur ka ardhur.

— Po Naili me Marietën që do lagen, o xhaxhi Tasi?

— Nuk lagen jo.

— Po ku janë tashti?

— Mbledhin luleshtrydhe.

— Edhe nëpër shi do mbledhin?

— Nëpër shi e nëpër tufan, o kapedan!

— Urra! Urra! Po vijnë Naili dhe Marieta?

Ata të dy po ktheheshin me nga një degë çaj që e shtrëngonin pas vetes. I pari foli inxhinieri:

— Ne dolëm për çaj, se gjumi s'na merrte!

— Ashtu, o kapedan i Llazit, ashtu, por dëgjo këtu.

Marieta shtihej se s'dëgjonte gjë dhe hiqte nga kraharori fijet e buta të çajit, që i kishin mbetur atje.

— Dëgjo këtu, inxhinier... të pish çaj dhe të shkruash «dhiplomën», kjo shkon që pun' e madhe, po ta dish ama, që të bësh dasmë dhe të nxjerrësh çaj për darkë... s'të shkel njeri në prak të derës. S'e di! Tasja edhe mund të vijë...

— Po ku të vete unë, o tu mbylltë me grurë!
Unë dua dash e tatëpjetë, raki e përpjetë!

Gjer këtu dhe u duk sikur xha Llazua desh t'i vinte kapak fjalës, u kthye nga Marieta dhe i foli:

— Krihu, moj bijë, era t'i ka prishur leshrat, ke edhe kokrra dëllinje nëpër flokët prapa.

Ndërhyri Jani në bisedë se fytyra e Marietës u bë si lulekuqe. Po mua s'më pëlqeu Jani gjahtari ndofta, sepse vetë, gjithnjë më kanë pëlqyer lulekuqet e njoma. Dhe në këtë çast, vajza me faqet flakë, u përkul te burimi dhe nisi të lante fytyrën.

Dhe m'u duk atëhere se ujërat e burimit u përskuqën edhe ato.

Zu të frynte një erë e freskët dhe pak e lagësht; kopeja me delet la hijen dhe doli në kullotë; u duk bariu në një çukë, vuri dorën mbi ballë si strehë dhe shihte qiellin. Jani e xha Llazua rrëmbyen sëpatat nga samari i gomarit dhe u futën të prisnin shufra nga lajthishtet. Shpejt e shpejt i bënë furka i ngulën në tokë, i mbështetën pas drurëve, u hodhën sipër fier e degë bredhi.

— Futuni të gjithë këtu, se po afron shiu!

Dhe atje brenda na mbuloi një si hije e thellë gjelbërimi. Në krye nisën të binin disa pika të imta shiu, pastaj më tepër, por Llazua edhe s'ka hyrë në kolibe dhe nxiton të mbledhë fier. Papritur dëgjohet zëri i tij që thërret:

— Nail! O Nail! Inxhinier!

Qitësi rendi përjashta i kërrusur duke ngritur jakën e xhaketës.

— Xha Llazo, si e ke punën?

— Po ejani, ore, se s'jeni sheqer e do treti!

Reshja po trokëllinte nëpër fletët e mëdha të lepushave dhe ne rendëm përjashta.

Plaku ishte mbështetur pas një pishe, kishte vënë duart në bel dhe tundej sikur falej. Mbi kokën e tij gjer lart, dukej një farë si inçizimi në trung, shenjë rrufeje, por Llazua s'e kishte fjalën aty:

— Pa shihni, o djem, pa shihni.

Zëri i plakut ndihej si i lyer me helm. Me dorë tregon çukën përtej. Atje duket bariu i dhenve në mes të shiut dhe... pa gunë. Në vend të gunës, bariu ka hapur ombrellën!

— E shihni!? Epo të lutem shumë, kjo s'hahet fare! Çobani ka gunë, prandaj i thonë çoban!

* * *

E ngarkuam gomarin me dengjet e çajit. Dhe e ngarkuam aq fort, sa atij ju mbuluan edhe veshët nga ato bishtajat e buta të asaj bimës së merme. Anash samarit i varëm shportat me luleshtrydhe, kurse në mes të samarit Jani dërdhi një torbë me kokrra dëllinje.

U nisëm nëpër një monapat me rërë të hollë; pikat e shiut kishin lënë atje gjurmat e tyre. Të një pyll takuam një skelë sharrëxhinjsh. Rreth e qark turra me traversa e trarë. Dy burra sharronin një trung për dërrasa. Ai i sipërmi, i hipur mbi trung, e kishte më të lehtë tërheqjen e zhakës, ky i poshtmi mbante sytë lart, si vëngërosh.

— Puna mbarë!

— Mirë se erdhët!

Pirgu i tallashit s'kishte marë formën e rregullt, sepse binte e derdhej bashkë me çungje rëshire.

U duk një pllajë e punuar, e mbjellë me patate. Por ara duket e dëmtuar dhe xha Llazua zë e mallëkon:

— Ky i nëmur po na bëhet hisetar në kooperativë!

— Kush, o xhaxhi Llazi?

— Po ariu, o bir, shih se ç'dëme na ka bërë. . .

Kaluam më tutje dhe qëndruam në buzët e një gremine. Nën ne ishte një përrua i thellë dhe, përballë, tutje, larg, disa si pirgje, disa si forma të ngatërruara gurësh e shkëmbinjsh.

— Ja, ky është Përroi i Madh!

— Dhe atje përtej Vëra e Ariut!

Tutje, te praku i një guve duken dy putra. Pamja është fare e qartë. Te guva e vet ariu ka dalë e ngroh putrat. Trupi s'i duket, ndofta fle. Më ngjet si në përrallë. Rreth e përmbi guvë ngrihen pisha e ahishte, pamja me fletë të portokallta (ndonjë panjë që i kishin zënë rrënjët në gur) pastaj kulpra dhe qershë të egra. Era fryn dhe putrat e egërsirës, një herë duken të zeza, një herë të kuqe, një herë të bardha, pastaj verdhashe. Si të frynte era.

— Me siguri. . . ariu po fle — thotë xha Llazua.

Naili, rripin e gjatë të pushkës sportive e ka të mbështjellë pas llërës së vet dhe vështrimin e ka përqëndruar në thep e tutje.

— Do ta qëllosh?

— Jo, jo. . . ligji. . . por do ta mbaj ariun në shenjestër.

Diçka lëvizi, pastaj një grahmë, një si gulçimë

e mbytur dhe, ariu çohet mbi këmbët e pasme, si njeri, me kokën lart mbuluar nga leshrat e gjata dhe në mes të dy putrave. Dhe këto putra i ka të mbuluara me ca si bishta thekësh të ngatërruara, por dallohen tabanët e tij si të rruar e të zez si lëkurë bualli.

Fëmijët u trembën, askush s'pipëtin, kurse xha Tasi ngul këmbë e thotë:

— Po s'e ngave ariun, ai s'të nget!

Kurse Jani gjahtari na tregon:

— Kur isha me rininë në Tropojë më 1945, kam qëlluar një ari me pushkë lufte. Sapo i rashë, ai u ngrit mbi këmbët e pasme, përçasi putrën e vet të djathtë pas fytyrës (si të desh të shihej në pasqyrë) menjëherë nxori gjuhën e tij të kuqe dhe lëpiu putrën... atje ish goditur, por ala s'i kish vajtur në vesh krisma e armës... Pastaj mori vesh ç'po ngjiste. U drodh e u xhindos dhe u vërsul të shkulte ç'të mundte dhe të na e vërvitte. Gjete një gur të madh, bëri ta shkulte, por si duket putra i përveloi dhe, duke kërcyer e pëllitur, u turr nëpër vrimën dhe s'e pashë më. Nga goja e vrimës zu të dilnin ca britma, rrapëllima e mjaullitje të egra.

Përsëri u vumë në rrugë, por xha Llazua përsëri s'e la rehat Janin:

— Ore, i kanë ndodhur gjëra Janit, kur ishte me rininë në Tropojë më 1945! Ti, inxhinier, je i huaj dhe kooperativa jonë s'ka sepse të të kritikojë, kurse Janit... ta dini nga unë... kanë për t'ja bërë haram bukën.

— Xha Llazo! Dë më lësh rehat apo si e ke punën?

— Jani, e di që ke edhe të drejtën me vete ti?

More, po dale xhanëm, se, të akuzosh, s'ka punë më të lehtë. Por pa ta shoshitim punën hollë-hollë: A e pa Jani ariun e sotmë? E pa. Po a kishte ariunë dorë ndonjë orë «Bulova»? Jo. Dhe Jani ynë e gjeti të udhës të vepronte edhe në bazë të rregullores, edhe në bazë të interesit personal. Tha me vete Jani: «E ç'më duhet mua me këtë ari? Apo mos kam ndër mend të hap hasmëri me të gjithë arinj të Tropojës, të Moravës dhe të Gramozit bashkë...»

Jani bën të qeshë, por balli i skuqet dhe i flet plakut:

— Mos ishin këta, të huajtë...

— Hajde pusho, zagar i djallit!

Për të gjitha unë mbaj shënime. Marieta më pyet:

— Domethënë ju do shkruani për shëtitjen e sotme?

— Po, do të shkruaj.

— Një reportazh?

— Jo.

— Tregim.

— Jo.

— Novelë?

— As novelë.

— Po çfarë atëhere?

— Do të shkruaj për një ditë në mes të pyjeve, një copë jete.

— Pa bosht e pa kornizë? Po kompozicioni?

— Po ja që jetën s'e futim dot në korniza. Dhe në raste kur nuk tentojmë ta bëjmë këtë, atëhere jeta është më e bukur.

Ecim nëpër shkurret e dendura të pyllit dhe më shkon ndër mënd se njerëzit rrojnë nëpër të gjithë rruzullin e tokës duke qenë afër kësaj natyre të madhe, të bukur e të mahnitshme. Jetojnë midis këtij njerëzimi edhe studentë e studentesha, që rëndin të kapin majat më të larta të dijes, të shkencës e të teknikës. Dhe të gjithë këta, vajza e djem, pregatiten të mbrojnë diplomat e tyre duke nxituar nëpër biblioteka, nëpër fabrika e nëpër funde oqeanesh, vozitin edhe pas rrugëve të ajzbergeve, edhe pas rrugëve të mjegulluara të inkasve, ngjiten edhe nëpër polet e tokës, ndjekin vijat e mistershme të shtegëtimit të ngjalave, hyjnë në miniera dhe në laboratore, kurse kjo vajzë erdhi këtu dhe ndjeu frymëmarrjen e pyjeve, nuhati aromën e korijeve, dëgjoi zemrën e saj dhe të popullit, dëgjoi vargjet e folklorit që së pari i ka thithur bashkë me sisën e nënës. Erdhi këtu kjo vajzë, e cila nesër do të merrret me gjuhën, me folklorin, me letërsinë. Kjo vajzë nesër do të japë mendime për punën tonë. Sot mban shënime, por aty nga viti 2000 mbase do të shkruajë se dikur, në mes të maleve, ka njohur një letrar, i cili jetonte atëhere, ishte një mik dhe rob i pyjeve, që nxinte letra dhe shpresonte se ndonjë çikërrimë e punës së tij do të mbetej edhe tej vitit 2000.

Por sot, në krah të kësaj vajze, në gjurmat e saj, ecën dhe s'ndahet kimisti qitës. Mbase ky mund të bëhet shoku i saj në jetë, edhe mund të mos ndodhë kjo. Por ky djalosh me sy të menduar dhe të gjallë e ka bërë zakon studimin, punën dhe ndje-

njën e përgjegjësisë kundrejt atdheut të vet. Në universitet ky s'ka qenë as një «peshkop», as një «kovaç» as një «virus» e as një «maniak i bulevarde».

Më vërtiten në kokë bisedat e sotme, shpërthimi i pleqve me të gjithë bagazhin e tyre të pasur nga jeta, natyra, poezia, folkori, problemet gjuhësore të çamërishtes dhe shtegëtimi i suloteve në katër katundet e Devollit, Isuf Arapi i ashpër, të cilit i binte arma nga supi kur vajzat loznin valle. Por zëri i xha Llazos më preu mendimet. Ai bërtiti:

— Hej! Qëndroni!

Ne ndaluan, por Marieta dhe Naili kanë ikur përpara dhe nuk dëgjuan asgjë. Llazua nuk ju nda atyre:

— Hej, ju, Nail, Marieta! Qëndroni! (dhe duke na u kthyer neve). Po ku i gjejnë gjithë ato fjalë xhanëm?

Më në fund edhe ata dëgjuan, u kthyen nga rruga dhe u nisën për këtej.

— Afrohuni! Afrohuni!

Ata të dy u bindën dhe ja morën me vrap. Ne u bëmë kureshtarë: Çdo nxjerrë vallë xha Llazua kështu? Tani ishim thujse të gjithë kokë më kokë dhe kjo më pëlqeu. Ne, atij mëngjezi ishim thujse të panjohur, të largët, gati të ftohtë me njëri-tjetrin. Tani ndjehemi më të afërt, me shpirt dhe me zemër. Marietës i shkëlqejnë sytë. Më duket se për të gjitha arësyet ajo është me të vërtetë shumë e gëzuar dhe e lumtur. Xha Llazua na hedh duart mbi supe, Marieta është nën krahun vigan të xha Tasit, unë ngjitur me Nailin, shtrënguar pas xha Tasit aq sa i shoh fare pranë kokrrat e kuqe të koçimares. Xha Llazua flet:

— Dëgjomëni mua, do vëmë gomarin përpara, ne do shkojmë të gjithë pas tij!

Xha Tasi u xhingos:

— Or, ta mbyllça derën me grurë, ti ç'na pandeh ne? Gamile jemi ne që të shkojmë pas gomarit?

— O Tase! Tase, o vëlla! Ti je ca i trashë, e kam thënë me kohë unë. Po a nuk e sheh se filladi i veriut na rreh përballë dhe na sjell aromën.

Dhe ashtu u nisëm, por çifti Nail Marieta tani na mbetën prapa. Xha Llazua qesh me cepin e buzeve dhe me atë dhëmbin e tij të vetëm:

— Po si është kjo punë xhanëm! A nuk ndikon aroma e çajit mbi çiftet e rinj? Po ku i gjejnë gjithë ato fjalë xhanëm? Ku?

MJEKU ME DUART E RRFESHME

Ja kushtoj mjekut Sotir Polena

Në shtëpinë e mjekut Stefan Molena, zakonisht gjithnjë kishte patur hyrje-dalje njerëzish të sëmurë, pacientë të çdo kategorie, por, që të mblidheshin aq shumë të huaj, kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë.

Salloni i madh ishte mbushur plot e përplot me njerëz. Doktorin sapo mbushi të gjashtëdhjetë vjetët dhe qyteti kishte vendosur t'i festonte këtë jubile atij njeriu, që qytetarët i detyronin shumë dhe atdheu i ishte mirënjohës.

Abazhuret e rënda të tavanit ishin ndezur të gjitha, qilimi i madh me push të trashë sikur ishte spërkatur me një cipëzë të hollë hiri, me një farë pluhuri në ngjyrë të plumbit. Miqtë dhe të ftuarit kishin ardhur, kërcisnin karriget dhe kolltukët, nëpër korridoret rendnin të katër vajzat e doktorit të shpejta, të nxituara, të emocionuara me nga një përparëse shërbimi.

Pastaj filloi një farë ceremonie zyrtare. Filluan të mbaheshin fjalime. Doktorin vuri re se miqtë, ata

më të moshuarit, vunë syzet dhe lexuan çka kishin pregatitur, kurse një mjek djalosh foli pa letër, i qeshur, i shkathët, si një spiker varieteje duke vësh-truar herë doktorin, herë të pranishmit.

Thuheshin fjalë joshëse, ziheshin në gojë raste, vepra, vite, sakrifica, shërbime dhe mënyra. Mjeku djalosh vijonte të fliste duke mbajtur pëllëmbët hapur në drejtim të doktor Melenës:

— Mjek do të thotë t'i shërbesh njeriut, ta duash njeriun. Mjek do të thotë të mos hash kurrë bukë në orar me fëmijët e tu, të mos mbarosh kurrë gjumin gjer në fund, të mos e dallos ditën e zakonshme nga ajo e pushimit. Mjek do të thotë të kesh të bësh me vdekjen, do të thotë të jesh përditë, për orë e për çast ballë për ballë me vdekjen dhe ta mundësh atë, . . .

Salloni i tërë shkëlqente nga dritat, ai kishte një hije të rëndë nga veshjet e burrave, ai ishte gati i përmbytur nga ngjyrat e ndezura të veshjeve të vajzave, nga flokët e kapur me kordela që përkëdhelnin përkreset e kolltukëve të rëndë. Pak më parë, atje zienin bisedat më të ndryshme midis grupesh djemsh e vajzash. Flisnin për muzikën dhe për modën, për kërcimin së larti të kampiones së vendit, flisnin për ngjyrat e bluzave të akrelonit, për një ndeshje futbollit të zhvilluar në Kavajë në një terren të vështirë balte e shiu. Doktorin vinte re vajzat e tij që ishin të shqetësuara, kurse Meri, e shoqja, fshinte sytë me shami.

Me të gjithë ata njerëz që ndodheshin në sallon, doktori kishte patur të bënte në mënyrat më të ndryshme, gjithnjë brenda kuadrit të profesionit të tij si mjek dhe si njeri. Në karrierën e tij të gjatë

dyzetvjeçare, kushedi sa herë i kishin hyrë e dalë në shtëpi, në spital apo në poliklinikë. Rastet? Hajt dhe i mbaj mend. Por ata, të pranishmit, natyrisht ishin në gjendje t'i kujtonin me hollësira, me data e me ditë ashtu si çdo nënë di ekzakt ditëlindjet e fëmijëve të vet.

Doktor Molena ishte kredhur në kolltukun e tij të rëndë dhe priste atje kur miqtë i afroheshin dhe i jepnin dorën. Ai kujtonte tani se po atje kishte ndenjur dikur edhe i ati, mjek edhe ai. . .

«Mjeku plak, baba Vasili, si e thërrisnin, me ato mustaqet e gjata sipas modës së asaj kohe, me atë ballin e gjerë, të madh e të ndritshëm, me unaza të rënda nëpër duar, duke përkëdhelur kokën e bastunit të argjendë, duke i folur të birit: «Mjerë ai djalë që nuk ja kalon babait, mjerë ai çirak që s'ja kalon ustait». Të sëmuret e fillimit të shekullit, pleq me fustanella e me jelekë. Ajo kohë që mbante akoma vulën e shekullit të kaluar me atë farmacinë e vetme në atë labirint dhomash përdhese, me ato kutirat e mëdha prej kartoni të shkruara arabisht. Ajo kohë kur babai shkruante dy palë recetash: për në «spiceranë» dhe për te bakalli. Të plagosur nga hasmëria, të cilëve u nxirreshin plumbat me disa mënyra mizore, pastaj njerëz të rrahur nga inatet, që baba Vasili u fuste trupin në lëkurë të ngrohta delesh të sapotherura.

Babai pati tetë fëmijë dhe tre mjekë në shtëpi, unë i vura në rrugë për mjekë djalin dhe dy vajzat e mia. Babai kurrë s'deshte që vajzat të mësonin për mjekte. Kurrë. . . Babai ishte zemërmadh. . . Ku e gjente ai gjithë atë humanizëm dhe forcë shpirtërore përbrenda vetes së tij. . .?»

Doktor Molenës sot i kujtohet ai viti i tmerrshëm i epidemisë në fillim të shekullit. Difteriti, gryka e bardhë, po bënte kërdrinë në fëmijët. Kambanat e kishave s'pushonin së gjëmuari në zi. Sapo ktheheshin nga një varrim, gjenin fëmijën tjetër të vdekur. Edhe baba Vasili u nis për në një varrim. Te shkallët një grua e popullit me lot ndër sy:

— Baba Vasili, të ndritë shpirti në këtë jetë dhe në atë tjetrën, të dy fëmijët m'u sëmuren nga grykët... më thanë se keni gjëlpëra...

Por plaku kishte vetëm dy ampule. Dy të vetme. Dy ampule dhe tetë fëmijë. Stefani rrinte i kruspullosur te shkalla dhe dëgjonte lutjet e gruas së mjeruar.

— Ju lutem, baba Vasili.

Plaku hyri në shtëpi, mori të dy ampulet dhe bëri të niset me gruan. Por e shoqja doli e qëndroi:

— Burrë! Çfarë po bën? Po nesër kur të të sëmuren fëmijët e tu?

— Fëmijët e mi, grua, fëmijët e mi, lavdi zotit si i sheh, sot janë shëndoshë si molla...

Dhe të dy fëmijët e gruas së popullit shpëtuan. Po, kur u kthye Vasili nga varrimi, gjeti dy nga fëmijët e tij të sëmurë. Kurse të nesërmen ata u keqësuan dhe pas tri ditësh, Stefani i vogël mbeti me dy vëllezër më pak. Të dy fëmijët e doktor Vasilit vdiqën.

«A kam mundur unë t'ja kaloj babait? Le të jem i çiltër me vetëveten... Mua më dhanë dorë shpikjet më moderne të shekullit, barnat, metodat, përparimi i shkencës, më ndihmuan këshillat e babait, por atë humanizmin e tij të pamasë e të pa-

fund, unë kurrë s'kam mundur ta arrij. Kurrë! Pas-taj babain e goditën aq fatkeqësi...»

Doktori kishte edhe një vëlla tjetër. Zhvillimi i tij fizik dhe mendor ishte aq i jashtëzakonshëm, sa plaku Vasil, tek ai kishte shpresat më të mëdha. Andoni mbaroi gjimnazin e Manastirit në katër vjet; pa ditur anglishten u nis për në Amerikë, rrugës mësoi aq anglisht sa e pranuan në universitet. Sapo mbaroi, u kthye në atdhe. Ishte koha e pushtimit turk dhe djaloshi organizoi një manifestim sportiv me shokët e tij. Në manifestim erdhi «të mbante sehir» edhe komandanti turk Rexhep Palla, i famshmi antishqiptar, që e fitoi këtë mbiemër në qytetin e Korçës. Ky anadollak i pabesë, me të mbaruar lodrat e djemve, u foli zabitëve të tij:

— Ky Andon djalli do na hapë havaze, duhet qëruar...

Të nesërmen i vunë shtatë xhandarë që ta provokonin. Por djali ishte aq i fortë fizikisht, sa i rrahu të shtatë. E arrestuan për «kundërshtim të rendit publik». Atëhere u ngrit gjithë qyteti më këmbë. Vala e protestës ishte aq e madhe, sa Rexhep Palla s'dinte nga t'ja mbante. Të nesërmen, një farë Lipe Lugati, i çoi Andonit në burg një gotë me çaj. Pas disa orësh djali vdiq duke vjellë shkumë të gjelbër. Dhe vetëm pas disa ditësh, Rexhep Palla, që e kishte mbushur kupën me egërsitë e tij, e pati fundin nga pushka e Themistokli Gërmenjit, që e vrau në kafene kur po lozte kumar.

Këto kujton tani doktori që po feston të gjash-tëdhjetin vit të lindjes së tij. Ai mban duart përpara dhe dashur padashur, sytë i shkasin te një çika-triçe, që ka më shpinë të pëllëmbës së majtë. Për

raste të tilla, ai u këshillon pacientëve: «Po s'të ngau, mos e nga». Por kolegëve të tij ai u tregonte: «Kjo çikatriçe, që kam unë, nuk do të mbyllet, ka kaq vjet dhe s'dëgjon në asnjë mënyrë, dhe është kanceroze. . .»

Ajo s'u mbyll gjersa doktori shkoi në Budapest dhe atje i bëri një plastikë, i shkoi përsipër lëkurë nga e tija.

— U mbyll? Do ta shohim! Pastaj djema, të shkosh në luftë, të luftosh për dyzet vjet me radhë dhe mos të të kapë asnjë shigjetë e armikut? A mund të ndodhë kjo? Vështirë se ndodh.

Tani doktori, në pritje të miqve i mban duart përpara, të holla, delikate, nervoze dhe gjithnjë të shpejta. Ai i mban duart përpara, sikur do të vërë në dukje, sikur kërkon t'u tregojë të gjithëve dhe vetes se duart (barometri më i saktë për një mjek kirurg) s'i dridhen aspak dhe ai është ende i ri, i shkathët, me ato duart e veta nervoze dhe gjithnjë të përpikta, që askush s'ka thënë dot se ua ka kaluar, ai është në gjendje të punojë dhe t'u shërbejë njerëzve, të bëjë operacione dhe diagnostikime, ai është më në formë të mirë sot se dje, sepse «vera e vjetër është gjithnjë më e mira, më e forta, dhe përvoja e këtij mjeku ka arritur caqe të tilla sa për të, s'është më përkitja në regjionet e zemrës, as përkitja e pulsit, as matja e temperaturës te pacienti që operohet. Doktor Molena, me një të he dhur të syrit, me një shikim të shpejtë mbi fytyrën, me një prekje të hollë të lëkurës dhe me intuitën e tij të regjur, e ndjen gjendjen e pacientit.

Por ja se Lanua, infermieri i tij i vjetër i afrohet. Lanua sonte ka vënë një përparëse të madhe

shërbimi përpara, është bërë kamerier, por duket ca qesharak.

— Doktor, ka ardhur një njeri nga lagjja poshtë, më duket i çuditshëm.

— Ç'gjë të çuditshme ka?

— Ka një gjaje ndër duar dhe thotë se do të vijë t'ja buçasë një herë për shëndet të doktorit se është borxhli...

— Mos është i pirë?

— Më duket se jo.

— Lëre të vijë.

I posaardhuri ishte një burrë i gjatë me buzë të trasha, veshur me rroba doku blu e me pak thinja në tëmthat. Hyrja e tij shkaktoi një farë ilariteti në sallon. Ai u mundua të ecte drejt e jo me hapin e tij të zakonshëm. U përkul para doktorit dhe i uroi:

— Të bëhesh dyqind vjet, doktor, se njerëzit kanë nevojë për ty... dhe unë nga ana ime që të jam shumë borxhli, do loz një këngë me gjajden time... (ai vështroi anembanë dhe u drodh). Oda qenka e madhe, me lejen e zotrisë suaj...

Molena ishte i mallëngjyer për fjalët që dëgjonte, për datën e daljes në pension që po vinte, për fundin e vet që kujtohej në raste të tilla, sepse rastet si ky i sontmi, dashur padashur të ngulin në kokë mendime të tilla ashtu si moshë të ngul në kokë thinjat dhe në ballë rrudhat.

— Doktor... a e mban mend atë natë?

Molena hapi duart e ngriti supet duke vështruar nga Lanua, infermieri i tij, por edhe Lanos s'po i kujtohej gjë.

— S'ju kujtohet, doktor? — pyeti i panjohuri. Ju e gdhitë gjithë natën mbi kokën e tim biri!

— Më fal, po...

— Si është e mundur? Ju s'fjetët fare asaj nate, s'ju kujtohet Bezati im, kish një plagë në kokë, ju...

— Po tashti si është? — pyeti doktori si për të kapërcyer këtë farë naiviteti të vizitorit. Por ky u gëlltit dhe uli kryet:

— Vërtet s'e mbajtke mend doktor... por unë s'e harroj dot kurrë njerëzillëkun tuaj, më falni se ju shqetësova, por unë erdha t'ju uroj...

Ai ngriti lart kavallin e gajdes, por me një vrull të beftë sikur kreu një kërcim e pastaj zëri gazmor i gajdes e mbushi sallonin tej e ndanë.

Dhe u deshën vetëm pak rendje të gishtave mbi kavall, u deshën veç disa përkëdhelje të bërryleve mbi kacek, veç disa përpëlitje të pizgës dhe ajo derdhja e papritur e pasionit të gajdexhiut që t'u mbushej mendja të gjithëve se kishin përpara një mjeshtër të gajdës, që ndjenja e thellë e mirënjohjes po i jepte dorë edhe më shumë që ta mbushte gjithë sallonin me artin dhe shkathtësinë e tij. Doktor, edhe se i mallëngjyer, u ngashërye më fort dhe vuri dorën mbi zemër. Tashmë nuk buçiste gajdeja, thujse ajo s'dëgjohej fare. Tani ishte duke shpërthyer shpirti, fryma, muskujt dhe zemra e atij njeriu të panjohur. Molena kurrë s'kishte dëgjuar diçka të tillë. Kurrë. Dhe u kujtua se dikur kishte parë një pianist polak, që, kur e rrëmbente muza dhe pasioni, i lozte tastierat si i çmendur dhe flokët i binin mbi fytyrë. Ai kishte parë një kitarist spanjoll, që gati e shtrydhte veglën kur lozte me të. Kishte parë një kubaneze zezake, që lozte pianon aq ëmbël dhe aq qetë. Kishte parë dikur një klarinetist maqedhonas, që, i rrëmbyer nga kënga, gati i pëlcsinin

sytë dhe gati i çohëj gjoksi. Kishte parë një virtuoze rumun, që, kur lozte violinën, ikte «në atë botë» si Paganini. Kishte parë edhe një çek me violinë, që, pasi ju këput teli sapo doli në skenë, kërkoi të falur, rivendosi telin dhe pastaj... edhe bilbilat do të ishin nemitur po ta dëgjonin. Po... kur doktor Molena pa këtë vizitor, kur vuri re shkathtësinë dhe vrullin e tij, kur dëgjoi gjer në fund atë shpërthim të papritur tingujsh dhe shpirti, ndjeu se përmbi të gjitha e përmbi të gjithë ishte me zemër e me shpirt, më afër këtij njeriu me të cilin e lidhte trualli i mëmëdheut dhe jeta e Bezatit, të cilin tashmë e kishte harruar.

«Edhe zemra ime është më afër këtij njeriu nga të gjithë ata që shkova nëpër mend, qoftë edhe sikur të kisha parë dhe dëgjuar orgat e Shën Pjetrit, orkestrën e San Luisit ose atë të Berlinit».

Tani u derdhën fëmijët e tij me pjatat dhe shisheet. Doktorin ende i quante «fëmijë» vajzat e tij. Ato rendnin sonte nga një qosh në tjetrin, të lumtura, të gëzuara që e shohin «tatën» plot shëndet dhe gjallëri, në këtë natë të paharruar, kur atë e porositin nëpër fjalime që të çlodhet, të gëzojë familjen dhe fëmijët.

Përsëri u duk Lanua në sallon, bashkë me atë përparësen e tij të madhe.

— Ç'ke, Lano?

— Një tjetër i panjohur se ç'është atje poshtë e kërkon të hyjë... për urim thotë, ka diçka në shpinë...

— Le të vijë.

I posaardhuri mu në prak të sallonit lëshoi një thes të mbushur rëndë. Nga kreu i thesit u du-

kën disa degëza me fletë. Me siguri ndonjë bimë e nxjerrë me gjithë rrënjë dhe e sjellë me dheun e vet.

— Mirëmbërëma — foli i panjohuri — e zëri i tij prej malësori ishte aq i thekshëm, sa u ndien veç disa trokëllitje të lehta mbi pjatat e porcelanit nëpër tryezat, e pastaj qetësi në krejt sallonin.

Ai ishte një burrë nja gjashtëdhjet vjeç, i veshur me roba shajaku të zi, me këpucë të rënda me gozhdë, me një xhamadan të gjerë dhe mustaqe mesatare.

— Mirëmbërëma! Ardha, zoti doktor t'ju uroj ditëlindjen. Dje mora vesh dhe sot u nisa. Dorën s'jua jap, se e kam me dhé, por njëlloj është, unë zemrën e jap për ty. Dyqind vjet u bëfsh, doktor! Si njeri që vij nga pyjet, të kam sjellë një diçka të vogël. . .

Doktori u ngrit dhe i dha dorën të panjohurit. Sytë i shkanë te gryka e thesit dhe sytë i xixëlluan, Ai e njohu në të parë. Një mjeku profesionist dhe një amatori botanist si ai, s'mund t'i shpëtonte kjo. Dhe s'u gabua. Atje, brenda në thes, ishte një bisk llex *Aquafolium*. Të tillë s'kishte në kopshtin e vet botanik dhe as që e dinte se rritej edhe në pyjet tona. Doktori kishte parë të tillë në pyjet e rrethëve të Vienës, kishte takuar në Insbruck të principatës Likstenshtain, edhe në Munshen. «Po, po, dru zbukurimi i familjes së dafinës, gjelbërosh dimër e verë, fletët e forta dhe si të lyera me një vernik të gjelbër. Kur rritet kërcelli, çdo fletë lëshon katër kokrra jeshile që skuqen e bëhen si qershi. Ja si reflektohen dritat mbi gjethet e ndritshme. . .»

— A më kujtoni mua, doktor?

Përsëri plaga e tij e vjetër. Ai gjithnjë ka patur dëshirën që t'i kujtojë pacientët e tij dhe gjithnjë

s'i kujton dot. Janë shumë, sigurisht, po ndoshta nga mosha. Ikin vjetët, koka më s'nxe as kujtime të reja, as impresione të ditës, as fytyra të çastit, koha...

— S'ka gjë doktor, të kujtoj unë. Ti për vajzën time, bëre sa munde, luftove me vdekjen dhëmb për dhëmb por... (pa e thënë, u kuptua) ti luftove me vdekjen si burrë, po...

Doktori u mallëngjye dhe deshte të ndërronte bisedë:

— A ke fëmijë të tjerë?

— Po, kam edhe katër.

— Të të rrojnë.

Malësori tregon pëllëmbën e vet. E tregon dhe s'flet, por të gjithë e kuptojnë. Ai kërkon të thotë: «Këtu janë pesë gishta, secili ka vendin e vet, e secili, po u lëndua, dhemb njëlloj.» I posaardhuri përkëdheli fletët e filizit.

— Ta mbillni kështu si është, doktor.

Ai tha «ta mbillni kështu si është» pa zënë në gojë dheun, dhe doktori e kuptoi. Por ja që Lanua bën një gafë dhe pyet:

— Nga dheu e keni nxjerrë?

— Lanooo!

Doktori e pa nga afër mikun e tij të vjetër dhe sytë i shkrepëtinë. Dhe Lanua u kujtua se sytë e mjekut xixëllojnë ashtu vetëm në sallën e operacionit, atëhere kur në vend të bisturisë i jepet klemeri.

— Sigurisht, Lano, nga gurët s'e ka shkukur. Eja o mik!

Doktori e vuri afër vetes malësorin. Tani ishte midis dy miqve të panjohur dhe kjo e gëzonte, se i dukej sikur pikërisht këta të panjohur, përfaqëso-

nin atë turmën e pafund të pacientëve të tij, që u kishte shërbyer për dyzet vjet me radhë dhe që u kishte harruar emrat.

Një fërfërimë e nxituar... Te dera e sallorit një çift i ri. Djalë e vajzë të posafejuar. Rinia dhe shëndeti u shkëlqen në fytyrat. Kanë sjellë një tufë të madhe lulesh. S'është as tufë e as buqetë, por është një vandak i plotë me trëndafilë. E mbajnë të dy dhe sa shumë u shkon. Por edhe këta, për sytë e doktorit janë të panjohur. Molena u ngrit. E para ju afrua vajza. Ajo ishte një brune shtahedhur me sy të kulluar, e drojtur dhe e turpshme si një vajzë konvikti, që sapo ka ardhur nga fshati. Flokët i kishin marrë aromën e trëndafilëve dhe të bisqeve të gjelbër. Dhe doktori s'po i binte dot më të: Me cilin nga të dy kishte patur të bënte? Po ja se ju afrua djali. Dukej tepër i ndjeshëm dhe e pa Molenën në ata sytë e tij ekspresivë ku butësia e vështrimit përzihej me vrullin e vitalitetit.

Të rinjtë mbetën të dy para mjekut, të drojtur, të heshtur, duke kafshuar buzët e veta, rrinin atje duke vështruar më fort duart e tyre, sikur po prisnin nga Molena që t'i uronte a t'i bekonte. Por nga një intuitë e çuditshme doktorit diçka ju kujtua. Sa dendur atij në rrugë, në punë apo në udhëtim, bile edhe në kampet e pushimit, edhe në tren, edhe në bregdet i dilnin përpara djem e vajza të turbulluar, të emocionuar, i shtrëngonin dorën dhe për asnjë rast s'kishin patur kurajën t'i thoshin se çfarë i lidhte ata me mjekun! Por këto raste e këta tipa tashmë i ishin bërë të zakonshëm. Djemve u nënqeshte dhe u tregonte majat e veshëve, kurse vajzave... Vajzave u lutej:

— Hej, vajzë, pa hiq mënjanë ata flokët përmbi veshë... pa hiqi!

Ja, po kështu i foli edhe brunës së sapofejuar. Ajo u bind dhe mjeku pa edhe një herë shenjat fare të vogla të pencave mu në krye të lopëzave të trëndafilta të vajzës. Doktorin, për gjithë këta, thoshite: Janë nga turma e atyre që kanë lindur si Makdafi!

Në sallonin e madh filloi të lozte orkestra, miqtë dhe të ftuarit ngrinin dollitë dhe uronin, rinia vallëzonte në sallon dhe në korridoret. Molena e ndjente veten aq të emocionuar, sa ju desh të dilte lart në tarracën e madhe. Njëra nga vajzat e shoqëroi dhe pastaj u tërhoq. Ajo e dinte se ai, në çaste të tilla, deshte të mbetej vetëm.

Natë. Buzë vjeshte. Ajri sapo kishte filluar të merrte freski dhe shushurinte ngadalë nëpër fletët dhe degët e vishnjave në oborr. Mbi krye, në kupolën e pallatit, që ngrihet mbi gjithë qytetin si një vazo e madhe mermeri, lejlekët kishin mbetur pa gjumë. Dëgjohej krakavitja e tyre, që ngjet me përplasjen ritmike të dy fletëve papirus.

«Qyteti fle, dritat e rrugëve janë tepër të bardha nga përdorimi më i ri i llambave me zhivë. Parullat e kuqe me drita hapen e mbyllen nëpër pullazet e sipërme të pallateve. Ja drita të lëvizshme. Një automobil i lëshuar me shpejtësi drejt spitalit. Ç'të jetë vallë? Një lindje e vështirë apo një aksident? Sidoqoftë ata do të telefonojnë, pastaj atje janë djemtë...»

Dhe doktorit i shkojnë para syve të mendjes ata mjekë të rinj, që erdhën në spital si çuna të drojtur me diplomat në xhep.

«Disa kanë mbaruar jashtë, disa në kryeqytet.

Vërtet erdhën të drojtur, por jo nga padija, njëri prej tyre e tregoi turbullimin e tij: «Si do ta kapim bisturinë ne, përpara atij që vetëm në një vit kreu tremijë e ca ndërhyrje kirurgjikale!» Por unë gjithnjë i kam pritur mirë, u mësova edhe çikërrimat më të holla të mjeshtërisë, por megjithatë kështu dëgjova pëshpëritje...»

Njëri nga djemtë e rinj kishte thënë:

«Ai na dha gjithshka, por vetëm një gjë s'mundet të na e japë... s'mundet të na japë atë shpejtësinë e tij të jashtëzakonshme, atë dinamizmin dhe energjinë e tij të pushtetshme...»

«Ja, qyteti im është i tëri nën sytë e mi. U rrit shumë. Ikën shumë njerëz ashtu si shkojnë gjithnjë kur brezat ndërrohen, por... më shumë kanë ardhur. Ne i kemi krijuar njeriut një kordon sanitar dhe qyteti ynë u dyfishua. U rrit, u ndriçua. Zemra e tij rreh ditën dhe natën. Zemrat e njerëzve dhe zemrat e fabrikave. Si ishte qyteti, kur u ktheva unë nga universiteti?! I vockël, i zyrtë, qytet i tezgave, i barrakave, i kishave. Kishte dy karroca të vdekurish, që tërhiqeshin nga kuaj të zinj, njëra karrocë për të krishterët, tjetra për muslimanët. Qytet me një fabrikë të huajsh, me një bankë të huajsh dhe me gjashtëmbëdhjetë sarafë vendas. Ç'po shkoja ndër mënd. Po. Brezat që ndërrohen. Edhe unë, sigurisht një ditë do shkoj. Ku do më zërë vdekja? S'e di. Por në çdo rast duhet të jem në punë».

Doktori nënqeshi. Ju kujtua një plak. Ai dikur i lutej në pavion:

— Nxirrmë nga spitali, doktor.

— Po ti je i sëmurë, ti s'ecën dot.

— Këtu jam keq, por në shtëpi do vete të punoj.

— Po ti s'mund të punosh.

— Në fushë s'dal dot, se këmbët s'më dëgjojnë, por do thur kosha në shtëpi, duart i kam të forta. Dhe ta dish, doktor, kur punon, je më i gëzuar, më i fortë, vdekjes s'ja ke frikën fare, se, kur je në punë, ajo s'afrohet. Për vdekjen duhet të jesh i ngeshëm...

«Qyteti im! Për ty bëra sa munda. T'i shërbesh njeriut është virtuti më i madh. Kur mbyll një plagë, kur shpëton një jetë, kur të del një fshatar me një bohçe ndër duar... Ai zbret shkallët e spitalit i emocionuar dhe i gëzuar. Ai këtu është i vetëm, por larg, pas tij janë një varg fëmijësh. Ai më jep dorën të shkallët dhe mua më duket se drejt meje shtrihen dhjetëra duar, ai qesh me të dy sytë e tij e mua më duket se qeshin me dhjetëra sy. Këtu rreh zemra e tij me mirënjohje, por unë e di se, kur ai të kthehet në familje, do rrahin njëherësh me dhjetëra zemra. Qyteti im! Unë një ditë do iki, por unë dua të të shërbej edhe tej varrit. Si i nisa unë ditët e para të punës sime?»

Ndër ato ditë, aty nga viti 1933, në skuadrën e futbollit të qytetit luante edhe një djalosh esmer, tepër i shkathët, por shumë i varfër. E quanin Lano. Ai luante me gjithë shpirt dhe ishte një talent i vërtetë. Por djaloshi nuk kishte se si të ushqej sipas energjive, që konsumonte. Atëhere ja çuan Molenës në spital dhe ju lutën:

— Doktor, në shërbim të sportit dhe të dashurisë së qytetarëve për sportin, të lutemi gjeji një punë këtij djaloshi dhe mbi të gjitha, jepi të hajë sa të ngopet.

— Doktor! Paguaje sa të duash, por vetëm ushqeje mirë!

Molena s'kish se çfarë të bënte tjetër veçse ta vendoste pjatararës në spital. Dhe ashtu bëri. Dhe djali punonte aq mirë, sa kryekuzhinieri (njeri që futbollin e quante marrëzi) i jepte të hante sa të ngjishej. Herë për dëshirë, e herë për kuriozitet doktori shkonte e shihte Lanon edhe në praktikat, edhe në larjen e pjatave, edhe në ndeshjet e futbollit. Dhe pikërisht këtu Molena vinte re diçka të jashtëzakonshme te djali. Ky djalosh truphedhur, nëpër ato orët e ethshme të ndeshjeve, nëpër ato çastet e sulmeve dhe kundërsulmeve, kur i gjithë qyteti brohoriste e tifozët gati çmendeshin duke bërtitur, duke tundur zile e këmborë, duke djegur kapela e xhaketa e duke gëlltitur pa përtypur fara bajamesh e kikiriku, në ato ndeshje kur nxehej gjaku e tendoseshin nervat, futbollisti pjatararës ishte kurdoherë korrekt me kundërshtarin. Bile, edhe kur e provokonin, Lanua përmbahej. Kur dikush aksidentohej në fushë, ishte i pari Lanua që rendte për ta ndihmuar, le të ishte shoku i tij apo kundërshtari,

— Pjatararësi me zemër të madhe! Pjatararësi humanist! Ky njeri meriton një fat tjetër!

Doktori e thirri lart në sallën e operacionit.

— Ti, djalë, do bëhesh infermier!

— Unë infermier?! — Lanua po hapte sytë.

— Po, po, ti.

— Po unë s'di, unë...

— Do të të mësoj.

— Po unë jam futbollist, këtu kam ardhur për të ngrënë...

— Stina e futbollistit mbaron shpejt, djalosh, vish një mantel të bardhë dhe kthehu përsëri këtu. Ti ke lindur për t'u shërbyer njerëzve!

Ëndrra dhe parashikimi i Molenës dolën sakt. Doktorin me intuitën e vet prej njeriu praktik dhe prej njeriu me sulme të forta shpirtërore, njeriu me energji të pashtershme, u dha pacientëve pikërisht njeriun që u duhej. Lanua shumë shpejt u bë kryeinfermier i gjithë spitalit dhe asnjëherë Molena nuk dyshoi t'i jepte në dorë bisturinë dhe pincat në sallën e operacionit.

— Djema! Djema! — bërtiste Molena në sallën e mbledhjeve. — Lexoni, merrni shembull nga ky djalë, që e filloi karrierën si pjatolarës! Ky njeri ka një etje të çuditshme për të mësuar dhe për të lexuar!

Por jo të gjithë e dëgjonin doktorin, atëhere ai vërshonte:

— Injorancën e mjekut e paguan pacienti me plagët e tij, me infeksionet, daç edhe me jetën. Kush s'lexon, do t'i thahet shpirti e do të katandiset në një xherah.

Për vete Molena ishte i apasionuar pas Gëtes dhe Shilerit. Ai citonte Shekspirin dhe Tolstoin, recitonte përmendësh vjersha të Nolit, prekej thellë nga Migjeni dhe e kritikonte për gjuhën. Njëherë, kur disa mjekë nuk e dëgjuan për të lexuar, atëhere ai, nervoz dhe sarkastik, citoi Qezarin:

«Rreth meje njerëz le të kem të ngjallmë dhe kokë rrumbull dhe që flenë natën...»

...Ky Kasi atje lexon paprerë, është i madh vërejtës...

Po a e dini, kolegë, se kush ishte Kasi? Eh, ju s'e dini se kush ishte Kasi!? Për Kasin pak dinte edhe Noli, që e bëri të flasë shqip, Kasi! Kasi, o

Noli, Kasi ishte Shën Pjetri, që këshilloi të mos lëshohet kamxhiku më 1924. . .»

Dhe «kokërrumbullakët» mendonin se Molena fliste përçart.

Lart në tarracën e madhe. Molena u mbush me frymë dhe përkiti dorën e majtë, atje ku ishte ajo blana djallëzore. E përkëdheli pak dhe e la. Thuajse e harroi. Hodhi sytë larg, tutje nga jugu.

Kur u kthye nga universiteti, ai kishte një varg të pafund planesh. Dhe midis dëshirave dhe dashurive, midis mundësive dhe pengesave ai filloi të vepronte.

Molena ngriti një kopsht zoologjik, një akvarium të madh për rritjen e peshqve, ai ngriti një kopsht botanik ku kaktuset dhe palmat rriteshin në temperaturat e duhura. Doktorin bëri çmos gjersa lart në kupolën e shtëpisë së tij erdhën dhe ngritën follenë një çift lejlekësh. Një herë një fshatar nga Prespa i solli një sorkadhe të gjallë. Doktorin shpejt e shpejt i ngriti një strofkë të re në kopshtin e vet zoologjik. Gjente kohë dhe e vërente sorkadhen sqimatare, por. . . një ditë. . . kafsha e sjellë që nga pyjet e largëta, e mësuar të jetojë në liri dhe të bredhë mal më mal. . . sorkadhja e bukur, u lodh së vërtituri nëpër strofkën e ngushtë.

— Fare papritur, — tregonte Molena — fare papritur ajo ra në gjunjë dhe nisi të më vështronte me ca sy të këputur. . . pastaj për habinë time sytë e saj u mbushën me lot. . . sorkadhja po qante! Atëhere s'munda të përmbahesha më. . . Çela derën e strofkës dhe e lashë të dilte. . . Në çast sorkadhja më kuptoi dhe u derdh përjashta! Doli në rrugë, në bulevard, njerëzit po habiteshin me një sorkadhe

në mes të qytetit, por ajo... e shpejtë dhe e zgjuar, ja dha vrapit dhe mësova se kishte arritur në Moravë...

Viti 1935. Në qytet erdhën princeshat mbretërore të shoqëruara nga Musa Juka Efendia.

Doktor Molenën e njoftuan se «Naltësitë e Tyre do ndodheshin në spital të nesërmen dhe atje të gjithë shtetasit besnikë të Nalt Madhërisë së Tij do t'u puthnin dorën princeshave auguste!»

Doktori vendosi të mbyllej në shtëpi dhe të mos shkonte për t'i takuar. Kur ja... në portën e tij prej trinash të hekurta, shtyp butonin një mesoburrë. Ai i zgjati një kartëvizitë portierit dhe papritur përgjegjen mori shkallët përprjetë. Molena e njohu. E kishte parë dikur në Vienë kur zotëria e tij Sotir Martini dilte e shëtiste duke i kërkuar Madhërisë së Tij ndonjë nuse prej Evrope. Dhe ky zotni njihej me titullin: Shef i ceremonive të pallatit mbretëror (me M të madhe).

Me t'u takuar me doktorin, vizitori i shpjegoi zotit Molena se:

— Kam ardhur si mik t'ju ndihmoj dhe t'ju shpëtoj... yt at fanolist, ti fanolist, rrethi yt po me këtë damkë. Ti e ke emrin me bojë të kuqe, ja pra ku e ke rastin ta shlyesh bojën e kuqe...

— Jo — ja ktheu thatë Molena.

— Po ti dëgjomë mua, ne jemi edhe miq.

— Më lërë të qetë.

— Domethënë ti... — u hodh në sulm Martini — domethënë ti je ithtar i Mjekarës? Turp, doktor! Turp për emrin që ke dhe për shkollën ku ke kënduar! Ajo mjekra jote s'ka haber të mbretërore, të ish puna për ndonjë kungatë, për ndonjë lindje a për ndonjë vdekje, për të tundur ndonjë temjanicë

ose për të shkruajtur bejte të turpshme të një farë dervish babai... Turp, doktor, se ajo mjekra jote po gjezdis grazhdeve të botës dhe po shan me bejte Madhërinë e Tij... Dëgjomë mua, ti do vish t'u puthësh dorën princeshave, do vish!

Sytë e Martinit xixëllonin nëpër gjyzlykët e tij të rrumbullakët dhe të kapur përmbi hundë. Molena mori një vendim:

— Po, do të vij!

Doktori kishte vënë duart kryq mbi gjoks dhe e shihte nga lart:

— Tashti, zoti Martini, keni gjë tjetër për të thënë?

— Po, doktor, tashti që u bëmë miq, tashti kam diçka personale.

— Pa ma thuaj.

— Ja, doktor, më dhëmbin gjunjët, krejt këllqet nga ana e sipërme, me çajne e më dhëmbin çdo mëngjez deri në drekë, pas drekës sikur më shkon e keqja, po të nesërmen në mëngjez më fillon përsëri... ç'djali të më dhëmbin kështu xhanëm, unë s'bares as më këmbë, unë gjithë ditën mbi «Ford-et»

— Atëhere, Martini, mos shëtisni natën?

— Jo të keqen, doktor, ç'ne... mua më dhëmbin dhe më vjen edhe si më të përzierë...

— Mos të vjen edhe si më të shtriqu?

— Hë, më qafsh, doktor, edhe ashtu më vjen.

Sotir Martini i ulur në karrige, kishte hapur gjunjët gjer në masën më maksimale, kishte vënë duart mbi këllqet, kokën e ngritur, gojën hapur, sytë çapluar dhe priste këshillat e doktorit. Por Molena s'po i thoshte asgjë. Doktori shtrëngonte

buzët, dejet e faqeve, i dridhej mjekra dhe nga sytë po bëheshin gati të delnin lot... E ashtu ja plasi të qeshurit!

Të nesërmen princeshat mbretërore mbërritën në spital me veturat e zeza «Ford», me veshje nga moda e fundit pariziane, me nga një vello mbi fytyrë. Këto lloj vëllosh me fije të rralla e me disa kokrriza aty-këtu, mbulonin fytyrat e të dërguarave të mbretit, që ishin njëkohësisht edhe patronate të larta të degëve më të shquara të jetës. Princesha bulldoke Maxhide, e shëmtuar, e trashë, gdhë nga kultura, tapë nga zgjuarësia, ishte patronate e lartë e kryqit të kuq, princesha Sanije patronate e lartë e sportit, princesha Rukije, e hollë, e gjatë dhe fytyrë spec ishte patronate e lartë e arësimit...

Por... Skandal në spital! Kryemjeku, njeri me dije e me kulturë, na doli një polenak i pagdhundur! Ai maskara e i pacipë nuk u puthi duart princeshave! Bile as edhe gjurin nuk e përkuli!

Pyetjes së patronates së lartë të kryqit të kuq ai ju përgjegj thatë:

— Po, kemi shumë punë, sepse njerëzit ushqehen keq!

Në të thënë të së vërtetës troç dhe drejt përpara, doktori mbeti i patundur gjatë gjithë jetës së tij.

Kur mbaroi vizita, doktori, që nga dritarja e sallës së operacionit, pa se si shkanë veturat e zeza në rrugë. Ato sapo ishin kthyer nga shëtitja nëpër vendet skandinave dhe po iknin që këtu për të shkuar në vilat e Durrësit apo të Qaf Shtamës. Dhe doktorit ju kujtua edhe një herë ai vargu i pavdekshëm i Shilerit dhe ai rregulli i përgjithshëm i so-

vranëve dhe i diktatorëve: «Luksi pa fre dhe varfëria pranë!»

* * *

Mesnata kishte kaluar. Brenda në sallon vazhonte festa dhe doktorit i duhej të kthehej. Kaq herë vajzat e tij u dukën në hyrje të tarracës së madhe. Dhe përsëri Molena hyri në sallonin e madh. Tani ju mbloodhën aty përreth kolegët e rinj dhe disa dashamirës të vjetër. Ai e kuptoi se ata në këtë rast deshën fjalën e tij, deshën që ai diçka të tregonte nga të gjithë ata vjetët e tij të punës dhe të jetës. Pikërisht këtu një nga vajzat e tij e kujton me diçka të bukur. Nëpër sallonin e madh dëgjohet zëri i soprano Tefta Tashkos. Vajza e di se «tatës» i pëlqen. Përhapat zëri melodioz i sopranos së vdekur, ajo këndon serenatën e mbrëmjes së Shubertit. Është kënga më e dashur e Molenës. Doktorit i kujtohen tani rrethet e Vienës, rinia e tij kur kaloi andej dhe ndejti mbi bankot muze ku Shuberti i madh kompozoi muzikën e tij gjeniale, që ja la botës trashëgim nëpër shekuj.

Rrethet e Vienës! Atje ku muzika luhej jo me violina, as me pianoforte, por me disa klavecina të vjetra, tastierat e të cilave i kishte prekur vetë Shuberti i pavdekshëm.

Nëpër ato korie të mbjella nga dora e njeriut, atje ku në çdo hap e në çdo qosh kishte punuar dora, mendja dhe muskujt e aq brezave, përmbi gurë të vjetër të mbuluar nga veli i kohës dhe nga myshku i shekujve, atje kishte kaluar studenti shqiptar i mjekësisë ditë të paharruara në shoqëri të muzikan-

tëve, të kamerierëve, të vajzave leshverdha, që ishin të bukura, të njerëzishme e të dashura, po që për çudi i kishin hundëzat pak të kthjera përpyetë, si feçka.

Tani doktorit i duhet diçka t'u thotë miqve të tij aty në atë rrethin e ngushtë, që është krijuar në kohën kur në sallonin e madh, rinia vallëzon, kur në tryezat e anës zhurma e gotave sa vjen e po rritet.

— Në kohën kur princeshat tundeshin e shkundeshin nëpër Evropë dhe populli vuante për bukë, kishte plot njerëz që vuanin nga stomaku. Këta ishin të shumtë dhe dashur padashur, ata kontribuan në ngritjen e këtij spitali. Prej tyre një pjesë ishte nga parësia e vendit, e aristokracisë së qytetit, e cila ishte e rënduar në para dhe në kapitale të habitshme. Jo një herë vinin në prefekturë telegrame nga fabrikantët prej Lioni ose prej Milanoje: «Na është paraqitur X. Y. nga qyteti juaj dhe na firmoi një çek me një shumë tepër të madhe. Lutemi na njoftoni nëse keni tregëtarë të tillë me kapitale të tilla.

Por edhe se me para të mëdha, një pjesë e tyre ishin neqezë fajdexhinj dhe injorantë. Nën peliqet prej kunadheje, prapa unazave me gurë të çmuar e tej mëndafshit e stofërave angleze, fshihej përçmimi për kulturën, për artin dhe për shkencën përgjithësisht. Këta tipa hanin e pinin, pastaj derdeshin nëpër orgjira me ditë të tëra. Medoemos, në kondita të tilla, vuanin nga ulçerat, nga gazrat dhe nga shkarjet.

Aty nga viti 1938 më sollën në shtëpi një djalosh nja dymbëdhjetë vjeç. Ishte krejt pa ndjenja, i grisur, i dobët dhe i zi sterrë. Duke dashur të sjellë

në qytet kalin e vet të ngarkuar me dru për t'i shitur, e kishte goditur rrufeja në rrugë. Pas ndonjë ore e solla në vete. Lëkura nisi t'i merrte ngjyrën natyrale, pulsi ju gjallërua, pastaj hapi sytë, u rrotullua në shtrat sikur kërkonte diçka dhe bërtiti duke qarë:

— Po kalin ku e kam!?

Kurrë deri atëhere s'mbaja mend të isha prekur aq thellë dhe të isha mallëngjyer aq fort.

Molena nuk foli më dhe ra në mendime, kurse një nga dëgjuesit e pyeti:

— Po pastaj fëmija ç'u bë, doktor?

Ai nuk e tregoi fundin, por shumë nga ata, që e dëgjuan, e dinin se djaloshi i dikurshëm i goditur nga rrufeja, tashmë ishte një koleg i Molenës.

Doktori ndërroi bisedën dhe nisi të fliste për gjëra, për të cilat miqtë e tij po tregonin interes:

— Në profesionin tonë, një nga mënyrat më efikase për shërimin e pacientit, është ngjallja e besimit dhe e moralit. Aty nga viti 1940 më sollën një burrë nja dyzet vjeç nga Gorra. E quanin Xhezmi dhe kishte një infeksion të thellë tuberkulozi në mushkëri. Por asaj kohe «niente che fare»¹⁾ Për tuberkulozin jepnim pluhur fosfori e kalçium në venë. Tuberkulozi atëhere ishte si kanceri sot. Nganjëherë ushtronim edhe pneumotoraksin. Kështu që edhe Xhezmiut u përpoqa t'i vija mushkërinë në glodhje. Gjashtë herë me radhë i futa puntin nëpër kafazin e kraharorit, por më kot. S'merrte. I sëmuri do të kishte patur aderenca nga pleuriti. I pezma-

1) it. asgjë s'mund të bëhej.

tuar e lashë. Shkrova recetën për kalçium dhe fosfor dhe urdhërova të ushqehet mirë. Pastaj i ndejta Xhezos ndonjë orë te shtrati dhe bisedova me të për sendet më të ndryshme. Kaluan shumë ditë dhe pas ndonjë muaji e futa Xhezmiun përsëri në rontgen. U habita. S'po u besoja syve. Lezionet te mushkëria e tij kishin filluar të kalçifikoheshin. Ai dukej më mirë, kishte shije dhe humor. E pyeta:

«— Si dukesh, Xhezmi?

Ai m'u përgjegj duke shtrënguar cepin e mantelit tim:

— Doktor, jam shumë mirë. Ato gjashtë gjilpërat e mëdha, që më bëtë ditën e parë, më shëruan. Të faleminderit!

Kur e pyeta përse më shtrëngonte mantelin e nuk më jepte dorën, ai m'u përgjegj:

E kam dorën të ashpër, me shumë kallo, ti e ke dorën të brishtë, kam droje se ta dëmtoj, kurse ajo dorë do shërojë edhe të tjerë...»

— Ne mjekëve, profesioni ynë na rezervon raste, rrethana dhe ambiente jo të zakonshme. Disa herë kaloj korridoret e spitalit. Shoh në një qosh një grup njerëzish. Zakonisht gra dhe vajza. Janë familjarët e një pacienti, që ndodhet në gjendje të rëndë. Unë kaloj para tyre gati i përhumur dhe ata mendojnë se unë jam mospërfillës, krenar ose i pasjellshëm. Në të vërtetë unë i shoh ato gra dhe i kuptoj, por unë s'jam në gjendje të flas me to atëhere. Unë jam i përqëndruar pikërisht te njeriu i tyre. Ai vërtet është keq. Pas pak do ta operoj. Dhe duhet një kujdes i jashtëzakonshëm, duhet një përqëndrim i nervave të mia, i dijeve, i përvojës, i gjakftohtësisë dhe i duarve. Më dridhet zemra për

jetën e tij, sepse ai është njeri. Më duket sikur vdekja ka hipur mbi tavanin e sallës dhe më përgjonomia. Dua të më kuptoni. Një pakujdesi e vogël dhe fajin tonë e mbulon toka, kurse ndërgegja ka për të na brejtur për gjithë jetën. Na ndodh që një pacient i ka të gjitha të dhënat klinike se ai pas pak do të vdesë. Por ka ndodhur, jo vetëm një herë, kur organizmi i njeriut bën çudira. Mbahet, qëndron, reagon dhe fiton përmbi vdekjen. Rastet e tilla na japin ne disa mësimë dhe disa gëzime, që s'jam në gjendje t'i tregoj dot.

Aty nga viti 1940 kisha një mjek... në spital; nuk di se çfarë kombësie t'i vë... I ati kishte qenë bjellorus i ikur nga revolucioni, kurse e ëma serbiane. Çuhej Brankoviç. Ishte një djalë trupmadh, që të kujtonte ata aristokratët personazhe të Leon Tolstoit ose më saktë, Oblonskin e Dolit të Ana Karenina. Shtihej si fisnik dhe ngrinte në qiell Carin Aleksandër. Pispillosej dhe vërshëllente nëpër dhëmbë «Oçi çornie». Ishte diplomuar në Palermo dhe gjithnjë më çante kokën me disa gjepura filozofike, për të cilat iritohesha jo vetëm një herë. Ishte fashist i bindur dhe që shumë mospërfillës ndaj pacientëve.

Na sollën një ditë një të sëmurë rëndë. Ishte një djalosh i gjatë me një takije të bardhë në kokë. U ndodha bashkë me Brankoviçin dhe patienti mezi na shqiptoi emrin dhe na tregoi se ishte nga Rafshnalta e Dukagjinit. E vendosëm në sallën e madhe, por pas disa orësh doktor Brankoviçi shkoi dhe e izoloi nga të tjerët duke ja qarkuar shtratin me paravan. Prania e paravanit për të sëmurët është lajmëtare i vdekjes së paevitueshme. Ju s'mund ta

kuptoni se sa vuaj unë shpirtërisht kur jap urdhërin për ta ngritur një paravan. Por ç't'i bësh? Në rastet e duhura... Shkencës i duhet shumë punë për të mënjanuar ata paravanët mizorë, që gjithnjë i hedhin një hije misterioze shpirtit të mjekut.

Pra doktor Brankoviçi ishte i sigurtë për vdekjen e djaloshit kosovar, kurse unë nuk isha i një mendjeje me të. Megjithatë paravani mbeti i ngritur dhe unë e ndoqa me vëmendje gjendjen e rëndë të djaloshit. Buzët ju nxinë, sytë ju perënduan, frymëmarrja ju dobësua, nuk përmendej fare, veç zemra e tij rezistonte me një këmbëngulje të çuditshme. Ditën e pestë djaloshi hapi sytë, unë i kapa pulsën dhe ai më foli:

«— Jo, doktor, unë nuk vdes!

Me siguri ai diçka do të kishte dëgjuar nga bisdat tona, kur ne e pandehnim të mbaruar.

— Nuk vdes, doktor, nana më pret dhe ka nevojë për mue, unë nuk vdes, por të lutem doktor, më baj një nder!

— Folë!

— Ma kanë hjekë takijen e bardhë nga koka.

— Po, janë rregulla të spitalit, djalë...

— Prisheni rregullin për mue, doktor, ma ktheni takijen.

Urdhërova dhe ja sollën në çast. Dhe me takije në kokë ai dukej më i bukur. Ndërkohë kaloi atje Brankoviçi. Kur pa gjendjen, u egërsua dhe desh plasi nga marazi. Unë e ftova të ulej, por ai nuk deshte të qëndronte. Për të triumfuar ideja e tij, ai kishte dashur që kosovari të vdiste. Doli përjashta.

Në korridor unë i thashë:

— Parashikimi yt ishte i gabuar.

Brankoviçi u verdh.

— Unë kam kryer universitetin mjekësor për njerëz, jo për kafshë!

Atëhere s'u përmbajta dot. E kapa për mënge dhe e ndalova:

— Dëgjo këtu... me gjithë rrethanat që po kalojmë, unë të kam duruar shumë. Ne kemi lindur e jemi rritur majë shkëmbit e majë gurit, raca jonë është kalitur me vuajtjet dhe privacionet... Këto t'i kesh parasysh edhe në terrenin politik...»

Nga të rinjtë që dëgjojnë doktorin në natën e festimit të ditëlindjes së tij, njëri kërkon të tregojë për lidhjet e tij të para me lëvizjen e çlirimit gjatë luftës, që shkoi.

— Pranvera e vitit 1942 ishte diçka e papritur. Unë kisha dëgjuar për djemtë që kishin dalë malit kundër pushtuesve, thuheshin fjalë të çuditshme, thureshin legjenda e thashetheme për komitë me bruca të zeza, me nga katër kobure, me thika ndër dhëmbë e me bomba në brez... por unë s'kisha parë asnjë prej tyre e bile askush s'më kishte folur seriozisht mbi ta. Por...

Paradhoma e klinikës së doktor Molenës ishte mbushur plot e përplot me pacientë. E midis tyre, ngadalë dhe si pa u ndjerë, shkau dhe hyri një djalosh nja njëzet vjeç. Kishte një fytyrë të mprehtë dhe rrobat e zakonshme të një punëtori. I porsardhuri nisi të vështronte muret e paradhomës ku ishin varur radiografitë të kopjuara në pozitiv, kraharorë të shtrembër nga rakitizmi, ulçera të duodenit, pamje sifilitikësh, dy fëmijët siamezë. Midis qytetarëve që prisnin ishte edhe një sarakaçane e re, tepër e gjatë, e zbetë, e hequr, me ca gjurmë

të tretura në faqet, që dikur do t'i kishte patur shumë të kuqe. Kishte një kryq të vogël tutazhi në ballë. I kishin hedhur sipër një brucë të zezë me thekë të gjata. I panjohuri, si për të fshehur fytyrën filloi të vështrojë fotografitë e mureve. Doktorin ende s'kishte filluar vizitat e papritur çeli derën, doli përgjysëm në prak dhe foli:

«— Kush ka ardhur për pyetje:

— Unë, *shoku* doktor! — bërtiti djaloshi, dhe me të thënë këtë, fytyra i mori zjarr. E kuptoi se e kishte shkelur. Padashur e pa menduar kishte shqiptuar fjalën «shoku.» Kjo përdorej atëhere vetëm në mal, por në qytete, shqiptimi i saj të bënte të kujtoje partizanët.

Djaloshi hyri, doktori mbylli derën dhe u ul te shtrati i vizitës.

— Ç'keni për të pyetur, djalë? — dhe i hetoi fytyrën.

I porsaardhuri zbuloi gjurin e vet të enjtur.

— Po ju jeni për vizitë të plotë, — vërejti doktori — pse nuk pritët. . .

Në vend të përgjegjes i porsaardhuri hoqi xhakëtën. Ju duk revolveri në brez. Mjeku mori inat.

«Ky palaço rrugësh, shkel rregullat dhe kërkon të më trembë me revolverin!»

— Dilni jashtë dhe prisni radhën!

— Nuk mundem, o doktor, puna ime. . .

— Me ç'punë merreni?

— Po. . . ja, poshtë e lart!

Tani doktori u nervozua me gjithë mend.

«Ky do të jetë ndonjë agjent i kuesturës italiane, që vjen e. . .»

— Ç'është kjo poshtë e lart?

— Malit, o doktor!

— Malit?!

— Po... a nuk dëgjuat dje bombardimin e artilerisë italiane? Nga plasja e një predhe, më goditi gjurin një gur. Nëpër pështjellimin e gjithë atyre mijëra predhave i humba shokët dhe ja mbajta drejt e te ju...

Doktori shkoi te dera dhe i shkoi çelësin që nga brenda. Ky ishte takimi i tij i parë «me ata të malit», pastaj do të vinin takime të tjera edhe me «ata të qytetit». Pra doktori kishte shqiptuar germën A.

— Po që nga vini, djalosh?

— Nga mali.

— Po emrin si e keni?

— Ashtu si ti.

— Po mbiemrin?

— E kam lënë në mal.

— Po paski edhe morra...

— Si prej mali.

Molena nxitoi te dera e tij e pasme dhe thërriti:

— Lano!

Rendi këtej një djalë i shkurtër me një mantel të bardhë. Doktori diçka i foli dhe Lanua e vështroi partizanin me ca sy të gëzuar, që sapo vinin e zmadhoheshin.

— Lano, shko në farmacinë e Shomos dhe merr...

— Po recetë.

— Thuaji Shomos nga ana ime... merr dhe bar për ngordhjen e morrave, edhe një top me paqeta cigare...

Lanua u nis dhe doktori ju kthye përsëri partizanit:

— I thuaj komandantit tënd... si e ka emrin?

— S'ja mbaj mend, o doktor — dhe nënqeshi.

— Mirë që je i kujdesshëm, më pëlqen.

— Pra, i thuaj komandantit...

— Ose komisarit...

— Po, qoftë edhe komisarit... as emri i këtij s'të kujtohet?

Djaloshi mohoi me kokë.

— Thuaji pra se edhe morrat janë një armik jo i vogël. Tashti më fal. Ti dil e rri në këtë dhomë anekse, që këtej do të vijë Lanua, unë do vijoj vizitat se biem në sy...

Partizani u ul në një shtrat me rotëza kauçuku. Pastaj u pendua dhe shkoi në dritare. Dukej oborri prapa shtëpisë dhe në fund të tij ai kopshti i vogël zoologjik. Pavioni i ndarë me shufra hekuri. Ja ujku gjithë inat, që lëpin gjunjët e veta; ja më tej dhëlpëra «dhëlpërake», që kruan dhëmbët me putër; ja lepuri frikacak me pesë lepurushë pranë... Dhe partizanit ju kujtuan përrallat e gjyshes, ëndërrimet e fëminisë së tij, fshati, mali, shokët. Që nga klinika e doktorit dëgjohej ai dialogu i zakonshëm: Merr frymë, jep frymë, kollitu, qëndro, çlodhu, hape gojën. Pastaj u dëgjuan zhurmat e lejlekut që nga maja e çatisë. Po ja se u hap dera dhe hyri Lanua duke gulçuar nga nxitimi. Tani Lanua gjeti kohë të përqaftonte djaloshin. Edhe doktori doli këtej.

— Si e keni emrin? — e pyeti Lanua partizanin.

Djali s'u përgjegj dhe infermieri vështroi barnat e pastaj veshët e të ardhurit. Molena nisi t'i fliste:

— Kështu... përdorimin e barnave si ta shpje-

gova, merr edhe këtë pomadë për morrat, na një top cigare për ty.

— Po unë s'ty mos, doktor!

— Ua ndaj shokëve. Kisha shumë dëshirë të bisedoja me ty, por jashtë më presin gjithë ata njerëz. Veç disa fjalë kam për të të thënë:

— Urdhëro, o doktor...

— Thonë disa të huaj se populli ynë ka qenë i mallëkuar të mos ngopet me bukë. Prandaj edhe nuk shtohet, vdekjet në fëmijët i kemi të shumta. Nga revolucioni juaj...

Partizani e ndërpreu:

— Pse nuk thoni «yni» doktor?

— Po, qoftë edhe ashtu, pra nga revolucioni, unë pres atë që e shembën bejlerët më 1924, shkolla, spitale, demokraci dhe bukë që të ngopen njerëzit dhe të shtohet raca... Hajt, udha e mbarë dhe mirë u pafshim!»

* * *

Qytet në ditët e tij më të zeza. Rrugëve tankset e gjermanëve, telat me gjemba, burgjet, patrullat, era e barutit dhe e gjakut. Qyteti në luftë. Erdhën dhe shumë komandantë dhe vrasës, që pushkatuan sa mundën e vranë njerëz nëpër rrugë. Erdhën edhe merolamçet në qytet me nga tri shqiponja në ballë. Dhe kush ishte në krye të tyre? Një bej intelektual.

Dhe doktori e takoi beun ditën e krishtilindjeve në sallën e madhe të bashkisë. Ai ishte veshur me një pallto të rëndë, me kostum blu, këmishën e kishte borë të bardhë e veç gravatën e kishte të zezë, këpucët lustrafine dhe një revolver në brez.

Katedralja mbante akoma erë qiri e tempan, qyteti ishte plaçkitur. Peshkopi në mitropoli priste magët imagjinarë, që do të njoftonin lindjen e njëmijë e nëntëqind e dyzet e tretë të Krishtit, kur u lëshuan rrugëve magët mustaqellinj me nga tri shqiponja në ballë, me nga një pushkë në krah dhe me nga dy thasë në shpinë. Qyteti dhe qytetarët u plaçkitën ashtu si s'mbahej mend asnjëherë.

— Zoti Estref bej, — i tha doktori komandantit — mbrëmë natën magët tuaj ardhën në «Bethlehem» dhe i mbushën thasët plot me petulla të ngrohta.

Komandanti ballist u ndodh ngushtë dhe vendosi që këtë «sfidë» të doktorit ta mbante vath në vesh, po përsëri u përmbajt:

— Përgjegjësinë për këtë, zoti doktor, le ta mbajnë ata që i vunë kazmën rendit publik, sa për mua... më ngjau tamam si Saliut në Voskopojë... më shkau disa orë situata nga duart, gjëra që ndodhin, zoti doktor...

— Ndodhin, zoti Estref, kur u jepet erë hajduëve dhe nopranëve...

Pastaj më vonë situatat s'përmbaheshin dot më. Ato u shkisinin nëpër duar edhe komandaturave, edhe estrefëve, edhe merolamçeve, që erdhën pas tyre. Më në fund komandanti gjerman emëroi një komandant vendës të ri. Vetëm emri i tij i nervozoi njerëzit: Ethem bej Maliqi! «Toskëria është e pasur në nxjerrjen e zuzarëve të tillë...» shkruan diku Noli. Po, përmbi këtë, as Toskëria dhe as Shqipëria e tërë s'kishte njohur një gjaksor më mizor se Ethem bej Maliqi. Aty nga viti 1936 Ethem i kërkoi pronësi prej feudali mbi fshatin Goricë të Prespës. Po përse vallë? Një histori e çuditshme, më shumë e hidhur:

Një stërgjysh i Ethemit, duke kaluar nëpër Prespë për në Manastir, u godit nga damllaja dhe vdiq në vend. Shokët e rrugës e varrosën në një kodër dhe e lanë. Pas një viti erdhi i ati dhe i vëllai i të vdekurit për të shikuar varrin. Por, duke vësh-truar varrin, ata panë krahinën, panë malet, krojet, rrugët, liqenin, stanet, gjënë e gjallë dhe barinjte... Kështu që, babait të beut të vdekur, i pëlqeu vendi dhe... varri i beut u bë varri i Prespës... Ja kër-kuan Sulltanit me ferman dhe Sulltani u shkoi pas qejfit. Tani... pas kaq brezash... Nalt Madhëria e tij Zogu i parë, firmon edhe një herë pronësinë e fermanëve sulltanorë dhe fshatarët u nxuarrën me dhunë nga trojet dhe nga shtëpitë e veta.

Këtë e bëri Ethem bej Maliqi. Jetonte asaj kohe një mjek në qytet. Quhej doktor Zografi. E thërris-nin «doktor Opinga». Ai pajtohej me këtë emër duke nënqeshur dhe duke ngritur lart tregonjësia: Vox populi, vox dei! (1) Doktor Opinga agjitonte për një jetë të re, për kohë të reja, për socializëm. Ishte një burrë i shkurtër, por tepër energjik, mbante syze dhe një mjekër të hollë në një fytyrë të mbushur, ca si rrumbullake e gjithnjë të përzemërt. Për za-kon mbante në gojë ca kokrriza të vogla antiseptike me aromë. Një natë e thërritën «për një lindje të vështirë» në katundin Barç. U ngrit doktori dhe u nis. Jashtë qytetit, nën vreshtat, e priste Ethem bej Maliqi. Ky nxori revolverin dhe i foli: «Ti mban fjalime kundër bejlerëve, na... hakun që të pret dhe vajç në të satëme!» Dhe e qëllloi në kokë pesë herë.

Kjo ishte fytyra e beut komandant. Lëvizja na-cionalçlirimtare në qytet dha alarmin. Ethemi ishte

në orën e katërt të komandimit të tij dhe po jepte urdhërat e para. Kalonte rrugës me gjashtë trima pas, kur një granadë i shpërtheu fare pranë dhe ai u përmbys. Trimat s'panë nga ikën.

Beun e çuan të gjallë në spital dhe i gjithë qyteti mbante frymën në ato orët e tmerrshme të dhjetorit 1943. Ethemiz mizor me mustaqet e zeza dhe me ata sytë gjaksorë, ja shpunë doktor Molenës në sallën e operacionit. Doktorin hyri shpejt në sallë dhe i përzuri të gjithë ata që ishin futur atje. Rreth e përçark kishte ballistë mustaqellinj me unaza të rënda duarve, të egërsuar dhe të inatosur, ishin gati të të futnin thikën në bark. Teshat e të plagosurit mbanin erë barut, leckë e djegur dhe raki. Një sërë ballistësh ishin ulur në bisht aty në korridor me pushkët midis shalëve... Midis tyre edhe Estref beu me disa gjirinj, të gjithë me koburet në brez dhe me hakmarrjen në kokë. Pastaj erdhi edhe koloneli gjerman. Të gjithë donin të asistonin në operacion, të siguroheshin, të interesoheshin, të ndërmjetësonin, donin... as vetë s'dinin se çfarë donin!

Por Molena u foli:

— Është e pamundur të asistoni. Atij i ka ikur shumë gjak, tashti po i bëjnë pastrimin primar.

— A është në vete? — pyeti gjermani gjermanisht.

— Po.

Atëhere ata hynë pa pyetur doktorin. Beu i goditur sa i pa, nxori një grahmë të gjerë si prej egërsire. Ballin e kishte plot me sumbulla djerse. Damarët e tëmthave i rrihnin vullshëm. Pastaj foli, dhe për çudi fare rrjedhshëm, veç zëri i dridhej:

— Dëgjomëni, vëllezër, dëgjomë, her komandant! Do kalojë. Unë s'pranoj asnjë zëvendësim të postit tim, qyteti bëhet zap qoftë edhe me një këmbë...

— Jam dakord, — plotësoi koloneli gjerman — me një këmbë komandohet më mirë... Të huajt dolën jashtë.

Ethem Maliqi diçka kërkonte me gishta nëpër prevazin e krevatit të operacionit. Kërkonte dorën e doktor Molenës. E gjeti, e kapi. Doktorin u drodh. Ju kujtua doktor Opinga dhe nata e lindjes së vësh-tirë, kurse i plagosuri deshte t'i thoshte diçka. Molena nxitohej, urdhëroi:

— Vërjani maskën e narkozës... — Dhe duke ju drejtuar Ethemit: — Numëro...

— S'jam kalama doktor, në vend të numërimit kam disa fjalë për të të thënë.

— Folë.

— Shpëtomë, o doktor, dhe ja, vendosa... unë komandanti, gjysmën e qytetit do të të fal ty si çiflig, gjysmën do ta djeg gur mbi gur...

— Po, mirë, gur mbi gur.

— Doktor, unë kam zemër të fortë.

— E di.

— Duroj shumë.

— Edhe këtë e di.

— Jam tepër hakmarrës.

— Jam i sigurtë.

Molena u nervozua. Lanua i foli:

— Narkoza s'po bën punën e saj...

— E ka pirë rakinë me okë.

Jashtë binte borë me flokë të mëdha, të shpesh-ta dhe të shpejta. Dhe flokët ishin tepër të lagështa.

Era frynte dhe e pështjellonte borën. Qyteti ishte në ethe.

Molena e Lanua tashti flisnin veç me sy. Ethemit i bënë një anestezi lokale. Qelbej era e rëndë e mishit të njeriut. Bisturia e parë kaloi mbi mish. Por...

«Mjeku s'ka miq e armiq. Sapo hyn krimineli në spital, kthehet në një pacient. Mjeku ka veshur mantelin e bardhë dhe ka bërë betimin e Ipokratit. E me gjithë këto ky që kam nën bisturi është ai që është... Në unazat e tij të arta, në unazat e kuqe prej qelibari, dallohen inicialet e zeza E.B.M. Por... në universitet na mësuan se cilido qoftë, ai është pacient. Kështu u betuam para trupës së dinjitorëve dhe rektorëve. Por, pasi u betuam ne, ata nuk na thanë se do të dërgojnë edhe në ballkanet si vëllezërit e tyre për të shkelur betimin tonë dhe atë të Ipokratit. Ata s'na thanë se do të ngrejnë krematoriume për të djegur njerëz. Në universitetin «Ludovico Maximiliana» të Mynhenit nuk na folën fare për kohën e sotme. Djemtë i hodhën këtij një granadë. Shumë pak për një kriminel si ky, kurse Bruti diku thotë: «Jemi meshtarë e jo kasapë...»

Molena kreu ampulacionin e këmbës së djathtë. Qepi arteret dhe me maskën e bardhë mbi fytyrë vështroi sytë e Leonit dhe të Lanos. Pastaj hodhi sytë në pasqyrë, pa edhe sytë e veta. I pa dhe u mor vesh edhe me ata. Vendosi. S'duhej vepruar më tutje.

«Nuk duhet t'u kundërvihem atyre që i hodhën këtij një granadë. Qyteti ka për të më mallëkuar, edhe Prespa e tërë, edhe doktor Opinga, edhe të gjitha viktimat, që ky i ka dërguar në atë botë. Jo... kurse Bruti thotë...»

Papritur dera trokiti fort. Leoni e çeli. Hyri i shqetësuar Veizi, infermieri i pavionit të pranimeve. Ju drejtua Molenës:

— Shoku doktor, (ai e theksoi fjalën «shoku») kanë ardhur ata... domethënë shokët, kërkojnë nga ne, nga ti domethënë...

— U thuaj të largohen.

— Të largohen?

— Ashtu thashë.

* * *

Mbi varrin e Ethem bej Maliqit u mbajtën fjalime patriotike, mbi varrin e tij u betuan asët e nacionalizmës shqiptare për hakmarrje, për rend e drejtësi gjersa njëri i kaloi gjithë të tjerët. Ai, duke bërtitur e duke çarë erën me majën e gishtit, duke kërcyer përpjetë si epileptik, kishte bërtitur: «Përsëri u derdh gjaku i pafajshëm i Abelit. Përsëri Kainët në skenën kombëtare për terror e për çkombëtarizim. Dhe për djall dhe për çudi me anti-kombëtarët bashkëpunon edhe një Kain më i rrezikshëm, një farë xherahu, që duhet spastruar një orë e më parë!»

* * *

Pas ndonjë jave, në shtëpinë e doktor Molenës, qëndroi një veturë «Mileçento». Prej saj zbriti një burrë nja dyzet vjeç me pantallona fuska dhe me një pallto të rëndë «Gub». Kishte sy të bukur dhe duar të bardha. Me të hyrë në sallon, ai u vetë paraqit:

— Doktor Nexhip Vigani!

Molena e mirseardhi me dashamirësi, e ftoi të ulej, i ofroi cigare dhe i vuri përpara taketuken prej porcelani. Doktor Vigani shihte qilimin e rëndë, abazhuret, portretet, raftet e bibliotekave. Erdhi Meri e solli kafet.

— Keni shumë punë, zoti Molena?

— Shumë, koleg.

— Seleksionimi artificial...!

— Ne kurrë s'na ka munguar një seleksionim i tillë.

— E drejtë, doktor, gjakmarrja dhe injoranca, na tashti edhe politika!

— Për djall — vijoi Vigani — lufta është ndezur në Evropë, është ndezur në sallon si të thuash, kurse duhej të ndizej në kuzhinë... .

— Në kuzhinë?

— Po, Molena, të ndizej në ato legjione ku gërshetohet injoranca, prapambetja, dendësia e popullatës dhe racat e verdha me të zezat... Por fatalitet... Sidoqoftë lufta, me gjithë tmerret e veta, i jep një shtytje përpara shkencës. Në kirurgji kemi zbulime të mëdha... .

Pastaj ata, larg e larg folën për metoda të reja shkencore në mjekësi, zunë në gojë shpikjen e pasardhësve të Flemingut dhe qeshën të dy kur kujtuan ardhjen e flakoneve të penicilinës vetëm nëpërmjet valëve të radios. Pastaj fare papritur Vigani u mbush me frymë dhe perëndoi sytë nga tavani. Molena e kuptoi se erdhi çasti i qëllimit të vizitës. Vigani rrahu me dorë cepin e kulltukut dhe ngriti sytë:

— ... si të thuash, zoti Molena, por ju si mjek dhe si njeri e kuptoni se kudo e kurdoherë do ketë

vend për keqkuptime, për spekulime kontradiktore dhe për thashetheme.

— Nuk ju kuptoj.

— Do më kuptoni fare mirë, kur të bëhem më i qartë.

Dhe që këtu doktor Vigani me takt e me finesë i tha zoti Molenës se «në kryeqytet mendohet nga disa veta se gjoja, (këtu Vigani i hapi fort buzët dhe u dha një formë ovale, po ashtu hapi edhe gishtat e duarve, si për të treguar edhe habinë e tij) pra nga disa veta mendohet se gjoja dokot Molena, in extremis, e ka favorizuar vdekjen e një të quajturit Ethem Maliqi. . .

— Këto janë përçartje, zoti Vigani, unë s'u jap asnjë rëndësi.

— Ashtu, zoti Molena, por *ata* duan ta diskutojnë rastin. . .

— Ta diskutojnë?

— Po.

— S'e kuptoj se çfarë mund t'i diskutosh vdekjes së pashmangshme të një njeriu, që ma sollën në spital të dërmuar nga një granadë, të infektuar rëndë gjatë rrugës dhe që kishte humbur gjithë atë gjak. . .

— Ata duan ta nxjerrin të vdekurin nga varri dhe të kryejnë një autopsi.

— Bukur shumë, — u përgjegj qetë Molena — ata duan të hyjnë në një pyll ku unë i njoh shumë mirë shtigjet.

I zoti i shtëpisë u kot dhe kërkoi të falur. Doktor Vigani e kuptoi se duhej të nisej. Poshtë në korridor kishte zhurmë. Molena dha të kuptohej se ajo zhurmë ishte e pacientëve, që prisnin t'i vizitonte.

— Detyra mbi të gjitha, zoti Vigani.

— Moto e miqve të paftuar, që kemi në shtëpi — shtoi miku, por Molena nuk ja zgjati.

E përcolli Viganin gjer në rrugë, te porta me trinë të hekurt. Deri atje, ata të dy shkëmbyen edhe disa fjalë, bile e ngritën zërin në oborr, sepse në rrugë po kalonin motoçikla gjermane. I huaji lexoi disa nga titujt e doktor Molenës të shkruara në tabelën e bardhë te porta, shoferi çeli derën e «Mileçentos». Që nga sedilet komode të veturës doli këtej një afsh i ngrohtë. Doktor Vigani nxori pallton e rëndë, shallin dhe ja hodhi shoferit nëpër dorë. Pastaj u kthye edhe një herë nga Molena, i zgjati dorën, e përqafoi duke i lënë shëndetin dhe u përkul të hynte në automobil. . .

Në këtë çast doktor Molena sikur shtangu. Gjithnjë ai kishte pasur një virtut të pastër ndershmërie. Ai besonte shumë te njerëzit. Por këtu ju duk se pa diçka të pabesueshme. . . Kur u përkul doktor Vigani për të hyrë në maqinë, në fund të xhaketës së tij ju duk gryka e një revolveri. Molena u drodh dhe menjëherë e pati të qartë se Vigani ishte një provokator dhe një informator, që ja dërguan «sa për të marrë një mendje». Zëri i tij doli i ashpër, kur kapi Viganin pas supit dhe e tërhoqi këtej. Atij kurrë s'i kishte ndodhur të bënte një gjest të tillë:

— Ju lutem, kthehuni prapsht.

Si ishte i përkulur, Vigani e vështroi Molenën që ndën sqetullën e vet, pastaj u lëkund në parafango, u zmbrops dhe u kthye këtej:

— Cfarë kërkuat, zoti Molena!

— Kërkova që ju të ktheheni. . . kam diçka për të biseduar.

— Tashti u kujtuat...? Unë vij me gjithë qejf, zoti Molena! Do më ngjitni lart në sallonin tuaj?

— Jo, në sallën e operacionit.

— Çfarë pësuar kështu, doktor?

— Një goditje të fortë...

— Dhe kërkoni ndihmën time?

— Kërkoj të më thoni troç, ju jeni një provokator apo një spiun?

Tjetri u zbeh, por u përmbajt.

— Që nga i nxirrni këto, zoti Molena?

— Nga revolveri, që mbani në brez!

Vigani bëri sikur mënjanoi vithet e veta, bëri një gjest të tillë, sikur druhej se mos kishte ndonjë bisht prapa dhe këtë bisht deshte ta fshihte ose ta mënjanonte. Sulmi ishte aq i papritur dhe aq i fortë, sa Vigani, i cili s'deshte ta hiqte maskën plotësisht, mendoi të thënja latine «Kush mohon totalisht, pohon totalisht». Bëri që në buzët e tij të shkrihej një buzëqeshje e hidhur e hajdutit, kur e kapin te kasaforta e huaj.

— Jo pikërisht ashtu, zoti Molena. Unë kryej një gabim kur mbaj revolver, por unë jam një mjek me të vërtetë. Vetëm diçka ju fsheha, besimet e mia politike.

— Besimet apo bindjet?

— Merre si të duash.

— Besimet janë bindje kur mbahet revolveri në brez...

Vigani mendoi të bënte një kundërsulm të vogël:

— Nganjëherë, zoti Molena, edhe historia është më e rrezikshme se revolveri.

— Po. Ndodh kur të vjen ndër duar një dishepull i Neronit...

— Sidoqoftë ai ishte një nacionalist i ndershëm.

— Dhe ti je një shoku i tij...

— Të lutem, zoti Molena...

— Unë mendova se të nderoj, kur të bëj shok me atë njeri, që ti i del krah. Ç'të keqe ka këtu!

— Zoti Molena, — Vigani ndërroi tonin e të folurit, deshte të bëhej më i qetë dhe më i arësyeshëm — unë kam marrë anën e kombëtarëve...

— Ti më vjen këtu nën proteksionin e të huajve dhe më vetëquesh kombëtar?

— Lëre të jashtmen, doktor, lëre këtë cirkostancë të çuditshme. Ata, — Vigani ngriti gishtin si për të treguar malet — ata paguhen me stërlina dhe me rubla tingëlluese...

— Unë kam parë me qindra dhe s'u kam gjetur veçse plagë dhe morra.

— Unë ju respektoj, por... ju jeni njeri i tyre?

— Unë u shërbej njerëzve.

— Po gjithnjë duhet patur parasysh se vendi ku jetoni ka rregullat dhe ligjet e veta.

— Më kërcënoni me këto?

— Ju tregoj rregullat.

— Faleminderit.

Molena po përmbahej, megjithëse ishte tepër i egërsuar. Te dera ai ndjeu çape të vogla, të nxituara, të shqetësuara. Ishin fëmijët e tij, që po habiteshin me shpërthimet e «tatës».

— Tashti mund të niseni...

— Për kaç më ktheve, zoti Molena?

— Po.

— Doktor, meqenëse piva kafen te ju, jam borxhli, ruhuni!

— Nga kush të ruhem?

- Nga kombëtarët.
- Edhe unë jua kthej nderin, që më bëni, me një nder tjetër: Hodie mihi, cras tibi(1) Ruhuni.
- Nga kush?
- Nga ata që ti i quan antikombëtarë.
- Domethënë se ju, zoti Molena, më thatë...
- Unë kam një infeksion në grykë dhe s'kam folur e s'flas dot fare tash e tre ditë, s'u kam thënë asgjë.

* * *

Pas ndonjë jave filloi anketa zyrtare. I vdekuri Ethem bej Maliqi u nxor nga varri, u kryen disa ekzaminime dhe autopsira dhe ndofta prej ndonjë mallëkimi të lashtë, të trashëguar apo të merituar, trupi i Ethem beut katandisi në një mërshë sakate të copëtuar dhe si të ngrënë prej qensh. Dhe përmbi këtë mërshë njeriu, mjekë e komandantë ngrinin akuza, ngulmonin të argumentonin teza e të lëshonin sentenca, gjersa... Njëri prej tyre u kujtua ose u turbullua dhe tha disa fjalë të mençme:

«Zotërinj! Të nderuar zotërinj! Të dashur vëllezër! Jetojmë ditë të vështira për atdheun tonë patriotik e sidomos për ne bijtë e tij të mësuar dhe intelektualë. Zotërinj! Historia përsëritet dhe granada, që u hodh kundër vëllait dhe të ndjerit tonë, zotit Ethem bej Maliqit, fare mirë mund të hidhet edhe kundër nesh, sepse antikombëtarët, zotërinj, s'e kanë për gjë të derdhin gjakun e pafajshëm të

1) Unë sot, ti nesër. Latinisht.

Abelit. Ata, o vëllezër, antikombëtarët dua të them, janë vrasësit e Ethemit, përsa u përket akuzave të ngritura kundër doktor Stefan Molenës, jam i mendimit se ne s'mund të zgjidhim dot asgjë. Ai është më kompetenti nga ne të gjithë mjekët dhe në pastë këtu diçka të zezë, kjo s'mund të zbulohet, sepse këto raste nuk i zbulon dot shkenca, por i mbulon toka dhe rasti mund të mbetet vetëm në ndërgjegjen e tij. Kështu pra... Shqipëri e shqiptarëve, vdekje-tradhëtarëve!»

* * *

Vetëm pas disa ditësh, përpara shtëpisë së doktor Molenës u duk një major gjerman, nën gradat e të cilit dalloheshin shenjat e qarta të mjekut. Ai ishte një burrë shtatmadh, por me fytyrë të mprehtë. Molena e vështroi nga xhami i kabinetit të vet: një gjerman si gjithë të tjerët, i veshur trashë si për dimër dhe me jakën e palltos të ngritur. Gjermani, pasi vështroi me një farë nënqeshje oborret, shkallët, tabelën e bardhë, degët e palmave, që dukeshin tej xhameve, shtypi butonin e ziles. Ai diçka mendoi dhe për një çast buza i shkau më të qeshur. I huaji fërkoj mjekrën e vet dhe nisi të vështronte borën e trashë, që po shtrohej në rrugë. Nën strehën e ndritshme të kapeles, balli i tij tani zuri të rru-dhej. Të panjohurin e shoqëroi dadoja për në kabinetin e babait. Ai ecte serbes, i përqëndruar fort në mendimet e veta dhe me sy mendohej të përpinte gjithshka që i dilte përpara. Molena e priti njerë-zisht, i zgjati dorën të huajit, ky ja mori në të tijën dhe vonoi t'ja lëshonte. Po i kërkonte sytë. Molena

e vështroi drejt dhe një si kujtim i largët, i humbur, i perënduar sikur ja përpëliti kujtesën: «Ky njeri... ky njeri... ku e kam parë këtë, ku e kam njohur?»

— Nuk më njihni, koleg? — pyeti gjermani.

— Jo, domethënë...

Molena e vështroi me ngulm dhe më në fund u njohën.

Ata kishin qenë bashkënxënës, pra edhe moshtarë, kishin qenë konviktore vite më parë në Mynhen në universitetin «Ludovico Maximiliana».

Biseda e tyre shkoi gjatë dhe Molena i mësuar me atë ftohtësinë nordike të gjermanit fodull, nuk u nxitua t'i paraqitte gruan e as fëmijët, por e ftoi të shihnin kopshtin e tij zoologjik.

— Interessant, — i thoshte Fridmani, — në një studim që lexoja kohëve të fundit, rezultonte se nga të gjitha kombet dhe racat vetëm tri kombe ishin të papërzier me të tjerë... dhe këta ishin... raca gjermane, raca juaj, koleg, racë sherete, desha të theksoja dhe raca e grekëve, edhe këta sherxhinj e të pashtuar...

— Përsa u përket konsideratave, Fridman, unë kam mendimet e mia, por përsa i përket racës gjermane, unë di se ju jeni të familjes së madhe dhe shumë të ngatërruar e të përbërë të anglo-saksonëve, gjuha juaj për ata që nuk e dinë, tingëllon gjithënjë si një anglishte e folur pak ashpër...

Gjermani u nxe, por u përmbajt.

Ata po shihnin të dy lopët e racës Xhersei, pastaj kaluan në kafazet e kafshëve të egra, tek ujku, vjerdhulla...

— Eh, Molena, Molena, — foli gjermani duke tundur kryet — dëshira juaj për t'u dhënë shembull

të tjerëve, iderat utopiste, që na shkaktonin aq diskutime të zjarrta në universitet. Ato ishin dhe mbe-
ten utopira, vetëm nacional-socializmi u ka dhënë
rrugë zgjidhjeje të gjitha problemeve ekonomike,
shoqërore. . .

Hynë në kopshtin botanik, në atë pjesën e mbu-
luar me xhame ku rriteshin kaktuset dhe palmat.
Fridmani gjithnjë nënqeshte me ironi. Jashtë binte
borë me flokë të trashë, degët e pishave po rëndohe-
shin, po hepoheshin e me gjithë të ftohtët nga hal-
thet e gjelbëra rridhnin pikëza bore të shkrirë, që
ngjiste si një sherbet i trashë.

Gjermani e vuri re këtë:

— Te ne, nuk ngjet kurrë kështu, ju jeni një
vend mesdhetar. . .

— Që kemi dhe veçoritë tona. . .

— Sigurisht. Kjo më shkon ndër mend kur
shoh këtë racën tuaj kokëkërcyer, ku seleksionimi
artificial ka marrë një hov të tillë sa s'dihet se ku
do dalë. Zaten ju e keni patur gjithnjë plagë çësh-
tjen e vëllavrasjes.

— Keni një fije të drejtë koleg, — ja ktheu
Molena — sidomos tashti, seleksionimin tonë arti-
ficial po e nxit edhe prania juaj me të gjitha pasojat
e saj.

Për çudi, biseda e tyre nuk po bëhej më e ngroh-
të dhe askujt s'mund t'ja merrte mendja se dy
shokë të vjetër ishin takuar tashti pas njëzet vjetëve.
I huaji ishte përfshirë nga ajo mania gjermanoma-
dhe e hitlerianëve dhe ajo që e habiste më fort
Molenën ishin kujtimet e tij mbi Fridmanin. Ky bir
prusiani nga Koneigsburgu dikur i fliste Molenës
për utopistët evropianë të shekullit XIX. Tashti

Fridmani fliste si një nazist i bindur e kokëplotë se «raca gjermane është e lindur për të udhëhequr dhe do të udhëheqë, ajo është e lindur për të sunduar racat e tjera dhe do t'i sundojë me hir ose me pahir dhe për këtë është dërguar Fyhreri nga zoti...»

Në mes të tryezës ishte skulptura artistike e shqiponjës. Atë e kishte trashëguar Molena nga i ati dhe as e dinte saktë se kush ja kishte dhuruar babait. E skalitur në mermer të bardhë, një shqiponjë me krahët drejt lart, krahë të fortë dhe nervozë, krahë të derdhur dhe të ashpër, një zverk lavrak prej shqiponje; qafa ulur poshtë, por me një mundim jo të zakonshëm ajo qafë është përkulur, është kthyer me zor dhe sqepi bën të ngrihet, kurse vështrimi i shpendit, me sy të vëngëruar ngulmon të vështrojë lart dhe të fluturojë larg!

— Megjithëse ju, Molena, mendoni keq për mua, prapëseprapë guxoni dhe më flisni gjëra, për të cilat çdo njeri nën pushtetin tonë dërgohet në Gestapo... Përse e bëni këtë?

— Sepse nganjëherë, koleg, ethet janë epidemi...

— Kurse unë mendoj se ju përfitoni nga shoqëria jonë e vjetër.

— Nëse dëshironi, mund të flasim për çështje thjesht profesionale.

— Jo, jo, vazhdoni.

— Ju pëlqen e folura ime, Fridman?

— Unë jam tolerant.

— Ju që zutë në gojë Gestapon!

— Gestapua ka lënë të flasë lirshëm Dimitrovin tuaj.

— Tonin? Unë s'jam komunist.

— E kuptoj, por di se influencoheni prej tyre;

pastaj, Molena, këtu s'mund të ketë komunistë, ju s'keni një klasë punëtore, ju s'keni një inteligjencë militante, rebelët tuaj rendin pas jehonës. Rast për t'u përbuzur, djemtë tuaj qëllojnë me armë bijtë e Bethovenit, që freskon shpirtin e botës. . .

— Ju prapë me shpirtin e botës po merreni. . .

— Megjithëse ju dikur talleshit me këtë «bujk nga Pomerania» prapëseprapë unë e ndjej fishkëllimin e thumbit e aq më shumë qëllësën. . .

— Unë jam mjek dhe nuk qëlloj kurrë!

Molena nxori nga xhepi stetoskopin dhe e lëshoi mbi komo.

— E paski të vjetër, koleg, — i tha gjermani — industria jonë ka prodhuar disa kopje shumë moderne, unë. . .

— E çmoj industrinë tuaj.

— Faleminderit. Po. . . ku e kishim fjalën? Eh, po, thatë se ju si mjek nuk qëlloni kurrë.

— Po.

— Kurse mua më thanë se ju keni qëlluar.

— Me armë?

— Me bisturi, drejt e në shenjë.

— Domethënë se ju para se të vinit tek unë, jeni përgatitur. . .

— Mandat arrestimi s'kam sjellë.

— Di se veproni edhe pa mandate.

— Për njerëz të zakonshëm. Pastaj, Molena, ju duhet të dini diçka. . . në çdo rast dhe në çdo rrethanë njeriu duhet të lërë çelur, në mos një dritare, të paktën një supap të vogël. . .

— Dhe unë jam supapi?!

— Mundet të bëheni?

— Po a i lejon nacional-socializmi këto?

— S'e paski harruar gjermanishten, bile theksi i tanishëm është më i saktë se ai që kishit në Mynhen, sidoqoftë leksikun e keni pasuruar...

— Ashtu?

— Kam përshtypjen. Keni mësuar shumë gjëra, kurse utopirat e Sen Simonit ju kanë ngelur...

— Ju i braktisët sigurisht...

— Ti, Molena, ke dashur të japësh shembuj, mëkatë, gjithë ai vrulli yt, gjithë ai dinamizëm, ju mbaruat shkëlqyeshëm universitetin. Ju kisha përfytyruar si një ministër, si një njeri të madh, kurse vij dhe ju gjej një mjek krahine. Fatalitet...

— Mos u ankoni nga këto rrethana, koleg, ku do ta gjenit supapin tuaj...?

— Më fal, Molena, po ju po bëheni tepër ironik. Pastaj ju harroni vëllain e Sen Simonit, harroni Furie-në, ai shkruan edhe për ne... «Mjeku do të ketë sa më shumë sëmundje, prokurori procese në çdo familje, arkitekti zjarr në qytet... Po nuk më thatë, si e pritët ju ardhjen tonë këtu?

Molena e kuptoi se e kishte lënduar gjermanin, por s'mund të tërhiqej.

— Ashtu si do ta prisnit ju ardhjen tonë në Gjermani.

— Ne të kemi pritur mirë, të kemi mësuar...

— Unë erdhi si nxënës atje, s'kisha me vete as Gestapo e as divizione të motorizuara, por biseda jonë s'duhet të marrë rrugë pa krye. Këtë e them pa shaka dhe ju flas sinqerisht, po e konsideroj atë problemin tuaj jetik...

Gjermani e hetoi Molenën me ca sy depërtonjës dhe me një ballë të menduar.

— Në çdo rast, Fridman, ju mund të njiheni

nga afër me bibliotekën tonë të spitalit, në gjermanisht ne kemi. . .

— Lexoni shumë, Molena?

— Po, koleg.

— Literaturë shkencore?

— Edhe politike, shoqërore, historike.

— Bismarkun?

— S'e kam qejf, ai na ka mohuar, por. . . (Molenaës i shkau buza në gaz).

— Ç'patët ashtu, koleg?

— M'u kujtua diçka, që lexova pardje mbi kancelarin e hekurit. . .

— Ma tregoni.

— S'do t'ju pëlqejë.

— Ju thashë, jam tolerant. Po kush e ka shkruar? Ndonjë judish (1) sigurisht.

— Jo.

— Butsch-i?²⁾

— Do të ta them në fund. Po m'u ngul në mendje, sepse ka të bëjë me një mjek. Pra ka qenë ajo kohë kur Bismarku nga një anë u thoshte italinëve: «Pushtoni Tunizinë» dhe nga ana tjetër u pëshpëriste francezëve; «Ç'prisni, përse nuk hyni në Tunizi?»

— Kjo parathënje s'më pëlqen.

— Edhe unë jam tolerant. Pra në një nga këto ditë Bismarku thirri mjekun. Nuk di nëse ky kishte mbaruar në Mynhen, por ishte një mjek trim dhe tepër kurajoz. Filloi mjeku t'i bënte vizitën me shu-

1) Judish — çifut.

2) Butsch-i — sekretar i Bismarkut.

më kujdes dhe sipas të gjitha rregullave të njohura. Por Bismarku u nervozua dhe i bërtiti: «— Dil jash-të, se më tërbove, dërgomë një mjek, që nuk bën pyetje, se ti më mërзите.

Mjeku gjakftohtë u drejtua nga Butsch-i dhe i tha: — Dërgoni e thërrisni një veteriner!»

— Domethënë ti, Molena, po tallesh me Bismarkun?

— Kurse ti e quajte sherete racën time dhe unë s'u përgjegja, pastaj këto i ka shkruar një pa-raardhës i Boshtit...

— Po çfarë literaturë thatë se keni?

— Më pëlqen shumë që jeni i etur për lexim ndër këto rebeshe lufte. Por unë do t'ju jap një varg historianësh dhe albanologësh, doktor Hahni, Karl Rothi, Jokli, Hameri...

— Qenkan shumë!

— Ka edhe të tjerë si Babingeri, Lambertzi, Pash-i, Falmeraier... (austriakë dhe gjermanë bash-kë), të cilët i janë kundërvënë Bismarkut, por ju s'i njihni fare?

— Nuk i njoh — pohoi Fridmani.

— Një gjermani intelektual nuk i falet kur s'njeh shkencëtarët e vet, aq më shumë kur këta s'janë as judish e as komunistë.

— Ju i njihni, se flasin në favor të racës suaj.

— Bukuri. Po ju a i njihni ata që në Shqipëri flasin në favor të racës suaj?

— I njoh, — foli vendosmërisht Fridmani — janë vëllezërit Mitrovica, Llagami, Starova, Ethem bej Maliqi...

— Ju çalon shqiptimi.

— Por jo njohja.

Sytë e gjermanit xixëlluan me djallëzi dhe ai u hodh në sulm:

— Po përse, Molena, më ndërpret pikërisht tek emri i... Nuk besoj se jeni si zonja Makbeth në fund ose si gjeneral Makbethi në krye...

— Jo, Fridman, unë jam mjek.

— Me bisturi!? Ne bashkë kemi kryer betimin e Ipokratit.

— Unë e mbaj atë betim — Molena theksoi fjalën «betim» — kurse ju dhe kolegët e tjerë... kam dëgjuar për krematoriume...

— Gabohesh, Molena, ajo radioja që i bie sinjalit me daulle kur nis dhe kur mbaron, ajo i bie daulles me të vërtetë kot. Po nuk më thatë a mbaruat me listën e autorëve gjermanë...

— Më pëlqen që interesoheni shumë për shkençtarët tuaj dhe sidomos për veprat e tyre të shkruara, që ne kemi në bibliotekë. Dua të të tregoj për Rainoldin. Rasti i tij është shumë piktoresk...

— Unë jam i ngeshëm...

— E kuptoj, prandaj më kujtuat dhe bibliotekën. Pra Rainoldi. Ky shkoi si mjek në flotën greke pas revolucionit të 1821-së. Ishte përgatitur me një greqishte të saktë, po, kur hyri në flotën e Athonit, greqishtja nuk i vlejti fare. U detyrua të mësonte shqipen, sepse marinarët vetëm kështu kuptonin.

— Interesant me ju ballkanasit, s'marr vesh ku nisni e ku mbaroni.

— Pra Rainoldi mblodhi folklorin e arbëreshëve të Greqisë aty në flotën greke dhe nga ky rast fitoi vendi im dhe kultura botërore...

— Si shumë e ngritët, Molena!

— Po ti vetë, Fridman, ti vetë më the se racat e papërlyera... pastaj këto s'i them unë, por autorët gjermanë, të cilët do të keni rast t'i njihni që të gjithë dhe duke qenë shumë i ngeshëm...

— Edhe në Mynhen ju kam lakmuar finesën mendore, por jo atë vrullin e egër të ballkanasit...

Molena u përmbloodh në kolltukun e vet. Fjalët e Fridmanit bënë që t'i kujtoheshin disa rivalitete të tyre të vjetra në Mynhen. Nënqeshi.

— E keni fjalën për Gretën koleg?

— Ajo u vra prej atyre që i bien daulles.

— Ashtu?

— Po.

Molena heshti. Sytë i qëndruan të fiksuar në mur. Ndofta përfytyroi Gretën. Ajo kishte qenë aq e mirë e aq e dashur. Fridmani e nxiti:

— Hej, miku im, zbrit në tokë, unë e kam një fotografi të saj...

— Mund ta shoh?

— Druhem ta nxjerr një fotografi mëkatore në shtëpinë e një shqiptari oriental...

Për të parën herë Fridmani qeshi dhe vështroi anembanë si për të kërkuar njerëz, që duhet të qeshnin me shakanë e tij të zgjuar. Megjithatë ai pa një pikturë në ngjyra vaji. Një vjeshtë shqiptare. I pëlqeu. Por as portretet e mureve, as shqipja në mermer, as doktor Molena... askush nuk qeshte. Fridmani u shtrëngua të mbyllte brenda dhëmbëve nënqeshjen e tij ironike. Pastaj ai psherëtiu dhe, duke u grindur përbrenda me mendimet e veta, deshte të përhapte mjegull mbi të gjitha ato sa shqipoi.

— Sidoqoftë, Molena, ne e kemi nënshtuar krejt Evropën. Ne po luftojmë në tokat e armiqve.

— Frontet gjithnjë kanë qenë të lëvizshëm, Fridman.

— Kurse Fyhreri ynë s'ka për t'u mundur.

— Edhe ai mbreti i Skotlandës, që zutë në gojë pak më parë, edhe ai kështu profetizonte, por...

— Por...

— Janë disa toponomine saksone, koleg, toponomine pyjesh e malesh!

Fridmani u koll dhe lëvriu supet brenda uniformës së tij të ngushtë. U përkul mbi tryezë dhe në shtrojën e shqiponjës së mermertë, shkundi hirin e cigares. Molena, menjëherë i afroi taketuken prej argjendi.

Fridmani kërkoi të falur:

— Më falni, Molena, s'e kisha mendjen.

— E kuptoj.

— Sidoqoftë s'kisha ndër mend të fyeja simbolin tuaj... pastaj shqiponjën e kemi edhe ne. Dhe shqiponja jonë e mban kryet lart, kjo shqipja juaj këtu, si e shihni, e ka kryet poshtë...

— Por vështrimin e ka lart!

Fridmanit ju duk se e kapi ngushtë bashkëfollësin e tij:

— Kam përshtypjen Molena, se iderat tuaja kanë ndryshuar, më duket sikur mendimet tuaja janë militarizuar duke kaluar nga e majta... miqësi me rebelët, luftë në sallën e operacionit, shqiponjë simbolike me kthetra e me vështrim luftarak... Evropa u zbuti koleg por ju sapo u kthyet në këtë strofkë rebelësh, ratë përsëri nënë influencën e malsorve

tuaj; nuk u ngritët dot përmbi instinktet e racës suaj pirate...

Molena u nxeh:

— E drejta e natyrshme e vetëmbrojtjes Fridman... Por unë nuk njoh as rebela, as luftra në sallën e operacionit. Dhe përsa i përket racës sime... ju e tepëruat... dua tu kujtoj se janë të tjerë ata që sot po piraterojnë në një det gjaku...

Gjermani e kuptoi se ndodhej në cakun e fundit ku i zoti i shtëpisë nuk përmbahej dot më. Ndërroi bisedë.

— Ne, Molena, po humbasim në biseda dhe harrojmë se dielli në këto vise subtropikale i ushqen për bukuri vreshtat tuaja, që më kujtojnë ato shisheet me verë, që dërgonte ati juaj deri në Mynhen...

— Po unë, koleg, kam verë nga vreshti im!

Gjermani qeshi, për herë të parë u kolovit mbi kolltuk:

— Verë nga vreshti i Sen Simonit! Ivip urah!

* * *

Doktor Fridmani u bë vizitor i rregulltë i doktor Molenës në ato kohët e mjegulluara të okupacionit. Në spitalin e qytetit, gjermanët përdornin për nevojat e tyre disa salla. Fridmani u rregullua në një dhomë të spitalit, mblodhi atje gjithësa i duheshin për nevojat e përditëshme dhe e ndjeu veten si në shtëpi të vet. Por Molena e dinte dhe ishte i bindur se kishte të bënte me një hitlerian fanatik që «në çastet e katastrofës» deshte të strehohej në bodrume. Prej tij mundi të tërhiqte instrumenta për spitalin.

dhe barna që aq shumë i duheshin. Dhe një ditë i erdhi për dore që ta vinte në lojë.

Atyre ditëve u shtrua në spital një pasanik pijanik nga Prespa me emrin e rrallë, Gjerman. Molena thërriti Fridmanin dhe të dy shkuan te shtrati i Gjermanit. Kolegu tregoi interesim të tepëruar dhe u habit me emrin, që mbante fshatari. Hapën kartelën, zbuluan pacientin, filluan vizitën. I pari foli mjeku vendës:

— Gjermani, kolegu im, paska një koleksion sëmundjesh: pleurit nga e ftohta, shpretka e zmadhuar sikur ka jetuar në Cirenaikë, mëlçia e zezë e enjtui, prostati i zhvilluar, veshkat me gurë, stomaku plot me gazra, ka qenë i pirë dhe ka rënë nga kali, shpina i paraqit një butësi si të barkut. . .

Ata e bënë rregull që çdo mëngjez të shkonin te pacienti i përmendur dhe Molena nuk la asnjë rast pa vënë në dukje atë organizëm të dërmuar nga alkooli. Fridmani fryhej nga marazi dhe dëgjonte me inat, kurse Molena fliste fare serioz. Dhe e dinte se, sikur për një çast t'i shkiste buza në gaz. . . Fridmani ishte gati ta denonconte në Gestapo. Por sidogoftë, Fridmani ishte këmbëngulës dhe mjek i mirë. S'la mënyrë e bar pa përdorur. Të gjitha preparatet më të fundit të «Farben Kimiken Industrie» u vunë në dispozicion të Gjermanit nga Prespa.

Një mëngjez ishte Fridmani, që e thërriti Molënën. E çoi te dritarja e sallës së operacionit.

— Shih, Molena, shih përjashta!

— Çfarë të shoh?

Gjermani nga Prespa po dilte nga spitali. Ecte mbi këmbët e veta, dukej mirë, hapat i hidhte në rregull Fridmani s'fliste fare, thithte cigaren, për-

gjonte Molenën me bishtin e syrit dhe përhapte në erë rrathë prej tymi. Fare i shkujdesur i foli Molenës:

— Ai përsëri në pijetore po shkon, Fridman, ai është si shkruan një autor gjerman — një «vareze biftekësh». Ne s'i bëmë më shumë se një meremet, një godine të shkatërruar i vumë një tra të kalbur...

— Ashtu?

— Po.

— S'keni gjë tjetër për të thënë?

— Jo, koleg, domethënë po... në sallën e operacionit nuk pihet duhan...

— E vërtetë dhe e drejtë, thuaji ati futbollistit ténd që të kujdeset për ajrimin.

* * *

Aeroplanat aleatë filluan të bombardonin kolonat gjermane. Fridmani nuk u shqetësua shumë për këtë. «Ata janë ushtarakë e sidoqoftë nuk qëllojnë qytetet e hapura». Por një ditë, aviatorët anglezë i lëshuan bombat mbi qytet dhe u zhdukën. Dhe që asaj dite Fridmani e vendosi «kuartierin» e tij në bodrum. Mblodhi atje gjithë teshat personale dhe i kërkoi Molenës që t'i zbriste poshtë një pjesë të bibliotekës, furnellën me korant dhe një çajnik të madh. Molena përfitoi nga rasti dhe në dhomën që deri atëhere banonte Fridmani, futi katër partizanë të plagosur.

Por, një ditë, kur Molena zbriti në bodrum të shihte bujtësin e tij, përballoi një skenë të papritur. Gjermani, kokën të mbështjellë me të dy duart e

kishte përplasur mbi tryezë ku kishte shtruar hartën e madhe të fronteve. Qelbej në raki, gogësinte dhe rënkonte. Një radio e vogël ushtarake shushurinte e kërciste. Papritur, Molena vuri re tri copë vula mbi hartë... E kapi njërën, pastaj të dytën... e treta ishte vula e spitalit të tij, ajo që u zhduk disa muaj më parë. Mbeti gojëhapur. Në anë të tryezës së madhe ishte një arkë e gjelbër me një kryq të kuq sipër dhe brenda... Brenda e mbushur plot me vula! Ato ishin renditur atje me radhë si ushtarët në një skalion. Doktor Stefani s'po u besonte syve! Atje afër ishte tamponi «Pelikan». Doktor Molena filloi të vërente ç'ishin gjithë ato... Një koleksion i tërë, një koleksion i plotë vulash mbledhur, vjedhur, rrëmbyer... Nisi t'i provonte dhe të vuloste. Mbi hartën e madhe të Gjermanisë, atje ku dukej Raihu III si një shqipe mbi Evropë, ai vulosi kartën. Dhe vulat rrumbullake u renditën mbi Këln, mbi Hamburg, mbi Berlin, mbi Pomerani, mbi ngushticat e Skagerakut dhe mbi Potsdam. Molena vuri syzat dhe lexoi vulosjet: «Centro delle camicie nere, Ricione. Drejtoria e muzeumit, Athinë. Klubi i adhuronjësve të Bethovenit Rotterdam. Instituti Paster, Paris. Qendra antiveneriane Napoli. Klubi i violinistëve ciganë, Budapest. Komiteti izraelit, Lodz. Teqeja e Bektashinjve, Përmet. Zyra e policisë, Prizren...» Doktor Molenës sikur ja dogji duart kjo vula e fundit dhe u drodh. «Gjithë këto vula, kolegu i paska vjedhur ashtu si vodhi vulën tonë. Koleksionist me imagjinatë të fortë, hajdut dhe virtuoaz. S'paska pyetur as për miq e as për armiq. Po ky?..» Një farë myhyri i vjetër. Molena e ngjeshi mbi kartë: germa të turqishtes së vjetër... S'e përmbajti dot zërin:

— Po ky myhyr turk? Ky qenka i sarajeve...

— Kam qenë edhe në Turqi!...

— Oj, Fridman, s'qenke i përhumbur? Mendoja se flije, po ç'dreqin ke dashur në Turqinë asnjëse?

— Shkova para gjashtë muajve, Fon Papeni vuante nga majasëlli dhe fare papritur ai shpërtheu duke ngritur kryet me nxitim.

— Molena! Ti je një maskara!

— Dale, koleg, ç'pate kështu?

— Ti je një gomar!

— Fridman!

— Çfarë, Fridman! Vjen e fut hundët në arkat e mia e s'të turbullon aspak fakti se po përmbysët bota.

— Fridman, unë s'të kuptoj çfarë ke kështu?

— Ti je idiot, asgjë s'mund të kuptosh, ti. . po humbet Gjermania e kupton ti këtë?

— E kuptoj.

— Asgjë s'kupton ti, injorant, mohonjës, ti krahasimin e një humbjeje e bën me shtetin tënd leccaman e vocrrak, të bjerë Gjermania do të thotë të përmbysët bota!

— Po dale, Fridman, ti ke pirë shumë!

— Jooo, domethënë po bie Gjermania, bota...

— Po bota nuk do përmbysët kur të bjerë Gjermania, Fridman!

— Ti je shtazë, Stefan! Shtazë!

Molena i kapi pulsën dhe e vështroi në fytyrë. Bebezat e syve i zmadhoheshin dhe i zvogëloheshin me një shpejtësi të paparë. Fridmanin e kishte kapur një krizë histerie. U dëgjuan sinjalet mbi daulle të radio Londrës, spikeri fliste gjermanisht. Fridmani qëlloi radion me grusht.

— Ai qen, që po leh, ha në grazhdin e Albionës plakë, ai është një nepërkë, një atdhemohonjës, që tall e ironizon e lëshon sarkazma e cinizma për atdheun e tij, ai është i poshtër! I poshtër! I poshtër!!!

Fridmani kërceu edhe një herë mbi kolltukun e tij dhe filloi të rrihte shtrojën e çimentos me aq egërsi sa i dërmoi këmbët dhe u gajas. Sot, ai ishte në një gjendje të dëshpëruar, kurse pak ditë më parë...

Disa ditë më parë ai kishte mbushur tri bute me rrush, i kishte shtrydhur sipas të gjitha rregullave, kishte grumbulluar dhe disa dengje me fletë pjergulle dhe medoemos kishte ëndërruar: Sapo të kthehemi në Gjermani, gazeta e madhe «Berliner Caitung» me germa të mëdha e të zeza, korsive apo gotike, në rubrikën e sensacioneve do të shkruante: «Gjenerali mjek fon Fridman nga Pomerania u kthye fitimtar në atdhe me një koleksion të çuditshëm që do t'i mrekullojë dhe do t'i lërë gojëhapët edhe koleksionistët më të ndezur jo vetëm të Gjermanisë, por edhe të të gjithë botës! Zotëria e tij solli në atdhe një koleksion komplet vulash e myhyresh e... bashkë me to edhe tri bute me verë, rrushi i të cilave është shtrydhur në një qosh subtropikal dhe... për të provuar origjinalitetin e verës, fon Fridman ka sjellë edhe fletët e vreshtave...»

Po kur të nesërmen Molena hyri edhe një herë në bodrumin e spitalit, gjermani dukej fare i qetë! Bile ai, kishte qëndruar në këmbë para furnelës. Çajniku i madh ziente, valonte e nxirrte përjashta shtëllunga avulli. Fridmani fare i qetë qeshte e hidhte në çajnik një nga një vulat e koleksionit të tij të famshëm. Ishte çmendur! Kur erdhi autoambu-

lanca ushtarake për ta marrë, Fridmani doli gazmor nga bodrumi dhe hipi në autoambulancë sikur do të nisej të shëtiste në Vilhelmsstrase. Në oborr Molena vuri re se mushti në butet e Fridmanit kishte fermentuar aq shumë sa i kishte çarë dërrasat vende-vende dhe po rridhte si lumë nëpër oborr!

* * *

Mjeku njeri e vijoi punën e tij në ndihmë të lëvizjes çlirimtare. Dy herë e arrestuan ballistët dhe të dy herët ua hodhi.

Aty nga viti 1949, në bazë të një marrëveshjeje shtetërore, erdhën për shkëmbim eksperience dy mjekë kirurgë hungarezë. Sapo hynë në sallën e operacioneve, ata vunë re tri shtrate pune.

— Çështja qenka e zgjidhur, — foli njeri nga hungarezët — këtu kemi tri shtretër pune...

— Jo, jo, — shpjegoi ish-futbollisti i vjetër. — Këta të tre shtretërit i duhen vetëm doktor Molenës.

— Po atij s'ka se ç'i duhen tre?!

— Po ju merrni mundimin dhe prisni.

Filloi dita e punës. Doktor Molena i kryente ndërhyrjet kirurgjikale dhe operacionet e ndryshme, duke vepruar në të tre shtretërit. Njëri pacient pastrohej, i dyti operohej, të tretit i vinin maskën e narkozës. Nga njëri shtrat Molena nxitonte te tjetri. Të huajt mbetën gojëhapur. Ata nuk kishin parë një mjek të tillë. Ndejtën ndonjë vit këtu, punuan, u njohën, lidhën miqësi. Dhe pas disa vjetësh Molena shkoi në Budapest. Të dy kolegët maxharë dolën dhe e pritën, e çuan në spitalin e tyre duke e parqitur: «Mjeku me duart e rrufeshme!»

Molena ndejti dy muaj në Budapest. Dhe për çdo ditë ai punonte si ishte mësuar. E kishin ftuar në kodrat e Pestit, e thërritën në fabrikat e Cepelit, i ofruan një jakt nëpër Danub, por ai kurrë s'u nda nga puna. Më në fund i vunë përpara një bordero dhe e lutën të vinte firmën. Molena nënqeshi, ktheu nga ana tjetër borderonë dhe tregoi mantelin e tij të bardhë!

* * *

Kur mbaroi festa dhe miqtë u shpërndanë, ishte agim mbi qytet. Doktor i vendosi të shkonte në spital. Ndjehej i gëzuar dhe duart i digjnin. Nori deshte ta ndalonte, por ai ju përgjegj: «S'është gjë, e kam këtë zjarrmi nervore...» Ndezi motorin e automobilin dhe u nis për në spital. Edhe s'kishte lindur dielli. Punëtorët e pastrimit po hiqnin fshesat e fundit në bulevardin e madh. Fletët po pikonin nga puhiza e lehtë. Fshesarët sapo e panë, e njohën dhe qëndruan. I morën fshesat ndër duar dhe dy prej tyre nxorën kapelat, që kishin në kokë. Molena frenoi dhe çeli derën e automobilin.

— Mirë mëngjezni! — dhe u zgjati dorën.

— Mirë mëngjez, doktor, mirë mëngjez! Të bëheni dyqind vjet, doktor!

Dhe dora e tij delikate dhe plot energji humbi në atë dorën e madhe prej punëtori.

* * *

«Të luftosh armikun për dyzet vjet me radhë dhe mos të të kapë asnjë shigjetë! Kjo s'mund të ndodhë!»

Kështu përsëriste dendur Molena në kohët e fundit të jetës së tij. Për shkak të moshës ai doli në pension, por në asnjë rast ai s'ju nda spitalit, punës dhe të sëmureve. Ai qëndroi besnik ndaj jetës së tij.

Dhe një ditë...

Operacioni i tij i fundit: Në shtrat një pacient me stomak të plasur. Ndërhyrje urgjente. Ishte pacienti i tij i fundit Floran Stakani... Operacionin e kreu më së miri, por aty nga fundi... ai ndjeu një të ngacmuar lart nën sjetull.

U kthye në shtëpi, Nori e pa të lodhur si ngaherë, por atë ditë ai dukej dhe i zbetë. U shtri në poltronën e vet.

— Nori!..

— Çfarë ke, Stefan?

Ai psherëtiu thellë dhe i vështroi fëmijët një për një. Ata ju mblodhën të gjithë si për një rast solemn.

— Nori, këtu nën sjetull një gamolionet dhe kam dhembje.

* * *

Një aeroplan u ngrit nga aeroporti i Vienës, kaloi Alpet dhe doli mbi Adriatik. Pastaj shkau tatëpjetë dhe u kthye nga e majta drejt disa malesh të larta me majole të bardha, me fusha gjelbëroshe dhe me detin çuditërisht të ndritshëm. Piloti i parë hepohej herë andej e herë këtej duke kërkuar nëpër luginat e nëpër gjiret e maleve, aeroportin ku do të zbriste. Të pesë burrat e ekuipazhit heshtnin. Asnjë bisedë, asnjë shaka. Në aeroportin e Vienës ata ki-

shin dëgjuar shkurt historinë e atij mjekut me duar
të rrufeshme, që të pafrymë e të pajetë po ja kthe-
nin këtyre maleve me bukuri të ashpër nga kishte
dalë ai dhe ku ai u kishte shërbyer njerëzve gjer
në fund.

Kur zbritën në aeroport, një turmë të zi, djem
e vajza me kurora lulesh ndër duar. Banda lozte
Simfoninë e Pambaruar të Shubertit.